



2.12.2. Kapacitetet financiare

Komuna e Klinës është një komunë jo shumë e madhe dhe gjithashtu karakterizohet edhe me kapacitete mjaft të kufizuara financiare. Në vazhdim janë paraqitur pasqyra dhe trendet e realizimit të të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore për vitet 2022 – 2024:

Tabelë 55. Pasqyra dhe trendet e realizimit të të hyrave vetanake sipas kategorive kryesore, 2022- 2024

Kategoria e të hyrave vetanake:	Te hyrat - viti:			Trendet e rritjes / zvogelimit - viti:		
	2022	2023	2024	2022 - 2023	2023 - 2024	2022 - 2024
Tatimi ne prone:	453,281.30	621,791.15	550,999.44	168,509.85	70,791.71	97,718.14
Regjistrimi i automjeteve:	80,326.50	86,049.50	93,624.92	5,723.00	7,575.42	13,298.42
Lejet e ndertimit:	300,448.67	303,282.64	264,474.25	2,833.97	38,808.39	35,974.42
Regjistrimi i trashëgimise:	-				-	-
Nderrim i destinimit te tokes:	-				-	-
Dokumentet e gjendjes civile:	41,646.20	44,518.00	41,723.00	2,871.80	2,795.00	76.80
Veprimtarite afariste:	73,565.85	61,519.10	60,067.00	-12,046.75	1,452.10	13,498.85
Shfrytezimi i prones publike:	10,427.23	11,219.08	9,707.85	791.85	1,511.23	719.38
Participimet ne Arsim dhe Shendetesi:	100,116.20	101,607.10	118,282.00	1,490.90	16,674.90	18,165.80
Tjera:	146,806.16	155,814.47	149,910.24	9,008.31	5,904.23	3,104.08
Gjithsej:	1,206,618.11	1,385,801.04	1,288,788.70	179,182.93	97,012.34	82,170.59

Siç shihet edhe nga tabela, pjesa më e madhe e të hyrave realizohen nga tatimi në pronë



Tabelë 56. Pasqyra dhe trendët e të hyrave vetanake sipas inkasimit, 2022- 2024

Kategoria e të hyrave vetanake:	Te hyrat - viti:			Trendet e rritjes / zvogelimit - viti:		
	2022	2023	2024	2022 - 2023	2023 - 2024	2022 - 2024
Direkte:	1,206,618.11	1,385,801.04	1,288,788.70	179,182.93	97,012.34	82,170.59
Indirekte:	433,301.50	411,942.11	478,599.00	21,359.39	66,656.89	45,297.50
Gjithsej:	1,639,919.61	1,797,743.15	1,767,387.70	157,823.54	30,355.45	127,468.09

Tabelë 57. Pasqyra dhe trendët e donacioneve sipas prejardhjes, 2022 - 2024

Kategoria e donacioneve:	Donacionet - viti:			Trendet e rritjes/ zvogelimit - viti:		
	2022	2023	2024	2022 - 2023	2023 - 2024	2022 - 2024
Te brendshme:	36,361.50	65,698.87	50,516.02	29,337.37	-15,182.85	14,154.52
Te jashtme:	5,437.68	21,580.34	0	16,142.66	-21,580.34	-5,437.68
Gjithsej:	41,799.18	87,279.21	50,516.02	45,480.03	-36,763.19	8,716.84

Tabelë 58. Pasqyra dhe trendët e shpenzimeve kapitale sipas sektorëve, 2022 - 2024

Sektori:	Shpenzime kapitale - viti:				Trendet e rritjes / zvogelimit - viti:			
	2019	2020	2021	2022	2019 - 2020	2020 - 2021	2021 - 2022	2019 - 2022
Infrastruktura sociale dhe publike:	278,884.46	258,254.25	266,889.66	304,338.55	20,630.21	-8,635.41	37,448.89	25,545.09
Infrastruktura transportuese:	1,296,052.35	1,229,281.14	1,617,339.90	2,146,923.20	66,771.21	388,058.76	529,583.30	850,870.85
Infrastruktura teknike:	812,023.93	498,695.19	284,227.18	370,168.65	313,328.74	214,468.01	-85,941.47	441,855.28
Gjithsej:	2,386,960.74	1,986,230.58	2,168,456.74	2,821,430.40	400,730.16	-182,226.16	-652,973.66	-434,560.66



Tabelë 59. Pasqyra dhe trendët e planifikimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2022- 2024

Kategoria ekonomike:	Buxheti i planifikuar - viti:			Trendet e rritjes / zvogelimit - viti:		
	2022	2023	2024	2022 - 2023	2023 - 2024	2022 - 2024
Rroga dhe paga:	6,460,888.51 €	7,416,450.42	8,092,428.93	955,561.91 €	675,978.51 €	1,631,540.42 €
Mallera dhe shërbime:	1,308,063.51	1,782,811.89	1,807,648.83	474,748.38 €	24,836.94 €	499,585.32 €
Shpenzime komunale:	167,000.00	235,183.50	270,000.69	68,183.50 €	34,817.19 €	103,000.69 €
Subvencione dhe transfere:	350,000.00	480,802.68	708,521.70	130,802.68 €	227,719.02 €	358,521.70 €
Shpenzime kapitale:	2,882,380.00	5,652,958.35	4,987,996.79	2,770,578.35 €	-664,961.56 €	2,105,616.79 €
Gjithsej:	11,168,332.02	15,568,206.84	15,866,596.94	4,399,874.82 €	298,390.10 €	4,698,264.92 €

Tabelë 60. Pasqyra dhe trendët e shpenzimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike, 2022- 2024

Kategoria ekonomike:	Buxheti i shpenzuar - viti:			Trendet e rritjes / zvogelimit - viti:		
	2022	2023	2024	2022 - 2023	2023 - 2024	2022 - 2024
Rroga dhe paga:	6,686,270.42	7,406,952.40	8,092,428.93	720,681.98 €	685,476.53 €	1,406,158.51 €
Mallera dhe shërbime:	1,369,064.00	1,716,950.69	1,761,496.69	347,886.69 €	44,546.00 €	392,432.69 €
Shpenzime komunale:	167,000.00	235,175.78	269,888.31	68,175.78 €	34,712.53 €	102,888.31 €
Subvencione dhe transfere:	408,796.31	420,962.85	679,856.95	12,166.54 €	258,894.10 €	271,060.64 €
Shpenzime kapitale:	4,050,693.38	4,911,241.33	4,605,207.02	860,547.95 €	-306,034.31 €	554,513.64 €
Gjithsej:	12,681,824.11	14,691,283.05	15,408,877.90	2,009,458.94 €	717,594.85 €	2,727,053.79 €



3. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

3.1. TRENDET DHE PROGNOZAT DEMOGRAFIKE

3.1.1. Projeksionet e popullsisë

Bazuar në elementet bazë të zhvillimit demografik në komunën e Klinës janë dhënë edhe rezultatet e parashikimit demografik. Këto rezultate japin vlera për parashikimin demografik për të ardhmen deri në vitin 2033. Gjatë vlerësimit të popullsisë për komunën e Klinës deri në vitin 2033 janë llogaritur dy komponentët themelore që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen demografike siç janë: shtimi natyror dhe migrimi. Sipas të dhënave për numrin e lindjeve dhe të vdekjeve për vitin 2022 në komunën e Klinës është llogaritur edhe shkalla e shtimit natyrorë që është 7.6 promil apo 0.76 përqind. Gjithashtu sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës rreth migrimit, komuna e Klinës ka një bilanc negativ si në migrimin ndërkombëtar ashtu edhe në migrimin kombëtar. Bilanci i përgjithshëm i migrimit për vitin 2022 ishte – 592 banor apo 1.9%.

Bazuar në këto trende të shtimit natyror dhe migrimit, është dhënë edhe parashikimi i popullsisë për periudhën deri në vitin 2033.

Në vazhdim do të paraqitet ky parashikim sipas formulës:

$$P_a = P_o \times [(S_n + S_m) \times V/100] + 1$$

Shpjegimet e simboleve:

P_a = parashikimi i popullsisë për vitin 2033

P_o = Popullsia në vitin 2025

S_n = shkalla vjetore e shtimit natyrorë

S_m = shtimi vjetorë nga migrimi

V = vitet e llogaritura deri në vitin 2033

Parashikimi i numrit të popullsisë për komunën e Klinës për vitin 2033 është:

$$P_a = P_o \times [(S_n + S_m) \times V/100] + 1$$

$$\begin{aligned} P_a &= 30574 \times [(0.76 - 1.9) \times 10/100] + 1 = \\ &= 30574 \times 0.886 = 27089 \end{aligned}$$

Bazuar në të dhënat rreth shtimit natyror dhe atyre të migrimit, atëherë numri i popullsisë në komunën e Klinës do të vazhdojë të zvogëlohet si shkak i shkallës më të lartë të emigrimit në krahasim me shkallën e shtimit natyror. Pas 8 viteve, apo në vitin 2033, komuna e Klinës do të ketë gjithësej 27,089 banorë.



Tabelë 61. Popullsia rezidente dhe emigrantët e parashikuar për vitin 2033

	2011	2025	2033
Popullsia rezidente	38496	30574	27089
Emigrimi	13140	17353	22089
Gjithësej	51636	47927	49178

Në këtë tabelë është dhënë edhe numri i emigrantëve që është marrë nga të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Sipas këtyre të dhënave, në vitin 2011 në komunën e Klinës kishte 13140 emigrant. Nga vlerësimet e ASK-së për periudhën 2012-2022 nga kjo komunë kanë migruar edhe 4213 persona që totali në vitin 2022 i emigrantëve ishte 17353 persona. Nëse trendi i emigrimit do të vazhdonte i njëjtë, atëherë në vitin 2033 do të kemi 22089 emigrant nga komuna e Klinës. Sipas këtyre shënimeve, numri i popullsisë rezidente në komunë do të jetë 27089 në vitin 2033, ndërsa numri i përgjithshëm ku janë të përfshirë edhe emigrantet do të jetë 49178 banorë.

Tabelë 62. Projektionet e popullsisë për komunë 2011 - 2033

Viti	Ekonomitë Familjare		Popullsia	
	Komuna	Qyteti	Komuna	Qyteti
2011	5843	841	38496	5542
2025	6541	1230	30574	5784
2033	5759	1270	27069	5969



3.1.2. Projektionet e popullsisë sipas vendbanimeve

Në vazhdim janë dhënë projektionet për numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare sipas vendbanimeve në komunën e Klinës deri në vitin 2033.

Tabelë 63. Projektionet e popullsisë dhe ekonomive familjare sipas vendbanimeve 2011-2033

Vendbanimet	Viti 2011		Viti 2025		Viti 2033	
	Popullsia 2011	Nr. Familjeve	Popullsia	Nr. Familjeve	Popullsia	Nr. Familjeve
Bërkovë	246	37	185	40	157	34
Binxhë	117	18	88	19	75	16
Bokshiq	433	66	326	70	277	59
Budisalc	398	60	299	64	255	54
Caravik	1241	188	934	200	795	169
Çabiq	862	131	648	138	552	117
Deiq	376	57	283	61	241	52
Dobërdol	339	51	255	54	217	46
Dollc	276	42	208	45	177	38
Dollovë	444	67	334	71	284	60
Dranashiq	21	3	16	3	13	3
Drenoc	440	67	331	71	282	60
Drshnik	1770	269	1332	287	1133	243
Dugajevë	399	61	300	65	256	55
Dush	241	37	181	39	154	33
Dush i Vogël	196	30	147	32	126	27
Gllarevë	1784	271	1341	288	1141	243
Grabanicë	728	111	548	118	466	100
Grabc	206	31	155	33	132	28
Gremnik	1131	172	851	183	724	155
Gjurgjevik i Madh	449	68	338	72	288	61
Gjurgjevik i Vogël	745	113	560	120	477	101
Jagodë	197	30	148	32	126	27
Jashanicë	1784	271	1342	288	1142	243
Jelloc	27	4	20	4	17	3
Kërnice	794	121	597	128	508	108
Klinafc	480	73	361	78	307	66
Klinë	5542	841	5784	1230	5969	1270



Kpuz	622	94	468	100	398	85
Krushevë e Madhe	585	89	440	94	375	79
Krushevë e Vogël	323	49	243	52	207	44
Leskoc	239	36	180	38	153	32
Nagllavë	67	10	50	11	43	9
Përqevë	1005	153	756	162	644	137
Pjetërq i Epërm	563	85	423	91	361	77
Pjetërq i Poshtëm	160	24	120	25	102	21
Pograxhë	366	56	275	59	234	50
Qeskovë	373	57	281	61	239	52
Qupevë	579	88	436	93	371	79
Raduloc	353	54	266	57	226	48
Ranoc	353	54	266	57	226	48
Resnik	399	61	299	65	256	55
Rixhevë	870	132	655	140	557	118
Rudicë	446	68	336	72	286	61
Sferkë	2448	372	1842	393	1567	331
Siqevë	1338	203	1007	216	857	182
Stupë	179	27	135	29	115	25
Shtupel	771	117	580	124	494	105
Ujmir	544	83	409	88	348	74
Videjë	663	100	499	106	425	90
Volljak	929	140	699	149	595	126
Zabërgjë	728	110	548	117	466	99
Zajm	1267	191	953	203	811	171
Zllakuqan	660	100	496	106	422	90
KLINË	38496	5843	30574	6541	27069	5759

3.1.3. Projektionet e popullsisë sipas grup-moshës

Gjithashtu janë analizuar edhe projektionet e popullsisë sipas grup-moshës, sipas metodologjisë në vazhdim: Të dhënat janë marrë nga regjistrimi i popullsisë për vitin 2011 për strukturën e moshës. Më pas janë marrë edhe shënimet nga statistikat e lindjeve në komunën e Klinës për periudhën 2012-2022. Nga të dhënat për lindjet vërehet se pas vitit 2011 ka një rënie të natalitetit e cila ka ndikuar edhe në strukturën e popullsisë. Bazuar në këto të dhëna është dhënë edhe parashikimi i grup-moshës për vitin 2033.



Tabelë 64. Projektionet e popullsisë sipas grup-moshës

Viti	0-4	0-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80+	Gjithsej
2011	9.0	9.8	10.8	11.1	9.8	8.2	7.1	6.6	5.4	4.8	4.3	3.5	2.9	2.3	2.0	1.4	1.1	100
2025	4.9	5.8	8.5	8.6	9.3	10.4	10.4	9.2	7.8	5.9	4.8	3.6	3.1	2.8	2.2	1.5	1.1	100.0
2033	3.7	4.8	5.1	5.7	8.2	8.3	9.1	9.8	9.6	8.9	7.6	5.3	4.7	3.4	2.7	2.0	1.2	100.0

3.1.4. Vlerësimi i gjendjes

Shikuar në tërësi, në bazë të numrave absolut të banorëve, mund të thuhet që komuna e Klinës që nga viti 1948 kishte një rritje të vazhdueshme të popullsisë deri në kohën e luftës së fundit në Kosovë. Rënia e numrit të popullsisë, për rreth 13,770 banorë është dokumentuar ndërmjet periudhës 1991-2011. Kjo, para së gjithash shpjegohet me pasojat e luftës së fundit që ka shkaktuar viktima të shumta, lëvizjen e banorëve brenda dhe jashtë komunës, si dhe efektet e ndryshimit të metodologjisë së regjistrimit në vitin 2011. Sipas rezultateve nga regjistrimi i fundit i popullsisë në vitin 2024, kjo komunë ka vazhduar të shënojë rënie krahasuar me regjistrimin e vitit 2011. Në vitin 2011 komuna e Klinës kishte 38,496 banorë, ndërsa në vitin 2024 ka 30,574 banorë, apo 7,922 banorë më pak.

Megjithatë, të dhënat dëshmojnë rritje konstante të popullsisë për 76 vitet e fundit (1948-2024), në vlerë mesatare prej rreth 130 banorë në vit.

Kjo komunë ka një strukturë gjinore të baraspeshuar. Popullsia aktive, përbën 63 % të popullsisë, grup-mosha 0-14 vjeç merr pjesë me rreth 22% dhe grup-mosha mbi 65 vjeç, me 11.9%.

Dendësia e popullsisë në komunë është rreth 99 banorë/km², ajo më e larta në qytetin e Klinës dhe disa vendbanime përreth, ndërsa në viset më periferike të komunës, dendësia është më e ulët.

Shtimi natyror i popullsisë në komunë është 7.6 promilë.



S.W.O.T. ANALIZA PËR DEMOGRAFINË

PËRPARËSITË	DOBËSITË
➤ 63% e popullsisë ekonomikisht aktive (15-65 vjeç); ➤ Shtimi natyror-pozitiv; ➤ Rritja e vazhdueshme e nivelit arsimor te të rinjët	➤ Migrimi i banorëve nga komuna; ➤ Trendi i rritjes së popullsisë po shënon rënie të vazhdueshme; ➤ Rënie e vazhdueshme e shkallëve të shtimit natyror ➤ Shkalla e lartë e papunësisë ➤ Shkalla e ulët e aktivitetit ekonomik te gjinia femërore
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Mbështetja e ekonomive familjare, sidomos familjeve te reja; ➤ Programe socio-ekonomike, me synim te veçantë të rinjtë;	➤ Largimi i të rinjve jashtë vendit; ➤ Largimi i popullsisë ekonomikisht aktive dhe te kualifikuar jashtë vendit; ➤ Migrimi selektiv: migrimi i burrave/djemve dhe të rinjëve jashtë vendit;



3.2. ZHVILLIMI EKONOMIK

Në vitin 2023 komuna e Klinës kishte 1,510 ndërmarrje aktive. Nga të gjitha ndërmarrjet aktive në komunën e Klinës shumica absolute e tyre (99.4) janë ndërmarrje në pronësi private. Sektori me pjesëmarrjen më të madhe të bizneseve aktive është sektori i Tregtisë me Shumicë dhe Pakicë me gjithësej 343 biznese (23 % e numrit total të bizneseve aktive). Ky sektor pasohet nga sektori i Akomodimit dhe Aktiviteteve të Shërbimit të Ushqimit me 262 biznese aktive (17 % e të gjitha bizneseve aktive) dhe sektori i Aktiviteteve Shërbyese me 212 biznese (14 % e të gjitha bizneseve aktive).

Sa i përket shtrirjes gjeografike të bizneseve në Komunën e Klinës, 68 % e tyre janë të pozicionuara në zonën urbane (Klinë). Pas zonës urbane, vendbanimi me numrin më të madh të bizneseve të regjistruara është Gremniku me 4.0 % të bizneseve aktive, i pasuar nga Zajmi me 2.7 % të bizneseve aktive, Zllkauqani me 1.9 % të bizneseve aktive në komunën e Klinës etj. Dugajeva është vendbanimi i vetëm me asnjë (0) biznes aktiv të regjistruar.

3.2.1 Bujqësia

Me 14,948 ha sipërfaqe me tokë bujqësore, Komuna e Klinës hynë në zonën intensive për nga mundësitë e zhvillimit të bujqësisë, pasi që 87.7% e sipërfaqes është nën 600 metra të lartësisë mbidetare. Vetëm 4.9% e kësaj sipërfaqe janë toka jopjellore.

Në strukturën e tokave bujqësore dominojnë arat me 12,734 ha, pyjet me 12,735 ha, livadhet me 2,184 ha, kullosat me 2,043 ha etj. Kulturat e drithërave zënë sipërfaqe totale prej 7,551 ha, ku kultura e grurit dominon me sipërfaqe prej 5,557 ha, e pasuar nga kultura e misrit me 1,767 ha. Kulturat tjera të rëndësishme janë perimet, patatet, shalqiri etj. Elbi, thekra dhe tërshëra kultivohen më pak. Sipërfaqja e tokës punuese për kokë banori është rreth 0.33 Ha.

Sipas regjistrimit të Bujqësisë për vitin 2014, Komuna e Klinës kishte një potencial të fuqisë punëtore në bujqësi prej 10,076 personash. Ndërsa të angazhuar ishin vetëm 4,022 persona, të cilët vinin nga 1,016 ekonomi familjare. Numri i fermave në vitin 2014 ishte 1,090.

Në fushën e bujqësisë, numri i punonjësve të paarsimuar dhe ata me arsim të kufizuar është i lartë: 1,384 persona nuk kanë asnjë nivel arsimimi, 441 kanë përfunduar shkollën fillore, 151 kanë shkollë të mesme bujqësore, 527 kanë arsim tjetër të mesëm, ndërsa vetëm 4 kanë të përfunduar arsimin universitar.

Përderisa në vitin 2014 numri i personave që merreshin me bujqësi ishte 4,022, në vitin 2023 ky numër ka rënë në vetëm 1,090. Kjo tregon për rënien e interesimit dhe përfshirjes së fuqisë punëtore në bujqësi. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm 1,090 prodhues janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

Shpërndarja e pa kontrolluar urbane ka vazhduar të jetë shkaktari dhe rreziku më i madh i humbjes së sipërfaqeve bujqësore, ndërsa ky problem është i theksuar në të gjitha komunat e Kosovës.

Prodhimtaria Bujqësore (Lavërtaria, Perimkultura dhe Pemëtaria)

Për vitin 2023 ishte planifikuar të mbillen 9,979 Ha tokë bujqësore, ndërsa janë mbjellur 8,426.5 Ha (Drejtoria e Bujqësisë, 2023). Më së shumti sipërfaqe janë mbjellur me grurë (5,557 Ha), misër kokërr (1,767 Ha), perime (719 Ha), patate (110 Ha) etj. Rendimenti i kulturave bujqësore është relativisht i ulët (3.46 tonë grurë/Ha; 5.7 tonë misër kokërr/Ha etj.). Rendimenti i ulët është pasojë e mungesës së ujitjes dhe teknologjive të reja prodhuese, nivelit të ulët të arsimimit të fermerëve dhe mungesës së aplikimit të praktikave të nevojshme agro-teknike, numri i pamajftueshëm i makinave bujqësore si dhe amortizimi i makinerisë ekzistuese bujqësore etj.



Sektorët tjerë ekonomik: Tregtia, Industria, Zejtaria dhe Turizmi

Nga numri total i bizneseve aktive në Komunën e Klinës (1,510), 343 prej tyre, apo 23 % e totalit të bizneseve i takojnë kategorisë së Tëgtisë me shumicë dhe pakicë. Kjo e bënë Tregtinë sektorin më të madh ekonomik në Komunën e Klinës dhe rrjedhimisht sektorin më të rëndësishëm ekonomik, krahas bujqësisë, shërbimeve dhe akomodimit/hotelerisë. Përkundër mungesës së të dhënave për fushën e Industrisë, vlerësojmë se orientimi strategjik i Komunës së Klinës duhet të fokusohet në dy sektorë kryesorë: Gjetja e mënyrave dhe rrugëve më të përshtatshme për të shfrytëzuar në mënyrë eficiente dhe të qëndrueshme potencialin e pasurive minerale si dhe fokusimin në industrinë e lehtë prodhuese dhe përpunuese, sidomos duke u fokusuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore (Industri Bujqësore). Zejtaria duhet të fillohet të përkrahet me programe, masa dhe mjete konkrete. Kjo për shkak të rrezikut të mos-vazhdimet, përkatësisht të shuarjes së shumë aktiviteteve zejtare, ndërsa kjo e fundit përbën rrezik jo vetëm në aspektin ekonomik por edhe në aspektin kulturor. Sa i përket Turizmit, Parku “Ujëvarat e Mirushës” është një ndër zonat më bukura dhe interesante të natyrës së Republikës së Kosovës, dhe rrjedhimisht përbën edhe potencialin dhe asetin kryesor turistik të komunë së Klinës. Që ky atraktivitet i rrallë natyror të zhvillohet edhe më tej, nevojitet investim në infrastrukturë fizike, përveç tjerash.

3.2.2. Shërbimet

Sa i përket sektorit të shërbimeve, në komunën e Klinës, nga numri total i bizneseve aktive (1,510), 212 prej tyre (14 % e totalit) i takojnë sektorit të shërbimeve. Kur kësaj i shtohet edhe numri i bizneseve nga sektori i hotelierisë dhe akomodimit (262, ose 17 % e totalit të bizneseve aktive), e që ndërliken me shërbimet, mund të thuhet se shërbimet në komunën e Klinës përbëjnë rreth 30 % të aktivitetit ekonomik të komunës. Rrjedhimisht, sektori ka rëndësi të madhe edhe për të tashmen, por edhe për të ardhmen e ekonomisë së Klinës. Ky sektor mund të përkrahet me masa të ndryshme, duke përfshirë lidhjen e shkollimit (sidomos atij të mesëm- profesional) me nevojat e tregut të punës, organizimin dhe fuqizimin e shoqatave dhe aleancave biznesore, rrjetizimin e shoqatave dhe aleancave lokale me organizata të ngjashme rajonale e ndërkombëtare, organizimin e panireve të punës dhe panireve për promovim të shërbimeve etj.

3.2.3. Fuqia punëtore, punësimi dhe papunësia

Nga totali i popullsisë së Klinës (27,098), 9,031 banorë, apo 33 % e totalit janë popullsi ekonomiksht aktive, ndërsa 18,067 banorë, apo 67 % e popullsisë totale janë popullsi ekonomiksht jo aktive. Nga totali i popullsisë aktive, 3,822 banorë, apo 42 % e popullsisë aktive janë duke punuar aktualisht. Ndërsa shkalla e punësimit në raport me totalin e popullsisë së Klinës është vetëm 14 %. Sa i përket dallimeve gjinore në mesin e popullsisë ekonomiksht aktive dhe asaj të punësuar kemi gjendjen si vijon: edhe pse dallimi gjinor në numrin total të popullsisë është dallim i pa përfillshëm (49.30 % e popullsisë janë meshkuj, ndërsa 50.7 % e popullsisë janë femra), dallimet gjinore në mesin e popullsisë aktive dhe asaj të punësuar janë shumë të mëdha, me një dominim absolut të gjinisë mashkullore, në këtë mënyrë, 75 % e popullsisë ekonomiksht aktive përbëhet nga meshkujt, ndërsa vetëm 25 % e saj nga femrat. Ndërsa kur jemi tek dallimet gjinore mes popullsisë së punësuar, 80 % e tyre janë meshkuj, ndërsa vetëm 20 % e popullsisë së punësuar në komunën e Klinës përbëhet nga femrat. Për të përmbledhur shifrat e papunësisë në komunën e Klinës mund të thuhet se 58 % e popullsisë ekonomiksht aktive të Klinës janë të pa punë, ndërsa niveli i papunësisë në raport me totalin e popullsisë së Klinës është 86 %.



3.2.4. Resurset Nëntokësore dhe sipërfaqësore

Pasuritë kryesore nëntokësore të Komunës së Klinës janë: rezervat e linjtit (2 miliardë tonë), xehet e boksitit (2 milionë tonë), argjila (6.5 milionë tonë), rëra dhe zhavorri (3.5 milionë tonë) etj. Nga totali i bizneseve aktive të regjistruara në Klinë (1,510), 23 nga to, apo 1.5 % e totalit të bizneseve, aktivitet primar i kanë xehoret dhe gurëthyesit. Kjo përqindje e vogël e bizneseve të orientuara në këtë sektor tregon një disproporcion mes potencialit real të sektorit për zhvillim të gjithëmbarshtëm ekonomik dhe aktivitetit të realizuar aktualisht. Kjo gjendje kërkon ri-orientim të politikave ekonomike të Komunës si dhe gjetjen e mënyrave dhe mjeteve për shfrytëzim racional, eficient dhe të qëndrueshëm të këtyre resurseve.

S.W.O.T. ANALIZA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

PËRPARËSITË	DOBËSITË
➤ Kushtet optimale për zhvillimin e bujqësisë (pozita e volitshme gjeografike, toka pjellore, kushtet klimatike, resurset humane dhe natyrore si dhe relievi); ➤ Shkalla e lartë e Bonitetit të Tokës së Kategorive I-IV: 58 % ➤ Numri i mjaftueshëm i barnatoreve bujqësore aktive (5) ➤ Numri i mjaftueshëm i pikave grumbulluese të qumështit (6) ➤ Përqindja e lartë e Tokës Bujqësore (47.24%) dhe Tokës Pyjore (34.94%) ➤ Parku “Ujëvara e Mirushës” si pasuri natyrore dhe atraksion turistik ➤ Potenciali për zhvillimin e turizmit natyror dhe rekreativ; ➤ Potenciali për zhvillimin e industrisë bujqësore dhe industrisë së lehtë	➤ Dominimi i ndërmarrjeve të vogla; ➤ Dominimi i Sektorit të Tregtisë me Shumicë dhe Pakicë (23 %); ➤ Vjetërsimi i mjeteve të punës dhe makinerisë në bujqësi; ➤ Shkalla e ulët e rendimenteve të kulturave bujqësore dhe qumështit; ➤ Mbulueshmëria e pamjaftueshme e tokave me sistem të ujitjes (aktualisht vetëm 1,500 Ha); ➤ Disproporcion mes potencialit real zhvillimor të bazuar në rezerva natyrore dhe zhvillimit të aktivitetit aktual ekonomik; ➤ Shkalla e lartë e popullsisë ekonomiksht jo aktive: 67 % ➤ Shkalla e lartë e papunësisë: 42 % ➤ Investimet e ulëta në infrastrukturën fizike për zhvillimin e turizmit; ➤ Mungesa e investimeve në industrinë bujqësore dhe industrinë e lehtë
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Zhvillimi i qëndrueshëm i bujqësisë dhe përdorimi i teknologjisë së avancuar në bujqësi; ➤ Shfrytëzimi i potencialit ekzistues për zhvillimin e nën-sektorit të shpezëve; ➤ Ndërmarrja e masave adekuate për rritjen e rendimentit të produkteve bujqësore dhe qumështit; ➤ Potencial i madh për zhvillimin e turizmit natyror dhe rekreativ; ➤ Investimet e planifikuara në infrastrukturë fizike; ➤ Resurset Natyrore: Rezerva të linjtit, xehes së bokstit, të argjilës, rërës dhe zhavorrit	➤ Mos-adresimi i duhur i pabarazisë gjinore në pjesëmarrjen në popullsinë aktive, shkollim dhe punësim; ➤ Mos-adresimi i duhur i nivelit të lartë të varfërisë ekstreme dhe varfërisë së përgjithshme; ➤ Mos-adresimi i duhur i ndarjes së theksuar hapësinore të shtrirjes së varfërisë; ➤ Mos-adresimi i duhur i disproporcionit mes potencialit real zhvillimor të bazuar në rezerva natyrore dhe zhvillimit të aktivitetit ekonomik



3.3. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

3.3.1. Infrastruktura e Ujësjetës

Skema e furnizimit me ujë në komunën e Klinës përbëhet nga katër sisteme si më poshtë:

- Nga fabrika e përpunimit të ujit në qytetin e Klinës furnizohen qyteti i Klinës (rreth 70%) dhe fshatrat Zajm, Videjë, Jagodë (70%) dhe Deiq-Polce.
- Nga burimi e Jarinës furnizohet një pjesë e qytetit (rreth 30%) dhe fshatrat e anës veriore: Klinavc, Pogradec, Dresnik, Dolle, Gjurgjevik i Madh (50%), Ujmirë, Dush-Jelloç, Siqevë, Jashanicë, Shtupel, Kërnice dhe Binxhë-Grapc.
- Nga burimi i Garablit furnizohen fshatrat: Sferkë, Volljakë, Qupevë e Lartë dhe Dush i Vogël.

Një pjesë e fshatrave të komunës së Klinës furnizohen me puse vetanake dhe ato janë si më poshtë:

- Pusi i Kpuzit që furnizon fshatrat Kpuz dhe Qeskovë.
- Pusi Berkovës që furnizon fshatin Berkovë.
- Pusi i Dollovës që furnizon fshatin Dollovë.

Disa fshatrat tjera janë të lidhura në sistemet e ujësjetës të Pejës dhe të Istogut, si më poshtë:

- Nga sistemi i Pejës furnizohen fshatrat Stupë dhe Petriq i Epërm
- Nga sistemi i Istogut furnizohet fshati Rudicë
- Jarina 2 i cili do të furnizojë fshatrat: Cerrovik, Gllarevë, Stapanicë-Rixhevë, Zabergjë, Qabiq, Gjurgjevik i Madh, Përqevë, Dobërdol dhe Gjurgjevik i Vogël.
- Nga pusi i Budisalcit i cili aktualisht është në prag të funksionalizimit dhe i cili do të furnizojë fshatrat: Budisalc, Nagllavë, Krushevë e Madhe dhe një pjesë e fshatit Jagodë (30%).

Bazuar në statistikat e raportit të performancës komunale, rreth 75% e vendbanimeve, përfshirë edhe qytetin e Klinës furnizohen me ujë nga KRU “Hidrodrini” dhe nga sistemet e pompimit, ndërsa 25% nga puset individuale.

Gjatë vitit 2020 është investuar në sigurimin e burimit të ujit dhe instalimin e rrjetit dhe pompave në Qupevën e Lartë dhe Ultë, Volljak, ndërsa banoret kanë investuar në ndërtimin e rezervuarit të ujit. Ky investim do të ndikojë edhe në stabilizimin me furnizim me ujë gjatë gjithë vitit në fshatin Dush dhe Sferkë.

Në vitin 2019 është hartuar projekti i ujit të pijshëm. Ky projekt, pas përfundimit të studimeve të fizibilitetit, vlerëson se burimi i ujit në rrjedhën e shtratit të lumit “Drini i Bardhë” siguron 300 litra ujë të pijshëm për sekondë, i cili do të jetë i mjaftueshëm për banorët e komunës së Klinës, si dhe për 20,000 banorët jo rezident, të cilët kalojnë kohë të caktuar gjatë vitit në vendlindje. Kostoja e projektit sipas studimit do të arrijë deri në 3.5 milionë euro dhe është aprovuar në Asambleen Komunale.

Në vitin 2020 ka filluar implementimi i fazës së parë: “Ndërtimi i Liqenit Akumulues dhe hapja e puseve për ujë të pijes”. Punimet janë realizuar sipas projektit, mirëpo rezultatet e pritura nuk ishin të kënaqshme. Është vazhduar me fazën e dytë: “Ndërtimi i basenit Filtrues për shtimin e kapaciteteve të ujit në fabrikën e ujit në Klinë”

Qyteti dhe territori i Klinës mund të cilësohen si zonë me resurse të pakta ujore dhe me probleme të vazhdueshme të mbulimit të nevojave në rritje të qytetarëve të saj.

Sistemet ekzistuese janë sisteme që kryesisht shfrytëzojnë pompat për furnizimin e banorëve dhe rrjedhimisht edhe kostoja e prodhimit të ujit është më e lartë në raport me vendet tjera që furnizohen me gravitet.



Gjenda e stacioneve të pompimit dhe e rezervuarëve ekzistuese, përgjithësisht mund të konsiderohet e mirë, mirëpo këto janë objekte që vazhdimisht kërkojnë mirëmbajtje cilësore si dhe investime në rehabilitimin e tyre. Pompat furnizuese si dhe filtrat e teknologjisë së lartë, janë pajisje që kërkojnë kujdes profesional dhe në baza ditore nga ekspertët e KRU "Hidrodrini".

SWOT Analiza për Infrastrukturën e Ujësjiellit

PËRPARËSITË	DOBËSITË
➤ Rreth 75% e vendbanimeve furnizohen me ujë nga KRU "Hidrodrini", duke ofruar një burim të besueshëm për shumicën e popullsisë. ➤ Implementimi i fazave të ndryshme për ndërtimin e infrastrukturës së ujësjiellit, si ndërtimi i liqenit akumulues dhe pusit të ujit të pijshëm, tregon angazhimin për përmirësim.	➤ Disa zona janë të varura nga pusët vetanake, ndërsa burimet e ujit janë të kufizuara dhe nuk përmbushin gjithmonë nevojat. ➤ Shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim të duhur në lumin Klina krijon probleme mjedisore dhe higjienike.
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Rritja e kapaciteteve për furnizim dhe shpërndarje të ujit të pijes	➤ Shkarkimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave në lumenj përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin publik dhe mjedisin. ➤ Ngjarjet ekstreme të motit, si përmbytjet, mund të dëmtojnë infrastrukturën ekzistuese dhe të rrisin shpenzimet e mirëmbajtjes.

3.3.2. Infrastruktura e Kanalizimit

Pothuajse si të gjitha komunat e Kosovës, edhe komuna e Klinës po përballlet me një situatë të vështirë të menaxhimit të ujërave të zeza dhe trajtimit të tyre. Objektivi i përgjithshëm i heqjes/depozitimit higjienik dhe adekuat mjedisor të ujërave të zeza në Klinë mund të arrihet në mënyrë të qëndrueshme vetëm nëse KRU përkatëse do të jetë në gjendje të operojë dhe mirëmbaj objektet dhe pajisjet në mënyrë të duhur dhe afatgjatë. Ujërat e zeza shtëpiake në shumicën e qyteteve të mëdha të Kosovës grumbullohen përmes amvisërive dhe shkarkohet jashtë qyteteve - në një distancë të caktuar nga shtëpitë në lumin më të afërt. Shumica e ujërave të zeza në qytetin e Klinës barten përmes tre kolektorëve kryesorë: Dy prej tyre kolektorët shtrihen përgjatë rrugës kryesore të qytetit (në të dy anët e tij) duke mbledhur ujërat e zeza nga pjesa më e madhe e qytetit. Kolektori i tretë është ndërtuar në pjesën perëndimore të qytetit i cili më pas bashkohet me pjesën e poshtme të qytetit. Këta tre kolektorë rrjedhin nga graviteti drejt lumit Klina dhe shkarkohen aty në tre pika shkarkimi pa asnjë trajtim paraprak. Kolektorët kryesorë në zonën e qendrës së qytetit janë me diametër DN 250 mm, ndërsa një masë e konsiderueshme kërkohet ndërhyrja në riparimin



e tyre. Shumica e objekteve të banimit kolektiv, objekte publike dhe shtëpitë individuale përfshihen në kolektor. Ana perëndimore e qytetit ka gjithashtu një kolektor të rregulluar përgjatë pjesës së urbanizuar. Kolektorët tubat janë me diametër DN 160; DN 200 dhe DN 250. Cilësia e ndërtimit është e kënaqshme dhe gjithashtu ujërat atmosferike ndahen dhe mbledhen përmes kolektorit me diametri DN 500 dhe DN 600.

Të gjitha ujërat e ndotura të zonës urbane derdhen në lumin Klina në 3 pika shkarkimi, dhe ndotja ekologjike është një shqetësim i vazhdueshëm për atë zonë. Përveç këtyre kolektorëve, në pjesën jugore të qytetit është ndërtuar një kolektor tjetër (DN 200 dhe DN 250) dhe mbledh ujërat e zeza nga zona në anën e djathtë në hyrje të qytet. Pika e shkarkimit të këtij kolektori është gjithashtu pa asnjë trajtim dhe derdhet në Lumi Drini i Bardhë.

Sipas analizave që kanë dal nga dokumenti i studimit të “Situata aktuale dhe propozimet për trajtimin e ujërave të zeza në Komunën e Klinës” i realizuar në bashkëpunim Komuna e Klinës me KRU “Hidrodrini”, njësia në Klinë, janë identifikuar disa probleme me rrjetin e kolektorëve në të cilin është një ndërhyrje në rehabilitim dhe nevojiten, të zgjerojnë dhe veçojnë ujërat e zeza nga ato atmosferike. Kolektorët nuk janë ndërtuar në cilësi të mirë, për rrjedhojë ka edhe depërtim të ujit në puse. Në shumë raste të kolektorëve të ujërave të zeza nuk janë të ndarë nga ata atmosferikë. Përveç kësaj, në mënyrë të paligjshme ose të pakontrolluara janë bërë lidhje, gjë që ka dëmtuar më tej infrastrukturën në qytet.

Një tjetër problem shqetësues është hedhja e mbeturinave inerte të ndryshme në rrjetin e kanalizimeve nga banorë të papërgjegjshëm, gjë që shpesh shkakton mbylljen e kolektorëve, ku ndërhyrja e KRU “Hidrodrini” nevojitet për zhbllokimin dhe vënien në funksion të tyre. Një problem tjetër është shkaktuar në rastet kur ka përmytje, në disa zona uji del nga pusët dhe shkakton ndotje dhe problem higjienik në atë zonë.

3.3.3. Ujitja dhe Drenazhimi

Sistemi i shkarkimit të ujërave atmosferike duhet të jetë i ndarë nga ai i kanalizimit të ujërave të zeza. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në zonat e varrezave. Për mbrojtjen e rrjedhave natyrore të lumenjve, është e nevojshme të kontrollohen të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve. Në zona ku nuk ka ujë sipërfaqësor apo nëntokësor (si rrafshnaltat dhe majat e maleve), uji atmosferik mund të shfrytëzohet për furnizimin e amvisërive. Ky ujë, megjithëse shumë i butë dhe jo i përshtatshëm për konsum si pije, është i mjaftueshëm për përdorime të tjera të përditshme.

Uji nga shiu dhe bora mund të grumbullohet nga kulmet e ndërtesave ose nga sipërfaqet e specializuara, dhe përmes rezervuarëve mund të përdoret për qëllime të ndryshme.

Trasa e rrjetit të kanalizimit atmosferik duhet të ndërtohet më e cekët se ajo e kanalizimit të ujërave të zeza dhe industriale.

Me qëllim të ruajtjes së burimeve të ujit të pijshëm dhe rritjes së kapaciteteve ujore brenda zonës komunale, Komuna e Klinës do të duhet të vendosë kushte të reja zhvillimore për ndërtimin e rezervuarëve grumbullues të ujit atmosferik (ujë teknik) në planifikimet e saj urbane. Uji i grumbulluar nga çatitë e ndërtesave do të drejtohet në rezervuarët brenda parcelës ndërtuese, dhe do të mund të shfrytëzohet për ujitjen e parqeve, larjen e rrugëve dhe trotuareve, shuarjen e zjarreve, si dhe për nevoja të tjera komunale.

3.3.4. Infrastruktura e Energjisë Elektrike

Nga ajo që është përshkruar tek pjesa e Profilit të Komunës, në raport me infrastrukturën e energjisë elektrike janë identifikuar çështjet/problemet si më poshtë:

- Jo qëndrueshmëri e furnizimit me energji elektrike me përçues jo të dimenzionuar mirë të tipit ajror (LP 10(20) kV), e cila është bazë për zhvillimin ekonomik industrial;
- Investimet e mangëta në zhvillim të infrastrukturës energjetike me kapacitetet gjeneruese dhe të instaluar furnizuese energjetike;
- Humbje të mëdha teknike dhe komerciale të energjisë për shkak të mosdimensionimit të përçuesve për linjat ajrore dhe kablllore duke i vazhduar linjat furnizuese të tension të mesëm dhe tension të lartë për konsumatorët e rinj;
- Humbjet e energjisë nga kycjet ilegale dhe kycjet në linjat e TM dhe TU pa balanc të ngarkesave;
- Jo stabilitet gjenerues i Termocentraleve të vjetruara dhe mungesë e sigurisë së furnizimit me energji elektrike për shkak të pajisjeve të vjetërsuara, ndërtimeve të egra dhe linjave të gjata radiale me shumë degëzime të stërngakuara;
- Mirëmbajtje jo e rregullt e stabilimenteve energjetike nga vjetërsia e tyre dhe prishja e pajisjeve industriale dhe rezidenciale nga ndërprerjet e shpeshta të linjave furnizuese;
- Rëniet e tensionit dhe cilësia e ulët furnizuese për shkak të humbjeve të mëdha teknike dhe komerciale deri në 27% në total, prej të cilave 15% janë humbje teknike dhe rënie e tensionit;
- Mungesë e planit strategjik i cili pamundëson nisma konkrete për zhvillimin e infrastrukturës së sistemeve të energjisë së ripërtëritshme e në veçanti energjisë termike.
- Mungesë e diversifikimit të resurseve të energjisë si dhe mungesë e iniciativave konkrete për prodhimin e energjisë së bazuar në burime të ripërtëritshme natyrore.

3.3.5. Infrastruktura e Telekomunikimit

Nga ajo që është përshkruar tek pjesa e Profilit të Komunës, në raport me infrastrukturën e telekomunikacionit janë identifikuar çështjet/problemet si më poshtë:

Përdorimi i ulët i telefonisë fikse dhe varësia nga telefonia celulare e cila mund të reflektojë në një mungesë të investimeve në infrastrukturën e telekomunikacionit fiks ose një preferencë të ndryshuar të konsumatorëve drejt teknologjive më të lëvizshme.

Qasja e kufizuar në internet dhe posedim të kompjuterëve: Rreth 51% e ekonomive familjare posedojnë së paku një kompjuter personal, që është një shifër relativisht e mirë; megjithatë, vetëm 45.1% e ekonomive familjare që posedojnë kompjuter kanë qasje në internet nga njësia e banimit. Kjo do të thotë se ekziston ende një segment i konsiderueshëm i popullsisë që ose nuk ka qasje në internet për shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur të telekomunikacionit ose për shkak të kostove të larta të lidhjes me internet. Mungesa e qasjes në internet mund të pengojë mundësitë e zhvillimit ekonomik, arsimor dhe social në komunë.

Alternativat e kufizuara të qasjes në internet për familjet pa kompjuter: Vetëm 1.7% e ekonomive familjare që nuk kanë kompjuter shfrytëzojnë mundësitë alternative të qasjes në internet. Kjo tregon se ka mungesë të infrastrukturës publike të internetit, si pikat e qasjes Eë-Fi publike, qendrat e qasjes në internet, ose programe të tjera që mund të lehtësojnë qasjen në internet për ata që nuk kanë pajisjet e nevojshme. Kjo mund të ndikojë në mungesë të njohurive digjitale ose interesit për të përdorur internetin si një burim informacioni dhe mjet për përmirësimin e cilësisë së jetës. Për të adresuar këto sfida, është e rëndësishme që politikat lokale dhe investimet të synojnë përmirësimin e infrastrukturës së telekomunikacionit, rritjen e qasjes në internet me kosto të përballueshme, dhe nxitjen e përdorimit të teknologjive digjitale në mesin e popullsisë.

3.3.6. Infrastruktura e Menaxhimit të Mbeturinave

Mbeturinat grumbullohen në tërë territorin e komunës. Gjatë vitit 2019, rreth 89.50% e vendbanimeve ishin të përfshira në sistemin e grumbullimit të mbeturinave. Sfidë e madhe sa i përket mbeturinave është numri i madh i deponive ilegale (45 deponi ilegale prej tyre 32 të mëdha, 9 të mesme dhe 4 të vogla) dhe mungesa e pajisjeve dhe makinerisë së ndërmarrjes “Ambienti”. Përderisa shërbimi i mbledhjes së mbeturinave në Komunën e Klinës është funksional dhe efikas, një çështje e pa zgjidhur është riciklimi i mbeturinave. Ricikimi i mbeturinave mund të ketë ndikim në krijimin e vendeve të reja të punës, përderisa ky aktivitet mund të zhvillohet si veprimtari ekonomike. Mirëpo, paraprakisht duhet që secili rast i deponimit ilegal të trajtohet ndaras dhe duhet ndërmarrur masat për mbylljen e deponive ilegale, pastrimin dhe konsolidimin e tokës. Komuna duhet të ndërmarrë masat dhe veprimet e nevojshme për trajtimin e mbeturinave. Së bashku me kompaninë rajonale është i mundshëm përmirësimi i situatës aktuale në menaxhimin e mbeturinave.

3.4. TRANSPORTI DHE INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT

3.4.1. Rrjeti rrugor

Klinë është e lidhur mirë me qytete të tjera të rëndësishme nëpërmjet rrugëve kombëtare dhe rajonale. Rrugët kryesore e lidhin Klinën me Pejën, Gjakovën, Prishtinën dhe qytete të tjera të rëndësishme në Kosovë. Këto rrugë kanë një ndikim të madh në lëvizjen e qytetarëve dhe transportin e mallrave.

Gjendja e rrugëve në komunën e Klinës - nga të gjitha rrugët të cilat e përbëjnë rrjetin e rrugëve të komunës me gjatësi prej 498.02 km, rrugë magjistrale janë 28.7 km (5.76 %), rrugë regjionale 46.3 km (9.30%), rrugë lokale 423.02 km ose (84.94%), dy kategoritë e para të rrjetit të rrugëve janë të asfaltuara dhe mirëmbahen nga MMPHI. Gjatësia e rrugëve të asfaltuara të këtyre dy kategorive në komunën e Klinës është 75 km, ose 15.06 %. Rrugët magjistrale dhe ato regjionale paraqesin vijat kryesore të qarkullimit dhe lidhjeve brenda komunës dhe në pjesën më të madhe shtrihen në terrene të rrafshëta apo përgjatë luginave. Ndërkaq, rrugët lokale kanë një shtrirje të lirë në mes vendbanimeve, duke iu përshtatur kushteve natyrore që ofron hapësira e Klinës. Megjithatë, cilësia e infrastrukturës rrugore ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Ka disa segmente të rrugëve që kërkojnë rehabilitim për të përmirësuar sigurinë dhe efikasitetin e transportit. Në disa zona rurale, infrastruktura rrugore mbetet e kufizuar dhe jo mirëmbajtur.

Magjistralla Prishtinë - Pejë paraqet arterien kryesore të qarkullimit rrugor në territorin e komunës dhe shtrihet kryesisht në drejtimin lindje-perëndim, duke e ndarë atë në dy tërësi. Kjo magjistrale mundëson lidhje me pjesët qendrore dhe lindore të Kosovës, duke e përfshirë edhe kryeqytetin, ndërsa përmes degëzimeve të mëtutjeshme mundëson lidhje me shtetet fqinje, respektivisht Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Në drejtimin perëndimor, magjistralla mundëson lidhje me Pejën si qendër regjionale, si dhe me Malin e Zi në vazhdim.

Rruga regjionale për Gjakovë - kryqëzohet me rrugën magjistrale rreth 620 m në lindje të kryqëzimit për qytetin e Klinës dhe është lidhja më frekvente në krahasim me drejtimet tjera regjionale brenda komunës. Shtrihet kryesisht në drejtimin veri-jug, përgjatë rrjedhës së Drinit të Bardhë dhe pothuajse paralel me drejtimin hekurudhor për Prizren. Kjo rrugë regjionale mundëson lidhjen e Klinës me Gjakovën dhe Prizrenin, si dhe në vazhdim lidhjen me Shqipëri.

Rruga regjionale për Skenderaj - lidhet me rrugën magjistrale përmes zonës urbane të Klinës, ku kryqëzohet me rrugën nga Istogu. Kjo rrugë mundëson lidhjen e Klinës me Skënderajin, Mitrovicën dhe me pjesët tjera të veriut të Kosovës. Në pjesën më të madhe shtrihet përgjatë terreneve kodrinore, kryesisht në drejtim verilindor.

Projekti (autoudha e planifikuar) Kijevë - Klinë - Zahaq do të jetë një rrugë me dy korsi për kahe e projektuar të jetë në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe specifikacionet, me një shpejtësi të projektuar prej 100-120 km/orë. Shtrirja rrugore e projektit ka në një distancë deri në 1.5 km dhe kalon në veri të rrugës ekzistuese N9. Rruga ekzistuese N9 do të përdoret si një rrugë paralele dhe dytësore. Asnjë ndërhyrje në rrugën ekzistuese nuk është planifikuar në kuadër të Projektit. Projekti do të jetë pjesë e Rrugës 6 në lindje-perëndim, ndërmjet Prishtinës dhe kufirit me Malin e Zi. Prishtina dhe Peja janë qendrat kryesore urbane përgjatë korridorit. Autoudha kalon në territorin e komunave të Klinës dhe Pejës.

Bazuar në projektin e autorrrugës së planifikuar, 13 vendbanime gjenden përgjatë projektit të autostradës: Dollc, Zajm dhe Drenoc (të ndara) dhe Drsnik, Jabllanicë, Kliçinë, Leshan, Lugagji, Gllaviqicë, Ramun dhe Zahaq; Rruga po ashtu kalon nëpër pjesën veriore të fshatrave Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Poshtëm; efekti i barrierës për këtë pjesë është i shpërfillshëm. Rruga kalon nëpër një rrugë regjionale (R 104) dhe disa rrugë lokale; lidhja me rrugën ekzistuese është e mundur përmes disniveleve, ndërsa vazhdimësia e rrjetit të rrugëve lokale sigurohet nga nënkalimet ose mbikalimet.




Figure 5. Projekti i planifikuar i autoudha Kijevë – Klinë – Zahaq (Burimi: Harta Zonale Komunale 2020-2028)

3.4.2. Rrjeti Hekurudhor

Rrjeti hekurudhor në komunën e Klinës ka një rëndësi të madhe gjeostrategjike, por aktualisht përballet me sfida të mëdha në aspektin e infrastrukturës, shpejtësisë dhe frekuencës së shërbimeve. Përmirësimi i këtij rrjeti kërkon investime të mëdha dhe një strategji të qartë për modernizimin e tij, duke përfutur nga pozita gjeografike e Klinës dhe roli i saj si një nyje hekurudhore.. Hekurudha që kalon nëpër Klinë është e vjetruar dhe kërkon mirëmbajtje të rregullt për të siguruar funksionimin e duhur. Aktualisht, shpejtësia e trenave në Kosovë është relativisht e ulët, duke ndikuar negativisht në efikasitetin e transportit. Ky është një faktor që ndikon edhe në zonën e Klinës. Komuna e Klinës përfiton nga shërbimi i trenave për transportin e pasagjerëve dhe mallrave, por frekuenca dhe cilësia e shërbimeve hekurudhore mbetet e kufizuar në krahasim me vendet fqinje. Ka potencial për rritje të frekuencës së udhëtimeve për të përmbushur kërkesat në rritje për transport publik. Rrjeti hekurudhor në Klinë ka potencial për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të rajonit përmes transportit të mallrave, duke shërbyer si një rrugë kryesore për eksportin e prodhimeve bujqësore dhe minerare nga zona.

3.4.3. Transporti

Transporti publik me autobus është mjeti kryesor i udhëtimit për qytetarët e Klinës, veçanërisht për ata që udhëtojnë në qytete të tjera për punë apo shërbime. Ekzistojnë linja të rregullta autobusësh që lidhin Klinën me Prishtinën, Pejën dhe qytete të tjera kryesore. Megjithatë, frekuenca dhe cilësia e këtyre shërbimeve mund të përmirësohen, duke rritur përballueshmërinë dhe komoditetin për udhëtarët.

Sa i përket Transportit Urban Klinë nuk ka një sistem të zhvilluar të transportit urban brenda qytetit. Lëvizjet brenda qytetit kryhen kryesisht me automjete private ose taksi, ndërsa transporti publik brenda qytetit është i kufizuar.

S.W.O.T. ANALIZA PËR TRANSPORTIN DHE INFRASTRUKTURËN E TRANSPORTIT

PËRPARËSITË	DOBËSITË
➤ Pjesa më e madhe e rrugëve magjistrale dhe regjionale janë të asfaltuara dhe mirëmbahen nga MMPHI, duke garantuar akses të lehtë në zona të ndryshme. ➤	➤ Rrjetet rrugore lokale nuk janë gjithmonë të mirëmbajtura, dhe mungesa e ndërlidhjeve efektive në zonat rurale mund të pengojë qarkullimin.
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Shtimi i investimeve me bashkë-financim me ministrinë e linjes dhe përmes kredive/huave ndërkombëtare	➤ Shkarkimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave në lumenj përbën një rrezik të vazhdueshëm për shëndetin publik dhe mjedisin. ➤ Ngjarjet ekstreme të motit, si përmbytjet, mund të dëmtojnë infrastrukturën ekzistuese dhe të rrisin shpenzimet e mirëmbajtjes. ➤ Mungesa e investimeve të mëdha në infrastrukturë mund të pengojë zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.



3.5. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

3.5.1. Institucionet Administrative

Hapësirat për veprim të institucioneve të administratës në komunë në aspektin hapësinor i plotësojnë kërkesat për dhe kriteret e parapara për këtë sektor. Sa i përket vlerësimit të plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të parapara me NTPH prej 0.62m² për parcela kadastrale, në komunën e Klinës ka hapësirë të mjaftueshme administrative.

Tabelë 65. Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve administrativ

Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)
27,089	20,861	0.62	16,795.18	+4,056.82	

3.5.2. Institucionet Arsimore

Institucionet e arsimit parashkollor: Në Komunën e Klinës gjendet vetëm një çerdhe publike: çerdhja “Xhevë Lladrovci” në qytetin e Klinës për fëmijë të moshës nën 5 vjet, me kushte solide. Kjo çerdhe ka 34 nxënës me një hapësirë prej 806.78 m² dhe oborrin me një hapësirë prej 3,9606 m².

Tabelë 66. Kërkesat minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale për Arsimin Parashkollor

Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)
27,089	39,606	1.3	35,215.7	+4,390.3	

Normat Teknike minimale të Planifikimit Hapësinor e përcaktojnë sipërfaqen e parcelave të institucioneve të arsimit parashkollor ku parashihet sipërfaqe prej 0.30 m²/banor për çerdhe, si dhe 1m² /banor për kopsht. Nëse minusohet sipërfaqja ekzistuese e Çerdhës/ Kopshtit prej 3.96 ha, atëherë për nevojat e ardhshme të komunës së Klinës paraqiten këto kërkesa bazuar në numrin e popullsisë së parashikuar për vitin 2033: Sipas projeksionit për vitin 2033, komuna e Klinës do të ketë 27,089 banorë dhe kur planifikojmë një sipërfaqe në minimum prej 1.3 m² për kokë banori, atëherë Komuna ka përmbushur kërkesat minimale hapësinore të përcaktuara sipas Normave Teknike për Planifikim Hapësinor, duke pasur hapësirë të nevojshme prej 4,390.3m².

Përcaktimi i lokacioneve për çerdhe/kopshte varet nga disponueshmëria e pronës publike dhe largësisë së institucioneve të tjera, apo edhe nga faktorë të tjerë lokal.



Sipas Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr.30/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, infrastruktura e institucioneve të arsimit parashkollor, duhet të planifikohet në lokacione si në vijim:

1. Në kuadër të zonës së banimit;
2. Në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
3. Në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
4. Në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
5. Në largësi nga lokacionet e ndotura;
6. Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
7. Në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
8. Në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
9. Në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industrial

Nga këto vlerësime mund të konstatohet se në komunën e Klinës ka mungesë të konsiderueshme të hapësirave për çerdhe/kopshte dhe përcaktimi i hapësirave të nevojshme duhet të shpërndahet kryesisht në vendbanimet me më shumë banorë.

Institucione të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët dhe të lartë: Përmirësimi i infrastrukturës në shkollat e komunës së Klinës ka qenë vazhdimisht prioritet me rëndësi dhe me ndihmën edhe të donatorëve të ndryshëm janë bërë përmirësime të vazhdueshme. Megjithatë, komuna e Klinës ende përballet me sfida të shumta në kompletimin e infrastrukturës së nevojshme. Në vazhdim do të analizohen Normat minimale Teknike të Planifikimit Hapësinor për sipërfaqen e parcelave të infrastrukturës së institucioneve të arsimit parauniversitar fillor dhe të mesëm të ultë. Sipas këtyre normave, për çdo banor duhet të planifikohet sipërfaqe prej 1.6m²/banor për shkollë fillore, si dhe 1.2m² /banor për shkollë të mesme të ulët, e që i bie se për këtë nivel të shkollimit në total kërkohen 2.8 m² për banorë,

Në komunën e Klinës aktualisht mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 22 objekte shkollore. Hapësira ekzistuese e këtyre objekteve shkollore është gjithsej 862,624.6m². Nga kjo hapësirë, 12,683.14m² apo 1.48% janë hapësira të objekteve të shkollës, ndërsa 385,454.25 m² apo 44.6% e hapësirës së përgjithshme janë hapësira të oborreve të shkollave. Sipas NTPH, ky proporcion do të duhej të ishte 40% /60%.

Tabelë 67. Kërkesat minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale për Arsimin fillor dhe shkolla të mesme të ulëta

Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shitesë (m ²)
27,089	862,624.6	2.8	75,849.2	+786,775.4

Bazuar në parashikimin e popullsisë për vitin 2033 ku kjo komunë do të ketë 27,089 banorë, atëherë kërkesat e hapësirës së përgjithshme për shkolla fillore dhe shkolla të mesme të ulëta është 75,849.2m². Megjithatë, duhet cekur fakti se sa i përket sipërfaqes totale të hapësirave të nevojshme sipas NTPH, në komunën e Klinës aktualisht nuk ka mungesë të hapësirave shkollore, përkundrazi, ka hapësirë edhe një herë më të madhe se ajo që kërkohet me NTPH. Mirëpo problemi qëndron në



faktin se hapësira totale shkollore nuk është e shpërndarë në atë mënyrë që t'i plotësojë nevojat për secilin vendbabin. Në këtë mënyrë, përderisa kemi vendbanime me hapësira shkollore shumë më tepër se sa standardi i kërkuar me NTPH, në anën tjetër kemi vendbanime në të cilat hapësirat shkollore janë të pamjaftueshme, dhe rrjedhimisht nën standardin minimal të kërkuar me NTPH.

Institucione të arsimit të mesëm të lartë: Në arsimin e mesëm të lartë në komunën e Klinës ekzistojnë 2 shkolla të mesme ku mësimet i vijojnë 94 nxënës dhe janë të angazhuar 941 mësime. Këto shkolla kanë një sipërfaqe totale të parcelave kadastrale prej 16,132.7 m². Sipas Normatve Teknike të Planifikimit Hapësinor, norma minimale për sipërfaqen e parcelave të infrastrukturës së institucioneve të arsimit të mesëm të lartë është 1m²/ banor.

Tabelë 68. Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore sipas NTPH-së për parcela kadastrale për ShM

Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m ²)
27,089	16,132.7	1	27,089	-10,956.3

Sipas këtyre shënimeve kërkohet që të plotësohet hapësira edhe me 10,956.3m².

Bazuar në NTPH, infrastruktura e institucioneve të arsimit para-universitar, duhet të planifikohet në lokacionet si në vijim:

1. Në afërsi të zonës së banimit në vendbanime urbane;
2. Në kuadër të zonës së banimit në vendbanime rurale;
3. Në lokacion të rrafshët ose me pjerrtësi të vogël;
4. Në lokacion të diellosur dhe të mbrojtur nga erërat e forta;
5. Në afërsi të infrastrukturës rrugore, shtigjeve për këmbësorë dhe biçikleta si dhe qasjes në transport publik;
6. Në largësi nga ndërtesat të cilat krijojnë ndotje të mjedisit dhe zhurmë;
7. Në largësi nga lokacionet e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore- vërshimet;
8. Në largësi nga trafiku i rëndë (infrastruktura rrugore dhe hekurudhore);
9. Në largësi më të madhe se 150 m nga lokacionet me rrezikshmëri nga zjarret;
10. Në largësi më të madhe se 800 m nga ndërtesat industriale.



3.5.3. Institucionet Shëndetësore

Shërbimet shëndetësore publike në komunën e Klinës janë të organizuara në tri nivele: 1 Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në qytetin e Klinës, 4 Qendra të Mjekësisë Familjare (QMF) si dhe 11 ambulantë (AMF).

Tabelë 69. Hapësirat e infrastrukturës shëndetësore në Komunën e Klinës

	QKMF	QMF	AMF	Gjithsej
Numri i institucioneve	1	4	11	16
Sipërfaqja në m ²	4480	7158	42791.35	54429.35

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Klinë ka 3,954 m² hapësirë të ndërtuar, ndërësa sipërfaqja e parcelës kadastrale është 4,480 m². Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë hapësirë të ndërtuar prej 930.16 m² dhe sipërfaqe të parcelave kadastrale prej 7,158 m². 11 ambulatat e komunës së Klinës kanë hapësirë të ndërtuar prej 1,334.07 m² dhe sipërfaqe të parcelave kadastrale prej 42,791.35 m².

Tabelë 70. Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve shëndetësore

Numri i parashikuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohej me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m ²)
27,089	54,429.35	0.2	5,417.8	+49,011.55

Bazuar në sipërfaqet e përgjithshme aktuale prej 54,429.35m² dhe numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2033 (20,789 banorë) rezulton se Komuna ka përmbushur kërkesat minimale hapësinore të përcaktuara sipas Normave Teknike për Planifikim Hapësinor për infrastrukturë të institucioneve shëndetësore, dhe madje ka tejkaluar ato për 49,011.55 m².

3.5.4. Institucionet Kulturore dhe sportive

Qendra e kulturës gjendet në qytetin e Klinës dhe shërben për aktivitete të ndryshme kulturore dhe rinore. Ky është objekti i vetëm kulturor në këtë komunë. Në vazhdim janë paraqitur hapësirat dhe kërkesat sipas NTPH-së për infrastrukturën e institucioneve kulturore:

Tabelë 71. Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve kulturore

Lloji i institucionit kulturor	Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohej me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m ²)
Shtëpia e kulturës	27,089	2,592.3	0.20	5,417.8	-2,825.5



Sic shihet edhe nga tabela më lart, hapësira aktuale për shtëpi të kulturës në komunën e Klinës është e pamjaftueshme, ndërsa kërkohen edhe 2825.5m² më tepër për të arritur kriterin minimal të vendosur me NTPH. Gjithashtu kjo hapësirë nuk duhet të jetë e koncentruar vetëm në qytetin e Klinës.

Tabelë 72. Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të bibliotekave

Lloji i institucionit kulturor	Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m ²)
Bibliotekë	27,089	2,592.3	0.25	67,772.25	-4,181.95

Biblioteka gjendet në të njëjtën parcelë me Shtëpinë e Kulturës. Siç shihet edhe nga tabela më lart, edhe hapësira aktuale e bibliotekës është e pamjaftueshme, ndërsa kërkohen edhe 4181.95m² më tepër për të arritur kriterin minimal të vendosur me NTPH. As kjo hapësirë nuk duhet të jetë e koncentruar vetëm në qytetin e Klinës.

3.5.5. Institucione të mirëqenies sociale dhe komunitetit

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 0.45 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për ndërtesa të komunitetit. Duke marrë parasysh numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2033 (20,789) banorë dhe normën minimale prej 0.45 m²/banor për ndërtesa të komunitetit, Komunës i mungojnë gjithsej 11,090.05m² sipërfaqe të destinuara për ndërtesa të komunitetit.

Tabelë 73. Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së ndërtesave të komunitetit.

Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e pergjithshme që kërkohet me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m ²)
27,089	1,100	0.45	12,190.05	-11,090.05

3.5.6. Infrastruktura e institucioneve sportive dhe hapësirave rekreative

Normat minimale për sipërfaqen e parcelës së infrastrukturës së institucioneve sportive dhe fushave rekreative janë si në vijim:

1. Numri i banorëve në vendbanim:

- ≤ 5000 banor: 2.50 m²/banor;
- ≥ 5001- 20000 banor: 4.50 m²/banor;
- > 20001 banor: 5.00 m²/banor.



Tabelë 74. Vlerësimi i kërkesave hapësinore për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së rinisë, sportit dhe rekreacionit

Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e pergjithshme e që kërkohet me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m ²)
27,089		5.0	83,162	-81,686

Duke marrë parasyshë numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2033, 20789 banorë dhe normën minimale prej 2.5-5.0 m²/banor për sipërfaqe të parcelës së infrastrukturës së rinisë, sportit dhe rekreacionit, Komunës i mungojnë gjithsejtë -352,714m² sipërfaqe të destinuar për institucione të rinisë, sportit dhe rekreacionit.

3.5.7. Hapësirat e Gjelbërta dhe Parqet publike

Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor kanë përcaktuar normën minimale prej 2.00 m²/banor për sipërfaqe të parcelave të destinuara për hapësira të hapura publike.

Tabelë 75. Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të hapësirave të hapura publike

Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e pergjithshme e që kërkohet me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m ²)
27,089	1,476.20	2.00	54,178	-52,701.8

Duke marrë parasyshë numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2033 (20,789) banorë dhe normën minimale prej 2.00 m²/banor të destinuara për hapësira të hapura publike, Komuna ka nevojë të përcaktojë sipërfaqe shtesë për hapësira të tilla, pasi që sipërfaqet ekzistuese nuk plotësojnë kërkesat minimale sipas NTPH ku mungojnë gjithsej -52,701.8 m² për hapësirat e gjelbërta dhe publike.

3.5.7. Objektet e Religjionit dhe Varrezat

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale, kriteret minimale të përcaktuara me Norma Teknike për Planifikim Hapësinor si dhe numrin e prognozuar të banorëve për vitin 2033, Komuna ka plotësuar kërkesat hapësinore për varreza si dhe ka tejkaluar ato për 31,658.3m², kështu që Komuna nuk ka nevojë të përcaktojë sipërfaqe shtesë për varreza.

Tabelë 76. Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të hapësirave për varreza

Numri i prognozuar i banorëve 2033	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m ²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m ²)	Sipërfaqja e pergjithshme e që kërkohet me NTPH (m ²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m ²)
27,089	72,291.8	1.50	40,633.5	+31,658.3



Gjatë analizës së sipërfaqeve kadastrale për kokë banori në numrin e parashikuar për vitin 2033 për secilin vendbanim të komunës së Klinës, del se hapësira ekzistuese e varrezave është e mjaftueshme edhe për periudhën e ardhme deri në vitin 2033.

S.W.O.T. ANALIZA PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE SOCIALE

PËRPARËSITË	DOBËSITË
➤ Plotësim dhe tejkalim i standardeve lokale dhe ndërkombëtare për hapësira publike	➤ Pamjaftueshmëria e cerdheve dhe kopshteve (aktualisht ka vetëm një cerdhe publike)
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Investimi në digjitalizimin e procesit mësimor; ➤ Investimi në digjitalizimin e shërbimeve në shëndetësi; ➤ Investimi në digjitalizimin e shërbimeve në administratën publike; ➤ Shtimi i mëtejshëm i hapësirave publike	➤ Mospërbushja e kriterëve minimale për hapësira shkollore për shkollimin parafillor, fillor dhe shkollimin e mesëm

3.6. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

3.6.1. Ndotja e mjedisit

Bazuar në të dhënat e publikuara në institucionet mjedisore në Kosovë, rezulton se gjendja e mjedisit në komunën e Klinës nuk është e mirë. Evidentohet se degradimi i mjedisit është rezultat i shumë faktorëve si: shtimi i numrit të automjeteve dhe importimi i automjeteve të vjetëruara, deponim jo adekuat i mbetjeve inerte, shtazore, derivateve, vajrave, pastaj ndotja e ujërave sipërfaqësore e nëntokësore, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, degradimi i mjedisit nga mihjet sipërfaqësore dhe eksploatimi i zhavorit etj. Në komunën e Klinës janë duke u ndërtuar impiante të reja të trajtimit të ujërave të zeza, të cilat në masë të madhe do ta ulin nivelin e ndotjes në ujërat sipërfaqësor dhe jo vetëm. Dëmtimi dhe degradimi i mjedisit me të gjithë komponentët e saj si uji, ajri dhe dheu shkakton jo vetëm dëmtim dhe humbje të resurseve natyrore dhe humbje të tokës bujqësore, por shkakton edhe pasoja direkte dhe indirekte në shëndetin e njeriut dhe të kafshëve.

3.6.2. Ndotja e ajrit

Komuna e Klinës bazuar në pozicionin gjeografik konsiderohet që është larg ndotësve apo larg shkaktarëve kryesor të ndotjes, e që në raportet e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit (AMMK) del që komuna e Klinës është një ndër komunat me ajr relativisht të pastër. Nga këto raporte të cilat paraqesin matjen e disa parametrave ndotës (SO₂, NO_x, O₃, CO, PM₁₀, PM_{2.5}) shihet se qyteti i Klinës ka vlera minimale të këtyre parametrave ndotës, ndërsa vetëm grimcat e pluhurit PM₁₀ kanë rritje të herëpashershme duke kaluar vlerat e lejuara mesatare. Brenda territorit të komunës së Klinës ende nuk ka sistem monitorimi për matjen e cilësisë së ajrit, por në raportet e AMMK të dhënat merren nga stacionet që gjenden në afërsi. Mbetet sfida që ndotja e ajrit të evidentohet saktë edhe brenda zonës urbane, duke pasur parasysh faktin se hapësirë është e ekspozuar ndaj komunikacionit gjithënjë e në rritje, përdorimit të drurit për ngrohje, deponive të hapura të mbeturinave (metan dhe CO₂) etj. e të cilat shkaktojnë ndotje të konsiderueshme të ajrit.

3.6.3. Ndotja e ujit

Komuna e Klinës bazuar në kadastrin e ndotësve të ujërave të Kosovës karakterizohet me prezencë të ndotësve individual dhe kolektiv në kuadër të territorit të saj. Nga të dhënat e kadastrit të ndotësve të ujërave evidentohet që në komunën e Klinës janë 8 ndotës kolektiv të ujërave, ndërsa nuk është evidentuar asnjë ndotës i “veçant”. Duke qenë se territori i komunës së Klinës përkohet nga 5 lumenj të ndryshëm, kjo i ekspozon rrjedhat lumore ndaj ndotjeve të ndryshme, e që në shumicën e rasteve ato janë individuale. Nga raportet e kadastrit të ndotësve të ujërave në Kosovë, tek regjioni i Pejës në përgjithëse dhe komuna e Klinës në veçanti janë evidentuar disa zona kyqe ky ndotja e ujit është e shprehur kryesisht nga ndotësit individual. Në kuadër të komunës së Klinës zona e qytetit me afro 10,000 mije banorë vendshkarkimin e ka në lumin Drini i Bardhë dhe lumi Klina, vendbanimi Dushi shkarkon ujërat në Drinin e Bardhë, Gllareva shkarkon ujërat në hapësira ku rrezikohen të ndotën ujërat nëntokësor, Qabiqi shkarkon ujërat në lumin Klina.

3.6.4. Ndotja e tokës

Ndotja e tokës në Klinë mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore, e shkaktuar nga disa faktorë, përfshirë shfrytëzimin e pakontrolluar të burimeve natyrore, ndryshimin e destinimit të tokës dhe përdorimin e tepërt të pesticideve dhe plehrave kimike. Këto praktika kanë ndikuar ndjeshëm në cilësinë e tokës, duke dëmtuar produktivitetin bujqësor dhe ekuilibrin ekologjik të zonave rurale dhe urbane. Gjithashtu, ndotja nga mbetjet e depozituara jashtë zonave të përcaktuara dhe ndotja e ujërave sipërfaqësore përkeqësojnë më tej situatën.



Një problem i veçantë është ndotja potenciale e tokës dhe ujit nga substanca radioaktive si uranumi, cesiumi dhe tritiumi në disa zona specifike, përfshirë ish-kazermën e ushtrisë dhe fshatin Zllakuqan. Për të adresuar këto shqetësime, komuna ka ndërmarrë hapa për të analizuar mostrat e dheut dhe ujit përmes laboratorëve të akredituar. Rezultatet kanë treguar se vlerat e ndotjes dhe rrezatimit janë nën kufijtë e lejuar, duke qetësuar shqetësimet për rreziqe të menjëhershme mjedisore apo shëndetësore.

Për të parandaluar përkeqësimin e ndotjes së tokës, është e nevojshme të ndërmerren masa parandaluese, duke përfshirë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, kufizimin e përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve dhe eliminimin e deponive ilegale. Krijimi i mekanizmave të rregullt për monitorimin e tokës dhe ujit do të ndihmojë në identifikimin e problemeve në kohë dhe në zbatimin e politikave të duhura për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

3.6.5. Ndotja nga zhurma

Në Komunën e Klinës, ndotja akustike është një çështje e rëndësishme që ndikon në cilësinë e jetës së banorëve, veçanërisht në zonat urbane dhe përreth korridoreve kryesore të trafikut motorik. Për të zvogëluar ndikimin e zhurmës në vendbanime, është e nevojshme ndërtimi i pengesave akustike dhe krijimi i brezave të gjelbër midis rrugëve kryesore dhe zonave të banuara. Këto masa jo vetëm që ndihmojnë në uljen e niveleve të zhurmës, por edhe përmirësojnë estetikën dhe cilësinë mjedisore të qytetit. Shfrytëzuesit e pajisjeve dhe makinerive që prodhojnë zhurmë në Klinë duhet të sigurojnë përdorimin e pajisjeve dhe mjeteve që respektojnë standardet ligjore për nivelin maksimal të lejuar të zhurmës. Implementimi i masave mbrojtëse, si mirëmbajtja e mjeteve dhe aplikimi i teknologjive që zvogëlojnë zhurmën, është thelbësor për të shmangur ndikimet negative në komunitet.

Nga të dhënat e tabelës sektoriale zonat më të ekspozuara nga ndotja nga zhurma janë kryesisht rrugët magjistrale Pejë-Prishtinë (zona Gllarevë, Dollcë, Gremnik, Zajm, Drenoc) ku ndotja kryesisht vije nga zhurma që emetohet nga makineritë e transportit motorik (vetura dhe makineri transportuese). Në rrugën rajonale Klinë-Istog (vendbanimet Dollc, Dresnik, Zllakuqan, Klinafç) po ashtu evidentohet ndotja nga zhurma e shkaktuar nga lëvizja e mjeteve motorike. Në zonat ku kalon hekurudha evidentohet se janë të pranishme ndotje nga zhurma dhe vibracionet kryesisht në vendbanimet Klinë, Qupevë, Ujmir, Jagodë, Budisalcë etj.

3.6.6. Përmblytjet

Komuna e Klinës sikurse edhe të gjitha komunat tjera të Republikës së Kosovës përballet me vërshime, e që në disa raste janë edhe të shpejta (flash flood). Territori i komunës së Klinës përballet nga rreziku i vërshimit në raste kur ka stuhi në zonat kodrinore-malore, pastaj shira të vazhdueshme për disa ditë, shkrirje të shpejtë të borës në zonën burimore të Drinit të Bardhë etj. Në anën tjetër, degradimi i shtretërve lumor, prroskave, hudhja e mbeturinave etj. vetëm se kanë ndihmuar në rritjen e shkallës së rrezikut nga vërshimet. Në komunën e Klinës zonat më të ekspozuara ndaj vërshimeve janë ato përgjatë rrjedhave të lumenjëve Klina, Drini i Bardhë dhe Lumbardhit të Pejës. Në pjesën e lumit Klina janë ndërtuar argjinatura dhe breza mbrojtës të cilat kanë zbutur rrezikun nga vërshimet, ndërsa edhe në zonat e dy lumenjëve tjerë (Drini i Bardhë dhe Lumbardhi i Pejës) janë duke u ndërmarrur masa të ngjashme parandaluese. Mbetet sfidë që komuna të krijoj mekanizma që brenda zonës urbane të evitohen përmblytje dhe vërshime. Kjo do të mund të bëhet përmes masave të pastrimit të kanaleve kulluese të ujërave atmosferike, pastaj ndarjes së ujërave atmosferike nga ato fekale etj,



3.6.7. Erozioni dhe sedimentimi

Erozioni është fenomen që e rrezikon tokën dhe lidhet me proceset e gërryerjes, zhvendosjen dhe transportimin e lëndëve të ngurta ose materialit tokësor, nën veprimin e ujit, akullit, erës, apo edhe aktivitetit human. Bazuar në konfiguracionin e terrenit, pjerrësisë, kushteve klimatike që mbizotërojnë në hapësirën e komunës dhe rreth saj, territori i komunës së Klinës u ekspozohet vazhdimisht proceseve erozive të cilat janë të pranishme në disa zona. Në komunën e Klinës janë të pranishme dy lloje të erozionit e të cilët shkaktohen në hapësira lumore dhe ato kodrinore-malore. Si zona me potencial eroziv janë identifikuar zonat përreth lumit Drini i Bardhë, kryesisht në zonat kadastrale Krushevë e Madhe, Jagodë, anën perëndimore të zonës kadastrale Klinë, pastaj në Zajm, Grabanicë dhe Dollovë. Në pjesën e epërme të rrjedhës së Drinit të Bardhë janë duke u instaluar argjinaturat mbrojtëse kundër erozionit dhe vërshimeve që shkaktohen nga lumi Drini i Bardhë. Përveç erozionit lumor, në komunën e Klinës janë të pranishme edhe hapësira erozive që shkaktohen nga pjerrësia e terrenit, faktorët klimatik e ata human. Si zona që kanë rrezikshmëri nga erozioni i lartëcekur janë identifikuar zonat kadastrale Dresnik, Klinafç, Ujëmir, Qeskovë, Dranashiq etj.

3.6.8. Rrëshqitjet e Tokës

Bazuar në studimet që janë realizuar në Kosovë për rrëshqitjet e Tokës, në komunën e Klinës janë evidentuara dy zona në të cilat ka rrezik nga rrëshqitjet e Tokës si ajo në Dollc dhe në Krushevë. Për parandalimin e rrëshqitjeve të tokës, është thelbësore të stabilizohet terreni përmes ndërtimit të mureve mbajtëse, përdorimit të gjeotekstileve dhe rigjenerimit të mbulesës bimore në zonat e ndjeshme. Mbjellja e pemëve dhe bimëve me rrënjë të forta ndihmon në forcimin e tokës, ndërsa ndërtimi i kanaleve të kullimit dhe përmirësimi i sistemit të drenazhit shmang ngopjen e tokës me ujë dhe grumbullimin e tij në zona kritike. Për më tepër, kufizimi i ndërtimit në terrene të paqëndrueshme dhe përdorimi i studimeve gjeoteknike janë masa të domosdoshme për të parandaluar ndërhyrjet që mund të përkeqësojnë situatën. Gjithashtu, instalimi i sistemeve të monitorimit dhe krijimi i sistemeve paralajmëruese për zonat me rrezik të lartë janë kritike për menaxhimin e situatave emergjente. Edukimi i komunitetit për rëndësinë e ruajtjes së tokës dhe trajnimi për reagim ndaj rrëshqitjeve janë hapa të rëndësishëm për ndërgjegjësim dhe parandalim. Duke hartuar plane të menaxhimit të tokës që përcaktojnë dhe mbrojnë zonat e ndjeshme, është e mundur të ruhet stabiliteti i terrenit dhe të zvogëlohet rreziku i rrëshqitjeve, duke siguruar kështu një mjedis më të sigurt për komunitetet përreth¹⁶.

3.6.8. Orteqet dhe shpatet e pjerrëta

Këto dukuri nuk janë të pranishme në komunën e Klinës.

3.6.9. Tërmetet

Komuna e Klinës i takon zonës seizmike Istog-Pejë-Prizren, andaj ndërtimet dhe çdo ndërhyrje në terren duhet përshtatur konform rregulloreve që specifikojnë procedurat e ndërtimit në zona me aktivitete seizmik siç është zona e lartëcekur. Rregullorja “Eurokodi 8” për zonimin seizmik dhe kodet e ndërtimit parashohin masat që duhet pasur parasyshë kur planifikohen dhe zbatohen ndërtime të larta në zona të tilla. Në këtë zonë seizmike, vlerat më të larta të magnitudës llogariten të jenë mes 6 dhe 7.

¹⁶Burimi: Çadraku, H. and Bejta, S., Landslide in Kosovo and Necessity for Their Monitoring, *Uluslararası Doğa ve Mühendislik Bilimleri Dergisi*, 12(1), pp.14-18.



Edhe Harta e Rrezikut Seizmik të Kosovës e kategorizon këtë rajon me aktivitet seizmik relativisht të lartë, në të cilën kanë qenë të pranishme tërmete të forta, vatrat e të cilëve kanë qenë të cekta (mes 15 dhe 20 km).

3.6.10. Sipërfaqet me ndotje të lartë (hotspotet mjedisore)

Bazuar në Raportin e Hotspoteve Mjedisore në Kosovë, në kuadër të komunës së Klinës nuk është evidentuar asnjë lokacion apo sipërfaqe me ndotje të lartë.

3.6.11. Sipërfaqet e rrezikuara nga zjarret

Zjarret kryesisht në komunën e Klinës janë të paraqitura në zona të mbuluara me vegetacion pyjor dhe paraqitja e tyre është kryesisht gjatë muajve korrik-gusht. Në këtë kontekst komuna e Klinës në munges të *Planit në nivel komunal për mbrojtjen nga zjarri*, rekomandohet që në afat sa më të shkurtër të filloj hartimin e këtij plan i cili bazohet në *Ligjin për Mbrojtje nga Zjarri*.

3.6.11. Zbatimi i masave të parandalimit dhe mbrojtjes të kërkuara me VSM

Masat që parasheh VSM për parandalimin dhe mbrojtjen e sipërfaqeve nga ndotja e ajrit janë kryesisht të orientuara nga instalimin e stacioneve të monitorimit të kualitetit të ajrit, specifikisht për matjen e sulfurit. Tek ndotja e ujit masat për parandalim dhe mbrojtje të tyre janë të orientuara në shtimin e kanaleve të ujitjes dhe vendosjen e kushtëzimeve ndaj operatorëve ekonomik për aplikim të minimumit ekologjik, shtuar kësaj dhe monitorimin rigoroz për ndalim eksploatimi të zhavorrit. Tek ndotja e tokës masat për parandalim dhe mbrojtje fokusohen në zbatim të planit komunal për menaxhim të mbeturinave, kontroll rigoroz të emetimeve dhe ndotësve nga aktivitetet bujqësore, teknologjike apo industriale. Ndotja nga zhurma parasheh masat për parandalim dhe mbrojtje duke hartuar plan mobiliteti, pajisjen me mjete monitorimi të vazhdueshëm të zhurmës etj.



S.W.O.T. ANALIZA PËR MJEDISIN DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

PËRPARËSITË	DOBËSITË
➤ Mos tejkalimi i vlerave limite të mesatares vjetore për ruajtjen e cilësisë së ajrit; ➤ Ekzistimi i monumenteve dhe tërësive natyrore të mbrojtura me Ligjin për Konservimin e Natyrës; ➤ Monumenti i Natyrës “Mirusha” e cila karakterizohet si Zonë me Interes të Vecantë.	➤ Ndotja e mjedisit nga zgjerimi i zonave të banimit, ndërtimet pa leje, eksploatimi i gurit dhe gurthyesit, prerja ilegale e pyjeve, ndërtimi i rrugëve të reja dhe zgjerimi i atyre ekzistuese; ➤ Degradimi i lumenjëve nga ndërtime të ndryshme, devijime të shtretërve të lumenjëve dhe nxjerrja e rërës; ➤ Degradimi i mjedisit dhe ndotja e lumenjëve nga mostrajtimi i ujërave të zeza nga amvisëria dhe nga aktivitetet e ndryshme industriale; ➤ Ekzistimi i deponive ilegale të mbeturinave; ➤ Vërshimet e kohëpaskohshme nga lumi Drini i Bardhë; ➤ Prerja ilegale e pyjeve.
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Ndërmarrja e vazhdueshme e masave për ruajtjen e cilësisë së ajrit dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë; ➤ Ruajtja dhe promovimi i aseteve të Trashëgimisë Natyrore; ➤ Investimi në infrastrukturën fizike dhe promovimin e Monumentit të Natyrës “Mirusha”; ➤ Ndërmarrja e hapave të shpejtë dhe konkret për pastrimin dhe parandalimin e ndotjes së lumenjëve; ➤ Ndërmarrja e hapave të shpejtë dhe konkret për parandalimin e degradimit të mjedisit dhe prerjes ilegale të pyjeve.	➤ Mosadresimi i problemit të degradimit të mjedisit dhe ndotjes së lumenjëve; ➤ Mosadresimi i problemit të Deponive ilegale të Mbeturinave; ➤ Mosadresimi në kohë i problemit të vërshimit të Lumit Drini i Bardhë; ➤ Mosadresimi në kohë i problemit të prerjes ilegale të pyjeve.



3.6. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE dhe ASETET TURISTIKE

Komuna e Klinës është e pasur me lokalitete të trashëgimisë arkeologjike, arkitekturore dhe natyrore, një pjesë e të cilave janë shpallur edhe nën mbrojtje të përkohshme. Monumenti i Natyrës “Mirusha”, Manastiri i Budisalcit, Manastiri i Dollcit, Hermitazhi me kishë apo Kisha e Heremitëve janë shpallur si zona të vecanta të mbrojtura dhe për rrjedhojë, çdo lloj intervenimi në këto zona rregullohet sipas ligjit nr.03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Por, shumë prej këtyre lokaliteteve nuk janë në gjendje të mirë fizike dhe kërkojnë intervenime restauruese dhe zhvilluese. Gjithashtu këto lokalitete të trashëgimisë arkeologjike e kanë të përcaktuar perimetrit dhe zonën mbrojtëse ashtu siç kërkohet me Ligjin për Trashëgimi Kulturor, si dhe sipërfaqen e mbrojtur, ashtu siç kërkohet me Ligjin për Planifikimin Hapësinor.

Trashëgimia dhe resurset natyrore luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të komunës së Klinës. Këtu ekzistojnë shumë monumente dhe tërësi natyrore të mbrojtura me Ligjin për Konservimin e Natyrës, sipas të cilit biodiversiteti dhe peizazhet e larmishme me vlerë duhet të mbrohen me çdo kusht. Prandaj, komuna duhet të ndërmerë një sërë masash dhe veprimesh për të penguar veprimet e dëmshme të njeriut në natyrë si dhe në asete dhe hapësira të trashëgimisë kulturore.

Monumenti i natyrës “Mirusha” karakterizohet si zonë me interes të veçantë dhe e cila përfshinë sipërfaqe prej 598.4 ha. Plani Hapësinor i Monumentit të natyrës “Mirusha” ka përcaktuar mundësitë e zhvillimit të turizmit dhe veprimtarive tjera ekonomike si dhe përgjegjësi të komunës në mbrojtjen e vlerave natyrore dhe kulturore të identifikuara.

Të gjitha këto asete të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, përveç që duhet mbrojtur, ato mund të shfrytëzohen racionalisht dhe në mënyrë eficiente edhe si asete të vlefshme të turizmit kutluro dhe natyror/rural. Në këtë kontekst; shfrytëzimi i potencialeve për Turizëm Natyror dhe Rural, sidomos në Zonën e Mirushës, Dushit, Ujëmirë, Pograxhes etj. si dhe shfrytëzimi i potencialeve për Turizëm Kulturor, sidomos në Budisavc, Çabiq, Mirushë, Ujëmirë, Dresnik, Dollc etj. janë identifikuar si prioritet strategjik për zhvillimin e ardhshëm të turizmit në komunën e Klinës.

Zhvillimi i ardhshëm i Klinës do të bazohet në parimin dhe zotimin e të gjitha institucioneve lokale për respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Në këtë mënyrë, zgjerimi i kufijëve të ndërtimit do të bëhet në atë mënyrë që të respektojë kufijtë e perimetrit mbrojtës për zonat e mbrojtura- edhe të trashëgimisë kulturore edhe të asaj natyrore- ndërsa Komuna e Klinës do të sigurojë infrastrukturën e nevojshme teknike për të promovuar këto asete si asete të rëndësishme për zhvillimin e turizmit kulturor dhe natyror. Kjo qasje e komunës ka reflektuar edhe në Objektivat Strategjike, Qëllimet dhe Objektivat sektoriale, e po ashtu edhe në Planin e Veprimit të këtij Plani Zhvillimor Komunal.



S.W.O.T. ANALIZA PËR TRASHËGIMINË NATYRORE DHE KULTURORE

PËRPARËSITË	DOBËSITË
-Pasuri Arkeologjike dhe Arkitektonike: Ka shumë lokalitete të trashëgimisë arkeologjike dhe arkitektonike, të cilat kanë status të mbrojtur, duke ofruar një bazë të ligjshme për ruajtjen dhe menaxhimin e tyre. -Biodiversiteti dhe peizazhet e larmishme janë të njohura dhe të vlerësuara, duke ofruar potencial për zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor. -Plani i zhvillimit të Monumentit të natyrës "Mirusha" ka përcaktuar mundësi për zhvillimin e turizmit dhe aktiviteteve ekonomike.	-Shumë lokalitete të trashëgimisë nuk janë në gjendje të mirë fizike dhe kërkojnë restaurime të domosdoshme. -Paaftësia për të siguruar financime të mjaftueshme për restaurim dhe zhvillim të këtyre lokaliteteve. -Niveli i ulët i ndërgjegjësimit për rëndësinë e ruajtjes së trashëgimisë kulturore midis komunitetit lokal.
MUNDËSITË	RREZIQET
-Potenciali i lartë për zhvillimin e turizmit natyror dhe kulturor nëpërmjet promovimit të lokaliteteve të mbrojtura. -Mundësia për të punuar me organizata të brendshme dhe ndërkombëtare për mbrojtjen dhe restaurimin e trashëgimisë. -Krijimi i programeve edukative dhe fushatave për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.	-Rreziku i aktiviteteve dëmshuese ndaj natyrës dhe trashëgimisë kulturore nga ndërtimet e pakontrolluara dhe veprimtaritë industriale -Ndryshimet klimatike mund të ndikojnë negativisht në gjendjen e monumenteve natyrore dhe kulturore. -Rreziku i mosfinancimit ose mbështetjes së pamjaftueshme nga qeveria dhe institucionet përkatëse për ruajtjen e trashëgimisë.

3.7. VENDBANIMET

Komuna e Klinës, e cila përbëhet nga 54 vendbanime, përfshinë vendbanimet të ndara në disa kategori, duke filluar nga qendra komunale Klina, qendrat lokale, fshatrat, lagjet, dhe grupet e shtëpive. Duhet theksuar se nga pikëpamja hapësinore, numri më i madh i vendbanimeve është përqendruar në viset fushore, rreze maleve dhe kodrave.

Tipi i vendbanimeve kryesisht është vendbanim i tipit të grumbulluar, veçanërisht në zonat fushore, por ekzistojnë edhe ato kodrinore-malore dhe të ndara në lagje. Qyteti i Klinës ka një sipërfaqe prej 308 Ha dhe shtrihet përgjatë anës së majtë të lumit Drini i Bardhë, pranë derdhjes së lumit Klina. Lumenjtë Drini i Bardhë dhe Klina, së bashku me kodrinën në veri të qytetit, krijojnë një trekëndësh brenda të cilit qyteti është zhvilluar, ndërsa tri drejtimet kryesore rrugore, Klinë - magistrale, Klinë - Istog dhe Klinë - Skënderaj, paraqesin boshtet për gjatësinë e të cilave qyteti mund të zgjerohet. Ky model i zhvillimit ka bërë që Klina të ketë një strukturë urbanistike të përshtatshme dhe funksionale, duke ndërtuar një qendër që shtrihet në tri drejtime kryesore dhe përfshin pjesën urbane dhe fshatra përreth, duke siguruar një infrastrukturë funksionale dhe të qëndrueshme për qytetarët. Sa i përket vendbanimeve tjera;

Në komunën e Klinës ekzistojnë 54 vendbanime gjithësej e të cilat shtrihen në 43 zona kadastrale. Në kontekst të madhësisë së vendbanimeve në raport me numrin e banorëve, në komunën e Klinës kemi këto grupe të vendbanimeve:

- **Vendbanime shumë të vogla rurale (0-199 banorë)** janë gjithsej 8 vendbanime,
- **Vendbanime të vogla rurale (200-499 banorë)** janë gjithsej vendbanime,
- **Vendbanime të mesme të vogla rurale (500-999 banorë)** janë gjithsej 15 vendbanime,
- **Vendbanime të mesme të mëdha rurale (1,000-2,499 banorë)** janë 9 vendbanime,
- **Vendbanime të mëdha rurale (2,500-4,999 banorë)** nuk ka në komunën e Klinës.
- **Vendbanime me mbi 5,000 banorë:** vetëm Klina me 5,542 banorë.

Kur analizohet pjerrësia e terrenit për nevojat e zhvillimit të vendbanimeve në komunën e Klinës, duhet theksuar se në komunën e Klinës si terrene shumë të përshtatshme dhe të përshtatshme për ndërtim janë 165.9 km² (53.74%), kurse pjesët tjera, sidomos zona kodrinore-malore nuk janë të përshtatshme për ndërtim, përjashtimisht ndëhyrjeve në terrene për adaptime të caktuara.

Sa i përket funksioneve të vendbanimeve, qyteti i Klinës ka funksion administrativ, tregtar, industrial dhe rezidencial, duke formuar kështu qendrën më të zhvilluar të komunës. Vendbanimet tjera kanë funksion bujqësor, me përjashtim të vendbanimeve si Gllareva, Klinafç, Zllakuqan etj. që kanë edhe funksion tregtar dhe industrial.

Tabelë 77. Kategorizimet e vendbanimeve

Nr .	Vendbanimi	Kategoria	Morfologjia hapësinore	Dendësia ndërtimore	Relievi	Statusi i popullsisë
1	Bërkovë	Qendër Bazike	Shpërndarë	E ulët	I rrafshët 400m	Zvogëlim
2	Binxhë	Qendër Bazike	Shpërndarë	E ulët	I përzier 520m	Zvogëlim
3	Bokshiq	Qendër Bazike	Shpërndarë	mesatarë	I rrafshët 430m	Konvergjent



4	Budisalc	Qendër e rendit të ulët	Linear	E ulët	I rrafshët 410m	Konvergjent
5	Caravik	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	Mesatarë	I përzier 580m	Rritje e pop.
6	Çabiq	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	Mesatarë	I përzier 600m	Rritje e pop.
7	Deiq	Qendër Bazike	Koncentruar	Mesatarë	I rrafshët 390m	Rritje e pop.
8	Dobërdol	Qendër Bazike	Koncentruar	E ulët	I përzier 560m	Konvergjent
9	Dolc	Qendër Bazike	Koncentruar	Mesatarë	I rrafshët 430m	Konvergjent
10	Dollovë	Qendër Bazike	Linear	Mesatarë	I rrafshët 370m	Rritje e pop.
11	Dranashiq	Qendër Bazike	Koncentruar	E ulët	I rrafshët 440m	Zvogëlim
12	Drenoc	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	Mesatarë	I rrafshët 440m	Konvergjent
13	Dresnik	Qendër e rendit të ulët	Shpërndarë	E lartë	I rrafshët 440m	Rritje e pop.
14	Dugajevë	Qendër Bazike	Koncentruar	E lartë	I rrafshët 400m	Konvergjent
15	Dush	Qendër Bazike	Linear	E ulët	I përzier 520m	Konvergjent
16	Dush i Vogël	Qendër Bazike	Koncentruar	E ulët	I përzier 520m	Konvergjent
17	Gllarevë	Qendër e rendit të ulët	Lineare	E lartë	I përzier 600m	Rritje e pop.
18	Grabanicë	Qendër e rendit të ulët	Linear	mesatarë	I rrafshët 390m	Rritje e pop.
19	Grabc	Qendër Bazike	Koncentruar	E ulët	I përzier 490m	Konvergjent
20	Gremnik	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	mesatarë	I rrafshët 410m	Rritje e pop.
21	Gjurgjevik i Madh	Qendër Bazike	Shpërndarë	E ulët	I përzier 550m	Zvogëlim
22	Gjurgjevik i Vogël	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	mesatarë	I përzier 485m	Zvogëlim
23	Jagodë	Qendër e rendit të ulët	Lineare	E ulët	I rrafshët 400m	Zvogëlim
24	Jashanicë	Qendër e rendit të ulët	Shpërndarë	mesatarë	I rrafshët 430m	Rritje e pop.
25	Jelloc	Qendër Bazike	Koncentruar	E ulët	I përzier 500m	Zvogëlim



26	Kërnice	Qendër Bazike	Koncentruar	mesatarë	I rrafshët 460m	Rritje e pop.
27	Klinafc	Qendër Bazike	Shpërndarë	mesatarë	I rrafshët 450m	Konvergjent
28	Klinë	Qendër e rendit të mesëm	Koncentruar	E lartë	I rrafshët 400m	Rritje e pop.
29	Kpuz	Qendër Bazike	Koncentruar	E lartë	I rrafshët 440m	Rritje e pop.
30	Krushevë e Madhe	Qendër Bazike	Koncentruar	mesatarë	I rrafshët 400m	Konvergjent
31	Krushevë e Vogël	Qendër Bazike	Koncentruar	E lartë	I rrafshët 400m	Rritje e pop.
32	Leskoc	Qendër Bazike	Koncentruar	E ulët	I përzier 460m	Konvergjent
33	Nagllavë	Qendër Bazike	Koncentruar	E ulët	I rrafshët 410m	Zvogëlim
34	Përqevë	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	mesatarë	I përzier 599m	Rritje e pop.
35	Pjetërq i Epërm	Qendër Bazike	Shpërndarë	E ulët	I rrafshët 405m	Konvergjent
36	Pjetërq i Poshtëm	Qendër Bazike	Koncentruar	E ulët	I rrafshët 405m	Zvogëlim
37	Pograxhë	Qendër Bazike	Shpërndarë	mesatarë	I rrafshët 430m	Konvergjent
38	Qeskovë	Qendër Bazike	Shpërndarë	mesatarë	I rrafshët 440m	Rritje e pop.
39	Qupevë	Qendër Bazike	Linear	E lartë	I rrafshët 370m	Rritje e pop.
40	Raduloc	Qendër Bazike	Shpërndarë	mesatarë	I rrafshët 440m	Rritje e pop.
41	Ranoc	Qendër Bazike	Shpërndarë	E ulët	I rrafshët 415m	Rritje e pop.
42	Resnik	Qendër Bazike	Linear	E ulët	I rrafshët 480m	Konvergjent
43	Rixhevë	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	E lartë	I përzier 600m	Rritje e pop.
44	Rudicë	Qendër Bazike	Shpërndarë	Mesatarë	I rrafshët 410	Rritje e pop.
45	Sferkë	Qendër e rendit të ulët	Linear	E lartë	I përzier 550m	Rritje e pop.
46	Siqevë	Qendër e rendit të ulët	Shpërndarë	E ulët	I përzier 550m	Rritje e pop.
47	Stupë	Qendër Bazike	Shpërndarë	E ulët	I rrafshët 410	Zvogëlim



48	Shtupel	Qendër e rendit të ulët	Shpërndarë	Mesatarë	I rrafshët 450	Konvergjent
49	Ujmir	Qendër e rendit të ulët	Shpërndarë	Mesatarë	I rrafshët 480	Rritje e pop.
50	Videjë	Qendër Bazike	Shpërndarë	E lartë	I rrafshët 380	Konvergjent
51	Volljak	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	Mesatarë	I përzier 530m	Rritje e pop.
52	Zabërgjë	Qendër Bazike	Shpërndarë	Mesatarë	I përzier 610m	Rritje e pop.
53	Zajm	Qendër e rendit të ulët	Koncentruar	Mesatarë	I rrafshët 370	Rritje e pop.
54	Zllakuqan	Qendër e rendit të ulët	Linear	Mesatarë	I rrafshët 390	Konvergjent

Madhësia e vendbanimeve në komunën e Klinës është e kushtëzuar dhe e ndërlidhur ngushtë edhe me shtrirjen e tyre sipas lartësisë mbidetare. Vendbanimet e mëdha dhe më të zhvilluara janë të vendosura kryesisht në pjesën më të ulët të komunës ku edhe mundësitë për zhvillim janë më të mëdha. Me rritjen e lartësisë mbidetare, edhe kushtet për zhvillim socio-ekonomik janë më të kufizuara dhe si rrjedhojë na paraqiten vendbanimet më të vogla të komunës që kanë më pak banorë. Gjithashtu pozita qendrore ka luajtur një rol mjaft të rëndësishëm. Vendbanimet që shtrihen në pjesën qendrore të komunës dhe më afër qytetit të Klinës janë më të mëdha, ndërsa ato periferike janë më të vogla.

3.7.1. Sipërfaqet e ndërtuara në kuadër të vendbanimeve

Sipërfaqja e përgjithshme e komunës së Klinës është 30,902.1 ha, ndërsa sipërfaqja e ndërtuar është 2,648.91 ha, e që i bie se ndërtimi në këtë komunë zënë rreth 8.5% të territorit. Më poshtë është paraqitur sipërfaqja e ndërtuar për secilin vendbanim të komunës:

Tabelë 78. Sipërfaqja e ndërtuar në komunën e Klinës sipas vendbanimeve/zonave kadastrale

Nr	Vendbanimi/Zona kadastrale	Popullsia	Sip_Ha	Sip_k m ²	Banorë/km ²	Sip. e ndërtuar (ha)	Sip. e pa ndërtuar (Ha)	b/sip. ndert
1	Berkovë	246	490.6	4.9	50.14	53.4	437.2	4.61
2	Binxhë/Grapc	323	1,143.90	11.4	28.24	71.97	1071.93	4.49
3	Bokshiq	433	539.9	5.4	80.19	46.58	493.32	9.3
4	Budisalc	398	428.7	4.3	92.85	47.23	381.47	8.43
5	Çabiq	862	579.4	5.8	148.78	84.08	495.32	10.25
6	Caravik	1241	873.3	8.7	142.1	89.91	783.39	13.8
7	Qupevë	579	352.9	3.5	164.06	26.67	326.23	21.71
8	Dollovë	444	352.9	3.5	125.8	24.04	328.86	18.47
9	Dobërdol	339	454.3	4.5	74.61	50.41	403.89	6.72
10	Drenoc	440	807	8.1	54.52	46.32	760.68	9.5



Kuvendi Komunal Klinë
Plani Zhvillimor Komunal 2025-2033

1 1	Dranashiq/Ranoc/Leskoc	613	976.9	9.8	63.78	78.33	898.57	7.83
1 2	Dresnik	1770	1,523	15.2	116.22	63.98	1459.02	27.66
1 3	Dugojevë	399	576.4	5.8	69.23	18.01	558.39	22.15
1 4	Dush i Vogël	196	413.6	4.1	47.39	43.74	369.86	4.48
1 5	Gjurgjevik i Madh	449	1,217.70	12.2	36.87	52.78	1164.92	8.51
1 6	Gllarevë/Rixhevë	2654	1562	15.6	169.91	123.53	1438.47	21.48
1 7	Grabanicë	728	550.8	5.5	132.18	67.58	483.22	10.77
1 8	Gremnik	1131	758.6	7.6	149.09	96.97	661.63	11.66
1 9	Jagodë	197	222.6	2.2	88.52	27.46	195.14	7.17
2 0	Jashanicë	1784	1,492.10	14.9	119.56	141.37	1350.73	12.62
2 1	Klinë/Krushevë e Vogël	5865	591	5.9	992.39	162.9	428.1	36
2 2	Klinafc/Pograxhë/Gjurgjevik I Vogël	1591	1,051.10	10.5	151.36	146.89	904.21	10.83
2 3	Kpuz	622	1160.9	11.6	53.58	31.81	1129.09	19.55
2 4	Krushevë e Madhe	585	643.2	6.4	90.96	44.45	598.75	13.16
2 5	Nagllavkë	67	386.8	3.9	17.32	15.3	371.5	4.38
2 6	Zajm	1267	482.2	4.8	262.74	92.11	390.09	13.76
2 7	Perqevë	1005	993.4	9.9	101.17	66.43	926.97	15.13
2 8	Pjëterq i Poshtem	160	612.6	6.1	26.12	24.49	588.11	6.53
2 9	Pjëterq i Epërm	563	395.6	4	142.32	63.42	332.18	8.88
3 0	Rudicë	446	241.1	2.4	184.98	40.59	200.51	10.99
3 1	Shtupel/Kërnice	1565	1,161.80	11.6	134.7	131.34	1030.46	11.92
3 2	Siqevë	1338	785.9	7.9	170.25	81.49	704.41	16.42
3 3	Stupë	179	232.7	2.3	76.93	36.57	196.13	4.89
3 4	Volljak	929	695.9	7	133.5	52.22	643.68	17.79
3 5	Zllakuqan/Radulicë	1013	625.6	6.3	163.53	77.85	547.75	13.01
3 6	Dollc	276	475.2	4.8	58.08	28.81	446.39	9.58



37	Ujmirë	544	331.5	3.3	164.13	38.1	293.4	14.28
38	Zabërgjë	728	236.9	2.4	307.32	40.49	196.41	17.98
39	Qeskovë	373	336	3.4	111.01	33.63	302.37	11.09
40	Videjë	663	849.4	8.5	78.06	33.09	816.31	20.04
41	Deiq	376	97.7	1	384.73	26.56	71.14	14.16
42	Sferkë	2448	1,594.30	15.9	153.55	29.16	1565.14	83.95
43	Dush/Jellovcë/Resnik	667	1,604.90	16	41.56	96.85	1508.05	6.89
	Gjithsej	38496	30,902.10	309	124.6	2,648.91	28253.19	14.5

3.7.2. Pjerrësia e terrenit për nevojat e zhvillimit të vendbanimeve

Një nga klasifikimet tjera të sipërfaqeve tokësore është edhe ajo që bëhet për nevojat e ndërtimtarisë. Sipas një klasifikimi¹⁷, terrene të përshtatshme për ndërtim konsiderohen terrenet me pjerrësi deri në 5 shkallë. Po ashtu edhe terrenet me pjerrësi 5-12 shkallë konsiderohen të përshtatshme për ndërtim, mirëpo këto terren kërkojnë rregullime adekuate. Terrenet me pjerrësi mbi 12 shkallë janë të përshtatshme për ndërtim vetëm në rrethana të caktuara, ndërsa terrenet me pjerrësi mbi 32 shkallë janë të papërshtatshme për ndërtim.

Nga klasifikimi i lartëcekur, në komunën e Klinës si terrene shumë të përshtatshme dhe të përshtatshme për ndërtim janë 165.9 km² (53.74%), kurse pjesët tjera, sidomos zona kodrinore-malore nuk janë të përshtatshme për ndërtim, përjashtimisht ndërhyrjeve në terrene për adaptime të caktuara.

Tabelë 79. Klasifikimi i sipërfaqeve për nevoja të ndërtimtarisë në komunën e Klinës


Pjerrësia	Sipërfaqja (km ²)	Përqindja	Tipi I tokës
<2°	59.54	19.29	Shumë të përshtatshme për ndërtim
2 - 5°	106.32	34.45	Të përshtatshme për ndërtim
5 - 12°	129.24	41.88	Të përshtatshme me rregullim adekuat
12 - 32°	13.40	4.34	Të papërshtatshme, vetëm me pjesë të caktuara të dobishme për ndërtim
> 32°	0.10	0.03	Jo të përshtatshme për ndërtim
	308.6	100.00	

¹⁷ Pécsi, M. -Environmental geomorphology in Hungary. In: Pécsi, M. (ed.) Environmental and dynamic geomorphology: Case studies in Hungary. Contribution to the First International Geomorphology Conference, 1985.



Kuvendi Komunal Klinë

Plani Zhvillimor Komunal 2025-2033



Harta 35. Klasifikimi i sipërfaqeve për nevojat e ndërtimtarisë në komunën e Klinës



3.8. BANIMI

Ndërtesat afaristo-banesore shtrihen përgjatë rrugëve kryesore, aty ku frekuentimi i banorëve është më i lartë. Shtëpitë individuale zakonisht posedojnë etazhitet P+0 apo P+2, ndërsa ndërtesat shumë-banesore të cilat i hasim në qendër të qytetit posedojnë etazhitet P+3 deri në P+10. Numri i përgjithshëm i njësive të banimit individual është rreth 10,283 ndërtesa me sipërfaqe rreth 1,690.96 Ha. Numri i ndërtesave të banimit kolektiv (në zonën urbane) është 46 ndërtesa me sipërfaqe rreth 7.23 Ha. Vitet e fundit, e sidomos periudha e pas luftës karakterizohen me tendencë të ngritjes së etazhitetit të ndërtesat shumë-banesore. Hapësirat e ndërtuara me banim individual karakterizohen si hapësira në të cilat nuk janë respektuar rregullat dhe kriteret urbanistike. Deri sa në Klinë si qendër urbane kemi një rritje të numrit të banorëve dhe ndërtimeve, në shumë fshatra paraqitet fenomeni dhe problem i depopullimit. Kjo lëvizje e banorëve ka për pasojë uljen e cilësisë së banimit në qytet për shkak të rritjes së numrit të banorëve në raport me shërbimet dhe kapacitetet ekzistuese. Ndërkaq edhe në fshatra kemi ulje të cilësisë së banimit, për kësaj here kjo vijë për shkak të mosshfrytëzimit të kapaciteteve të banimit dhe infrastrukturës ekzistues, por edhe për shkak të mungesës së investimeve publike për përmirësimin e kushteve të jetesës në ato vendbanime. I tërë ky zhvillim i pabalancuar shkakton pasoja edhe në zhvillim të përgjithshëm social dhe ekonomik të komunës, sidomos kur merret parasysh fakti i mosshfrytëzimit të potencialeve natyrore për zhvillim të bujqësisë dhe blegtorisë.

Sipas strukturës së vendbanimeve, përmbajtjeve dhe numrit të njësive të banimit, përveç qytetit të Klinës dallohen edhe disa vendbanime tjera si Zllakuqani, Grabanica, Jashanica dhe Ujëmiri. Këto vendbanime kanë tendencë të zhvillimit apo rritjes së mëtejme dhe në të ardhmen do të duhej të mendohej edhe për ngritjen e nivelit të vendbanimit.

Për shkak se në kohën e trajtimit përfundimtar të kësaj teme (Janar 2025) Agjencia e Statistikave të Kosovës (AKS) ende nuk ka publikuar rezultatet finale të Regjistrimit të Popullsisë dhe Ekonomive Familjare, si dhe për shkak të faktit se regjistrimi i fundit i publikuar në ASK në vitin 2011 nuk mund të jetë relevant me realitetin dhe situatën aktuale në fushën e banimit, ky PZHK nuk përmbanë të dhëna tjera të banimit në Komunën e Klinës.



S.W.O.T. ANALIZA PËR VENDBANIMET DHE BANIMIN

PËRPARËSITË	DOBËSITË
➤ Shumica e vendbanimeve janë të përqendruara në viset fushore, duke ofruar mundësi të mira për zhvillim dhe infrastrukturë. ➤ Qendra e Klinës dhe rrjetet e saj rrugore sigurojnë një strukturë urbanistike funksionale dhe të përshtatshme për zhvillim. ➤ Infrastruktura funksionale dhe e qëndrueshme mbështet aktivitetet ekonomike dhe shoqërore. ➤ Pozita e favorshme gjeografike e qytetit dhe rrugëve kryesore krijon mundësi për zhvillim ekonomik dhe tregti. ➤ Rritja e popullsisë dhe ndërtimeve në qytetin e Klinës është një tregues i gjallërisë urbane dhe tërheqjes së banorëve.	➤ Një numër i konsiderueshëm vendbanimesh ka popullsi të vogël (në kategorinë 0-499 banorë), duke kufizuar burimet dhe shërbimet. ➤ Vetëm 53.74% e territorit është e përshtatshme për ndërtim, duke kufizuar zhvillimin në zona të tjera. ➤ Disa vendbanime më të vogla ndoshta kanë mungesë të shërbimeve bazike, si ujësjellësi dhe ndriçimi publik. ➤ Depopullimi në fshatra: Migrimi i banorëve nga fshatrat në qytet ul cilësinë e banimit në qytet dhe çon në mosshfrytëzim të kapaciteteve ekzistuese të infrastrukturës në zonat rurale.
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Mundësitë për planifikimin e zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrimin e vendbanimeve në projekte më të gjera zhvillimi. ➤ Rritja e popullsisë dhe migrimi mund të sjellin më shumë burime dhe investime në infrastrukturë. ➤ Mundësitë për zhvillimin e turizmit rural në fshatra dhe vende të tjera atraktive natyrore. ➤ Angazhimi i komunitetit në proceset e vendimmarrjes dhe zhvillimit mund të forcojë lidhjet sociale dhe të sjellë risi. ➤ Investimet në përmirësimin e shërbimeve dhe infrastrukturës në zonat urbane dhe rurale do të ndihmojnë në përbalimin e rritjes së popullsisë dhe përmirësimin e cilësisë së banimit. ➤ Shfrytëzimi i potencialeve natyrore për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë mund të ndihmojë në ringjalljen e ekonomisë rurale dhe në përmirësimin e cilësisë së jetesës në fshatra.	➤ Shkalla e lartë e migrimit të rinisë mund të sjellë rënie të popullsisë dhe forcës punëtore. ➤ Ndryshimet klimatike dhe ndotja mund të ndikojnë negativisht në mjedisin dhe shëndetin e banorëve. ➤ Ndarja e burimeve dhe shërbimeve mund të krijojë tensione sociale, sidomos në vendbanimet më të vogla. ➤ Mosinvestimi në përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike mund të pengojë zhvillimin ekonomik dhe social. ➤ Pabarazia në zhvillim urban-rural: Zhvillimi i pabalancuar mund të çojë në polarizim social dhe ekonomik midis qytetit dhe fshatrave. ➤ Degradimi i zonave rurale: Nëse nuk investohet në përmirësimin e jetesës në fshatra, cilësia e banimit do të përkeqësohet edhe më tej, duke çuar në boshatisje dhe humbje të potencialeve zhvillimore.



3.9. SHFRYTËZIMI I TOKËS

Komuna e Klinës ka një sipërfaqe totale prej 30,869.01 ha, nga e cila 34.94% janë pyje dhe kullosa, 47.02% janë tokë bujqësore, 10.65% banim i përhershëm, 3.05% rrjet i transportit, 0.13% industri dhe pjesa tjetër e territorit të komunës shfrytëzohet nga kategori të tjera.

Kategoritë e shfrytëzimit të tokës në komunë janë: Bujqësi, Pylltari, Vendbanime, Zonat të Veçanta të mbrojtura, Komerciale, Rekreative-turistike, Komunikacionit dhe transportit, Sipërfaqe ujore, Industri, Shërbime të komunitetit, Sipërfaqe minierë-Gurore.

Sfidat kryesore për sa i përket shfrytëzimit të tokës kanë të bëjnë me zhvillimin e pakontrolluar të ndërtimit nëpër vendbanime si dhe humbjet e tokës bujqësore nga ndërtimet e objekteve të banimit dhe atyre të afarizmit. Tutje; zhvillimi i vendbanimeve është bërë edhe jashtë kufijëve ndërtimor të përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal 2014-2021+ edhe përkundër faktit që kufijtë ndërtimorë kishin lejuar hapësira më se të mjaftueshme për zhvillimet e ardhshme. Në këtë kontekst kemi vendbanime të cilët nuk janë zhvilluar brenda kufijëve ndërtimor edhe përkundërt hapësirës së lirë të mjaftueshme, por kanë dalur jashtë atyre kufijëve. Zgjerimi i vendbanimeve është rezultat i trendeve të zhvillimit të fundit socio-ekonomik në nivel të komunës në përgjithësi dhe vendbanimeve në veçanti. Në komunën e Klinës dendësia e banimit është e ulët, që do të thotë se indeksi i shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës është i madh në krahasim me numrin e popullsisë. Kjo tregon për jo-racionalitetin e shfrytëzimit të tokës e që bie ndesh me interesin e zhvillimit ekonomik në komunës, përkatësisht me zhvillimin e bujqësisë.

Përveç faktit që në tokat e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë janë zhvilluar ndërtime, edhe Zona Industriale në Klinë por edhe zonat tjera industriale të propozuara me HZK 2020-2028+ janë propozuar pikërisht në sipërfaqe të cilat i takojnë cilësisë së lartë të tokës (Klasat I-IV të bonitetit). Kështu, Zona Industriale në Nagllavkë, është propozuar të zhvillohet në tokë bujqësore të klasit II; Zona Industriale në Pograxhë është propozuar të ndërtohet në tokë bujqësore të klasit I dhe II. Sa i përket projeksioneve të PZHK 2014-2021+ për shfrytëzimin e tokës, është evidente se kufijtë ndërtimorë kanë qenë më se të mjaftueshëm për zhvillimet pasuese. Kjo duke u nisur nga fakti se shumë hapësira brenda këtyre kufijëve ndërtimor kanë mbetur të pandërtuara. Ndërsa një zhvillim sfidues në këtë fushë ka të bëjë me faktin se një pjesë e tokës jashtë këtyre kufijëve ndërtimor tashmë është mbuluar me ndërtime.



S.W.O.T. ANALIZA PËR SHFRYTËZIMIN AKTUAL TË TOKËS

PËRPARËSITË	DOBËSITË
➤ 47.02% e tokës është bujqësore, e cila ofron mundësi për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të bujqësisë. ➤ Pjesa e konsiderueshme e pyjeve dhe kullosave (34.94%) ofron potencial për zhvillim të qëndrueshëm dhe menaxhim të burimeve natyrore. ➤ Diversiteti në kategoritë e shfrytëzimit të tokës (komerciale, rekreative, etj.) lejon zhvillim të shumëanshëm ekonomik. ➤ Plani Zhvillimor Komunal 2014-2021+ ofron një kornizë për menaxhimin e shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit të infrastrukturës.	➤ Ndërtimi i pakontrolluar në vendbanime ka sjellë humbje të tokës bujqësore dhe zhvillim jashtë kufijëve të përcaktuar. ➤ Dendësia e ulët e banimit në raport me sipërfaqen e madhe të tokës sugjeron një shfrytëzim joefikas. ➤ Zhvillimi i vendbanimeve jashtë kufijëve ndërtimor ka shkaktuar sfida në menaxhimin e territorit. ➤ -Humbja e Tokës Bujqësore
MUNDËSITË	RREZIQET
➤ Investimet në bujqësi dhe menaxhimin e resurseve natyrore mund të ndihmojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunës. ➤ Mundësia për të përmirësuar infrastrukturën dhe shërbimet në zonat e veçanta mund të rrisë atraktivitetin për investitorët. ➤ Shtimi i popullsisë krijon kërkesë për më shumë banesa dhe shërbime, duke ofruar mundësi për zhvillim të ri. ➤ Potenciali për zhvillimin e turizmit rekreativ dhe ekologjik në zonat e mbrojtura.	➤ Kërcënimi i zhvillimit të pakontrolluar mund të rezultojë në humbje të mëtejshme të tokës bujqësore dhe shkelje të ligjeve të planifikimit. ➤ Zhvillimi i zonave ekonomike mbi tokat e klasës së lartë mund të dëmtojë sektorin bujqësor. ➤ Njohuritë e pamjaftueshme për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës mund të shkaktojnë probleme në implementimin e politikave. ➤ Ndryshimet klimatike dhe ndikimet negative mjedisore mund të ndikojnë në produktivitetin bujqësor dhe shfrytëzimin e përgjithshëm të tokës.



4.KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINORË

Korniza e Zhvillimit Hapësinor të Komunës së Klinës paraqet zhvillimet e planifikuara dhe orientimet e zhvillimit socio-ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor në të ardhmen. Caqet e zhvillimit afatgjatë janë përcaktuar përmes një bashkëpunimi dhe pjesëmarrje në diskutime e debate gjithëpërfshirëse, ndërsa e gjithë kjo është realizuar në bazë të vlerësimit të gjendjes ekzistuese të komunës, S.W.O.T analizës si dhe kapaciteteve zhvillimore dhe investuese të komunë

4.1. VIZIONI

Gjatë formulimit të vizionit për komunën e Klinës është marrë parasysh edhe Planit Hapësinor i Kosovës, i cili parasheh territorin e komunës si pjesë të tërësisë **“Kopshti i Kosovës** (Hapësira e portokalltë) - kulturore-turistike, shërbyese tregtare, agro-industriale-Kjo hapësirë zë pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Kosovës, shtrihet në luginën e pëlleshme të Dukagjinit, përgjatë kufirit me Bjeshkët e Nemuna, në luginën e Lumëbardhit, me afro 300.000 banorë, klimë kontinentale e klimë mesdhetare dhe me një rrjet hidrografie të zhvilluar. Komunitat që e përbëjnë këtë zonë janë: Peja, Istogu dhe Klina”

Po ashtu, është marrë parasysh edhe vizioni e Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021+.

Bazuar në vizionin e PHK-së, vizionin e Planit Zhvillimor Komunal 2014-2021+ si dhe në nevojat dhe trendet e planifikuara të zhvillimit në komunë, synim kryesor i Planit Zhvillimor Komunal të Klinës për periudhën 2025-2033 është që përmes strategjive të përcaktuara sektoriale, brenda 8 viteve të ardhshme të arrihet ky vizion i komunës:

DEKLARATA E VIZIONIT

“Komuna e Klinës – një komunë kompakte dhe e qëndrueshme me zhvillim të balancuar hapësinor dhe socio-ekonomik, trashëgimi të pasur kulturore, qendër rajonale e zhvillimit bujqësor, me ekonomi të bazuar në bujqësi dhe industri përpunuese, turizëm kulturor e natyror, si dhe nyje e rëndësishme e transportit rajonal, me shfrytëzim të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe një komunitet gjithëpërfshirës, mikpritës dhe aktiv.”



4.2. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

4.2.1. Qëllimet dhe objektivat e veçanta

Tek qëllimet dhe objektivat zhvillimore për komunën e Klinës janë adaptuar dhe integruar edhe Objektivat Zhvillimore të Agjendës së Kombeve të Bashkuara për vitin 2030, përkatësisht janë adaptuar Objektivat e Zhillimit të Qëndrueshëm (SDG) të përcaktuara nga OKB.

Agjenda e vitit 2030 është një kornizë globale 15-vjeçare e përqendruar në 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Sustainable Development Goals), 169 synime dhe mbi 230 tregues.

Kjo agjendë synon një mjedis pa varfëri dhe uri, me arsim cilësor, mbulim shëndetësor universal, arritje të barazisë gjinore dhe fuqizim të grave dhe vajzave, dhe me një mjedis të qëndrueshëm, ndërsa 17 Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm janë si vijon:

Objektivi 1: Eliminimi i varfërisë në të gjitha format kudo.

Objektivi 2: Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe përmirësimit të ushqyerjes dhe nxitja e bujqësisë së qëndrueshme.

Objektivi 3: Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe.

Objektivi 4: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë.

Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Objektivi 6: Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë.

Objektivi 7: Sigurimi i lidhjes me energji të përbalueshme, të sigurt, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë.

Objektivi 8: Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë.

Objektivi 9: Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit.

Objektivi 10: Zvogëlimi i pabarazisë brendapërbrenda vendeve dhe mes tyre.

Objektivi 11: Kthimi i qyteteve dhe vendbanimeve në gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, rezistues dhe të qëndrueshëm.

Objektivi 12: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të konsumit dhe prodhimit.

Objektivi 13: Marrja e masave për të luftuar ndryshimin klimatik dhe efektin e tij.

Objektivi 14: Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i oqeanëve, deteve dhe burimeve detare për zhvillimin e qëndrueshëm.

Objektivi 15: Mbrojtja, restaurimi dhe nxitja e përdorimit të qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore, administrimi i qëndrueshëm i pyjeve, lufta kundër kthimit të hapësirave në shkretëtirë dhe ndalimi dhe kthimi pas i procesit të degradimit të tokës dhe ndalimi i humbjes së biodiversitetit.

Objektivi 16: Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

Objektivi 17: Fuqizimi i mjeteve të vënies në zbatim dhe rigjallërimi i partneritetit botëror për zhvillim të qëndrueshëm.



Figura 9. Objektivat e Zhvillim të Qëndrueshëm, të përcaktura nga OKB



4.2.2. Qëllimet dhe objektivat sipas fushave tematike

Objektivat e propozuara me këtë PZHK janë Specifike, të Matshme, të Arritshme, Reale dhe të lidhura për afate të caktuara kohore. Përmes realizimit të këtyre objektive synohet një zhvillim i qëndrueshëm hapësinor, socio-ekonomik, infrastrukturor dhe mjedisor i Komunës së Klinës.

Infrastruktura Publike (Arsimi, Shëndetësia dhe Administrata publike)

Infrastruktura publike në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe administratës publike në komunë ka kapacitete për të ofruar shërbimet përkatëse, por këto kapacitete duhet plotësuar dhe kërkohet një shpërndarje më e balancuar si dhe ngritje e cilësisë dhe e mirëmbajtjes. Për të arritur nivel të kënaqshëm të funksionimit, e gjithë infrastruktura publike duhet të përmirësohet sipas qëllimeve dhe objektive të paraqitura në vijim:

Arsimi

Infrastruktura e arsimit në komunë është relativisht e mirë si për nga numri i shkollave, aspektit fizik, si dhe qasjes në arsim. Vetëmse kemi hapësirë jo të mjaftueshme dhe numër të vogël të çerdheve/kopshteve dhe përfshirje jo të mjaftueshme të fëmijëve në këtë nivel shkollimi. Kërkohet edhe një balancim i hapësirave shkollore për shkollimin fillor. Një tjetër mangësi është edhe arsimi profesional i cili nuk është i ndërlidhur me tregun e punës. Komuna e Klinës duhet të angazhohet në arritjen e qëllimeve dhe objektive vijuese:

Qëllimi 1: Cilësi dhe gjithëpërfshirje në arsim

01.1: Qerdhe të reja në qytetin e Klinës dhe në vendbanimet me mbi 1500 banorë si: Dresnik, Gllarevë, Jashanicë, Sferkë dhe në Zllakuqan deri në vitin 2029.

01.2: Zgjerimi i hapësirave shkollore dhe ndërtimi i hapësirave të reja për shkollimin fillor dhe të mesëm të lartë deri në vitin 2033

01.3: Rindërtim dhe Rinovim i shkollave fillore deri në vitin 2033

01.4: Salla sportive në shkollat me numër më të madh të nxënësve deri në vitin 2033 (“Motrat Çiriazit” në Klinë; “Dëshmorët e Qëndresës” në Gllarevë; “Emin Duraku” në Sferkë; Zllakuqan;

01.5: Përfshirja e nxënësve në arsim profesional deri në vitin 2028, me fokus te vecant në fushat prioritare për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të Klinës

01.6: Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësimdhënësve përmes trajnimeve

Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale

Shëndetësia si për nga infrastruktura ashtu edhe për nga shërbimet është në nivel të kënaqshëm përveç në zonat më të thella. Krahës numrit të banorëve, kemi hapësirë të mjaftueshme të shërbimeve shëndetësore në komunën e Klinës, por kërkohet mirëmbajtja e tyre dhe ngritja e nivelit të shërbimeve.

Mirëqenia sociale ka nevojë të përmirësohet dukshëm në shumë drejtime, si në përkujdesjen e organizuar për të moshuarit, zbutjen e varfërisë dhe papunësisë etj.



Qëllimi 2: Ngritja e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale

O2.1: Përmirësimi i shërbimeve shëndetësore, Avancimi i Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) dhe platformave tjera digjitale për shëndetësi deri në vitin 2033

O2.2: Përmirësimi i kujdesit dhe kushteve të jetesës së familjeve nën kujdesin social

O2.3: Decentralizim i shërbimeve administrative përmes e-kiosqeve

Administrata Publike

Administrata publike ka një hapësirë të mjaftueshme marrë në nivel të komunës dhe në krahasim me numrin e popullsisë. Është me rëndësi që të kemi një decentralizim të shërbimeve administrative dhe ngritje të nivelit të këtyre shërbimeve. Komuna në këtë aspekt duhet të angazhohet për të arritur qëllimin dhe objektivat vijuese:

Qëllimi 3. Administratë efikase

O3.1: Decentralizim i shërbimeve administrative përmes e-kiosqeve deri në vitin 2033

O3.2: Përmirësimi i kushteve dhe ngritja e shërbimeve administrative deri në vitin 2033

O3.3: Ofrimi i shërbimeve administrative në formë elektronike – e-administrata deri në vitin 2029

Infrastruktura sociale (kultura, sporti, hapësirat publike, varrezat)

Kapacitetet e hapësirave të bibliotekës, shtëpisë së kulturës dhe hapësirave sportive janë të pamjaftueshme në komunën e Klinës si dhe ka një koncentrim vetëm në qytetin e Klinës. Kërkohej që të krijohen hapësira të reja të infrastrukturës sociale, decentralizimi i tyre si dhe përmirësimi i ofrimit të shërbimeve. Për të arritur këtë janë hartuar Qëllimet dhe Objektivat si më poshtë:

Qëllimi 4. Sigurimi i infrastrukturës adekuate sociale dhe mirëmbajtja e saj

O4.1: Ndërtimi i objekteve të reja të kulturës dhe artit për të gjithë banorët e komunës së Klinës - sipas Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor - deri në vitin 2033: (Teatër i Hapur, Shtëpia e Kulturës & Teatri, Galeria dhe Ansambli në Dresnik ose në Dollc.

O4.2: Sigurimi i infrastrukturës për art, sport dhe rekreacion në gjithë territorin e komunës, sipas Normave Teknike të Planifikimit Hapësinor, deri në vitin 2033;

O4.3: Rregullimi, rehabilitimi i hapësirave ekzistuese dhe shtimi i hapësirave të reja publike dhe vendosja e shtatoreve dhe përmendoreve në komunën e Klinës - deri në vitin 2033;

O4.4: Mirëmbajtja e vazhdueshme e hapësirave publike, varrezave dhe objekteve të religjionit.

Veprim konkret: Rrethim i varrezave dhe objekteve të religjionit në tërë territorin e komunës.

Zgjerim dhe rregullim i hapësirës së varrezave (Carravik, Deiq (varrezat muslimane dhe varrezat katolike), Petriq i Epërm, Qeskovë, Grabanicë, Volljak).

Qëllimi 5. Promovimi i artit, sportit dhe kulturës

O5.1: Stimulimi i të rinjve për aktivitete sportive;

O5.2: Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe artistike

Qëllimi 6. Ndërtimi i hapësirave të reja të gjelbërta dhe publike

O6.1: Ndërtimi i tri parqeve të reja publike

O6.2: Ndërtimi i liqenit akumulues



Zhvillimi Ekonomik

Qëllimet dhe Objektivat për Zhvillim Ekonomik janë hartuar në atë mënyrë që të arrihet një zhvillim i balancuar ekonomik, i bazuar në shfrytëzimin e resurseve dhe potencialit real zhvillimor dhe që u jep mundësi të barabarta të gjithë qytetarëve të komunës- pra të sigurojë gjithëpërfshirje. Ky zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duhet të gjithashtu të mundësoj punësim të qëndrueshëm, diversifikim edhe më të madh të aktivitetit ekonomik, si dhe maksimalizim të profitit dhe efikasitetit në punë.

Qëllimi 7: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve dhe potencialit real zhvillimor si dhe diversifikim të aktiviteteve ekonomike

O7.1: Shfrytëzimi racional i resurseve njerëzore dhe natyrore si dhe shfrytëzimi i potencialit real zhvillimor, sidomos në Bujqësi, Industri Bujqësore dhe Përpunuese si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor

O7.2: Përkrahja e shtimit të aktiviteteve ekonomike dhe rritjes së punësimit në sektorët ekzistues e sidomos në sektorët e targetuar si bartës të zhvillimit të ri ekonomik (Bujqësi, Industri Bujqësore dhe Përpunuese, Tregti me Shumicë dhe Pakicë, Akomodim dhe Hoteleri, Shërbime si dhe Turizëm Natyror, Rural dhe Kulturor), duke u bazuar në Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal.

O7.3: Përkrahja e shtimit të aktiviteteve ekonomike dhe rritjes së punësimit në sektorët tjerë me potencial punësimi të qëndrueshëm si: TI (Teknologjia e Informacionit) dhe Ekonomia Hibrde (Remote ëorking).

O7.4: Ngritja e kapaciteteve komunale për qasje në fondet zhvillimore lokale dhe ndërkombëtare

O7.5: Nxitja e rritjes së eksportit të produkteve vendore.

Qëllimi 8: Orientimi i zhvillimit ekonomik drejt ekonomisë së bazuar në Bujqësi dhe Blegtori, Industri Bujqësore dhe Përpunuese, si dhe Shërbime.

O8.1: Hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Integruar të Bujqësisë dhe Industrisë Bujqësore.

O8.2: Zhvillimi i Bujqësisë Intenzive përmes orientimit të investimeve publike në këtë sektor si dhe përmes shtimit të subvencioneve nga Komuna.

O8.3: Përkrahja e vazhdueshme e NVM-ve me fokus të vecantë në bujqësi dhe blegtori

O8.4: Përkrahje e zejtarisë dhe sektorëve tjerë të marginalizuar ekonomik, përmes masave stimuluese, infrastrukturës dhe promovimit publik.

Qëllimi 9: Ndërlidhja e Arsimit me Ekonominë dhe zhvillimi i “Mësimi Gjatë Tërë Jetës”

O9.1: Sinkronizimi i programeve arsimore në shkollat profesionale me potencialin real dhe nevojat për zhvillim ekonomik (Bujqësi, Industria Bujqësore dhe Industria e Lehtë Përpunuese, Hoteleria, Shërbimet, Turizmi, IT)

O9.2: Përkrahja e “Mësimi Gjatë Tërë Jetës” përmes platformave për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, me fokus në sektorët primar për zhvillim ekonomik.

O9.3: Bashkëpunimi me Qendrën e Punësimit, për intensifikimin e aktiviteteve të aftësimi profesional.



Qëllimi 10: Rritja e Punësimit përmes Përkrahjes së NVM-ve, Start-Up dhe Inovacionit

O10.1: Rritja e punësimit përmes përkrahjes së krijimit të ndërmarrjeve të reja NVM, sidomos në sektorët primarë ekonomik, përmes politikave stimuluese për ndërmarrësit e rinjë;

O10.2: Themelimi i një Programi të Veçantë për Start-Up për përkrahje ndaj krijimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve Start-Up, sidomos në sektorët primar ekonomik.

O10.3: Themelimi i Qendrës për Start-Up, IT dhe Inovacion në Klinë, për të ndihmuar ndërmarrjet e reja dhe ato ekzistuese me infrastrukturë hulumtuese dhe logjistike.

O10.4: Nxitja e krijimit të së paku 50 bizneseve të qëndrueshme në vit

Qëllimi 11: Luftimi i informalitetit dhe zbutja e pabarazive në zhvillim ekonomik

O11.1: Luftimi i informalitetit në ekonomi përmes formalizimit të të gjitha aktiviteteve ekonomike dhe të punësuarve në komunën e Klinës.

O11.2: Luftimi i diskriminimit në punësim në baza gjinore si dhe në baza tjera diskriminuese.

O11.3: (Gjithë) përfshirja në punësim e personave me nevoja të vecanta dhe e grupeve tjera të marginalizuara.

O11.4: Luftimi i zhvillimit të pabalancuar ekonomik përmes sigurimit të shtrirjes së balancuar të investimeve dhe kapitalit.

Qëllimi 12: Rritja e pjesëmarrjes së sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në relacion me sektorët tjerë ekonomik

O12.1: Krijimi, funksionalizimi, mirëmbajtja dhe përditësimi i vazhdueshëm i Databazës Bujqësore, duke përfshirë parcelat kadastrale të tokës bujqësore, tokën e punëshme bujqësore, fermat, fermerët dhe kapacitetet e tyre, fondin blegtoral etj.

O12.2: Ruajtja strikte e tokës bujqësore me bonitet të lartë (I-IV) si dhe burimeve tjera natyrore përmes kontrollit rigoroz të respektimit të kufijëve ndërtimor dhe zbatimit të masave tjera sipas legjislacionit në fuqi.

O12.3: Rregullimi i shtretërve të lumenjëve për të parandaluar vërshimet dhe dëmet në bujqësi dhe amvisëri përmes pastrimit të lumenjëve dhe rregullimi i argjinaturave të lumnjëve.

O12.4: Shtrirja e rjetit të ujitjes në sipërfaqet e targetuara me planin e ardhshëm për zhvillimin e bujqësisë

O12.5: Ruajtja, shtimi (përmes pyllëzimit dhe ri-pyllëzimit) dhe zhvillimi i qëndrueshëm i sipërfaqeve pyjore

O12.6: Zhvillimi i Industrisë Bujqësore dhe asaj Përpunuese përmes programeve promovuese – mbështetëse për qumeshtoret dhe fabrikat tjera të industrisë bujqësore.

O12.7: Stimulimi i vazhdueshëm dhe subvencionimi i prodhuesve bujqësor për prodhimin bimor dhe prodhimin shtazor.

O12.8: Identifikimi dhe ndërtimi i vendgjuetive në komunën e Klinës.

Qëllimi 13: Orientimi i zhvillimit ekonomik drejt Turizmit Natyror, Rural dhe Kulturor

O13.1: Shfrytëzimi i potencialeve për Turizëm Natyror dhe Rural, sidomos në Zonën e Mirushës, Dushit, Ujëmirit, Pograxhes etj. duke hartuar Strategjinë Komunale për Zhvillimin e Integruar të Turizmit si dhe përmes investimeve në infrastrukturë, kapacitete turistike, promovimit si dhe përkrahjes së sektorit të shërbimeve të ndërlidhura me turizmin natyror dhe rural;

O13.2: Shfrytëzimi i potencialeve për Turizëm Kulturor, sidomos në Budisavc, Çabiq, Mirushë, Ujëmirë, Dresnik, Dollc etj., duke hartuar Strategjinë Komunale për Zhvillimin e Integruar të



Turizmit si dhe përmes investimeve në infrastrukturë, kapacitete turistike, promovimit si dhe përkrahjes së sektorit të shërbimeve të ndërlidhura me turizmin kulturor;

O13.3: Promovimi i turizmit rekreativ të zonës së Klinës;

O13.4: Inventarizimi i detajizuar i Aseteve Turistike dhe Potencialit Turistik të Komunës së Klinës, si dhe dixhitalizimi i këtij inventari, deri në vitin 2033.

Infrastruktura Rrugore dhe Teknike

Qëllimet dhe Objektivat për këtë pjesë janë hartuar në atë mënyrë që të krijohet infrastrukturë e qëndrueshme dhe me kapacitete të mjaftueshme për t'i absorbuar kërkesat e popullsisë aktuale si dhe asaj të projektuar deri në vitin 2031 (2025-2033). E gjithë kjo duhet të ndihmojë në rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve në gjithë territorin e komunës:

Qëllimi 14: Rrugë kualitative, qasje për të gjithë përdoruesit dhe transport publik për të gjithë banorët

O14.1: Ndërtimi i rrugëve kualitative për akomodimin e të gjithë përdoruesëve (automjete, këmbësor, biçiklistë), deri në vitin 2033.

O14.2: Rregullimi i trotuareve sipas standardeve për të gjitha rrugët që kalojnë në zona të banuara, deri në vitin 2033.

O14.3: Rregullimi i shtigjeve të biçiklistëve në qytetin e Klinës dhe zonat në afërsi, deri në vitin 2033.

O14.4: Ndërtimi dhe rregullimi i veprimtarisë së parkingjeve brenda qytetit të Klinës, deri në vitin 2026.

O14.5: Përfshirja e zonave të banuara në linjat e transportit publik, deri në vitin 2033.

O14.6: Rregullimi i vendndalimeve të transportit publik duke filluar nga qyteti i Klinës dhe zonat e banuara, deri në vitin 2033.

O14.7: Rregullimi i kalimeve hekurudhore në pjesët e rrugës ku kalimi është në nivel, deri në vitin 2026.

O14.8: Ndërtimi i mbikalimeve/nënkalimeve për këmbësor në fshatrat që ndikohen nga rruga nacionale N2, deri në vitin 2028.

O14.9: Rregullimi i qasjes së rrugës në kryqëzimin me rrugën nacionale N2, nga qyteti i Klinës, deri në vitin 2027.

Infrastruktura Teknike

Qëllimet dhe Objektivat për këtë pjesë janë hartuar në atë mënyrë që të krijohet infrastrukturë e qëndrueshme dhe me kapacitete të mjaftueshme për t'i absorbuar kërkesat e popullsisë aktuale si dhe asaj të projektuar nga 2024-2033. E gjithë kjo duhet të ndihmojë në rritjen e cilësisë së jetesës së qytetarëve në gjithë territorin e komunës.

Investimet në infrastrukturën teknike do të bëhen duke u mbështetur në buxhetin e investimeve kapitale të komunës, projektet e bashkë-financuara me qeverinë si dhe mbështetja potenciale nga donatorët.

Rritja e vazhdueshme e buxhetit për investime kapitale (Nga 4 Milionë Eur. sa ishte në vitin 2022, në 4,6 Milionë Eur. në vitin 2024) tregon në progresin e vazhdueshëm në këtë komponentë.



Qëllimi 15: Përmirësimi i sistemit aktual dhe ndërtimi i sistemit të ujit të pijes për vendbanimet periferike.

O15.1 Shtirja e rrjetit të ujësjellësit në vendbanimet periferike deri në vitin 2033.

O15.2 Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit në lagjet periferike të zonës urbane dhe rurale me qëllim të zvogëlimit të humbjeve, deri në vitin 2033.

O15.3 Kontrolli i vazhdueshëm i kualitetit të ujit të pijes.

O15.4 Paisja e sistemit të pompimit me energji solare

O15.5 Shtimi i dy sistemeve të reja të ujësjellësit

O15.6: Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në vendbanime të cilat aktualisht nuk kanë qasje

O15.7: Mirembajtja e shtuar e sistemit ekzistuese me fokus të veçantë në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Qëllimi 16: Trajtimi i ujrave të zeza dhe ujërave atmosferike

O16.1: Shtrirja e rrjetit të kanalizimit në vendbanimet periferike

O16.2: Koncentrimi i të gjitha ujërave të zeza në dy kolektorë kryesorë në dy anët e lumit Drini i Bardhë.

O16.3. Përmirësimi dhe rehabilitimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit

O16.4: Ndërtimi i gropave septike

O16.5: Lidhja e rrjetit të kanalizimit në impiantin regional për trajtimin e ujërave të zeza

O16.6: Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujrave të zeza në Kpuz

Qëllimi 17: Shtrirja e rrjetit të kanalizimeve për ujëra atmosferike

O17.1: Shtrirja e rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në të gjitha vendbanimet rurale

O17.2: Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat e bardha në zonën urbane.

Energjia dhe Telekomunikacioni

Energjia

Qëllimi 18: Përmirësimi i rrjetit energjetik

O18.1: Përmirësimi i rrjetit energjetik në të gjithë komunën

O18.2: Rritja e kapaciteteve të trafostacioneve ekzistuese përmes veprimve konkrete si më poshtë:

- Rritje e fuqisë instaluese prej 40 MVA për nënstacionin 110/10kV/kV të Klinës dhe nënstacionin 35 /10 kV/kV)
- Zgjerim i rrjetit elektroenergjetik për ndërtimet e larta në qytetin e Klinës me fuqi instaluese transformatorike 2x4MVA
- Zgjerim i rrjetit elektroenergjetik në Zonën Ekonomike me fuqi transformatorike 2x4 MVA. Ky rrjet do të ketë dy dalje 10 kV në Zonën Urbane (Zona Urbane 1 dhe Zona Urbane 2) si dhe dy dalje 10 kV në Zonën Ekonomike (Zona Industriale 1 dhe Zona Industriale 2)

O18.3: Përcaktimi i lokacioneve të përshtatshme për ndërtimin e një trafostacioni të ri 110/10(20) si dhe trafostacioneve të reja 10/0.4 kV, bazuar në analizën e nevojave të ardhshme për energji elektrike, deri në vitin 2028.



Qëllimi 19: Orientimi drejt diversifikimit të burimeve të energjisë

O19.1: Eksplorimi i vazhdueshëm i potencialit për burime të ripërtërishme të energjisë dhe shfrytëzimi i potencialit aktual për ER

Ndriçimi Publik

Qëllimi 20: Ndriçimi publik i rrugëve dhe investimi në sistem eficient të ndricimit publik

O20.1: Ndriçimi publik i rrugëve në të gjithë zonën urbane si dhe zonat qendër të vendbanimeve tjera, deri në vitin 2028.

O20.2: Orientimi drejt energjisë së ripërtërithme / kalimi në sistem eficient të ndricimit publik, deri në vitin 2033.

Interneti

Qëllimi 21: Shtrirja e internetit në të gjitha vendbanimet

O21.1: Qasje në rrjetin e internetit për të gjithë, deri në vitin 2033.

Telefonia Fikse

Qëllimi 22: Shtrirja e telefonisë fikse dhe ngritja e cilësisë së komunikimit në të gjitha institucionet publike dhe komunale

O22.1: Qasje në rrjetin e telefonisë fikse dhe rritje e cilësisë së shërbimit për të gjitha institucionet publike dhe komunale

Mjedisi dhe Sipërfaqet me Rrezikshmëri

Qëllimi 23: Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve mjedisore (uji, toka, ajri)

O23.1: Stimulimi i prodhimit dhe shfrytëzimit të energjisë alternative deri në vitin 2033

O23.2: Promovimi i vazhdueshëm i mobilitetit jo-motorik

O23.3: Mbrojtja e veçantë për burimet ujore deri në vitin 2033

O23.4: Trajtimi i vazhdueshëm i ujërave të zeza deri në vitin 2033

O23.5: Inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës deri në vitin 2026

O23.6: Revitalizimi i vazhdueshëm i ekosistemeve të degraduara në Komunen e Klinës deri në vitin 2033

O23.7: Mbrojtja e vazhdueshme e tokës bujqësore nga ndotja dhe degradimi si dhe ndërmarrja e masave për ruajtje dhe përmirësim të plleshmërisë

O23.8: Monitorimi dhe rritja e cilësisë së ajrit në tërë territorin e komuës

O23.9: Promovimi i sistemeve të riciklimit.

Qëllimi 24: Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore

O24.1: Marrja e masave dhe hartimi i politikave për mbrojtje ndaj rrezikut nga fatkeqësitë natyrore deri në vitin 2033

Qëllimi 25: Ri-organizim i sistemit të Menaxhimit dhe Riciklimit të Mbeturinave, deri në vitin 2033.

O25.1: Shtimi i kapacitete të grumbullimit të mbeturinave dhe promovimi i vazhdueshëm i sistemeve të riciklimit.

Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore



Qëllimi 26: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore për zhvillim të qëndrueshëm

O26.1: Konservimi dhe promovimi i vazhdueshëm i aseteve të trashëgimisë kulturore deri në vitin 2033

O26.2: *Promovimi i aseteve të trashëgimisë kulturore në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm deri në vitin 2026*

Qëllimi 27: Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore për zhvillim të qëndrueshëm

O27.1: Konservimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe peizazhit

O27.2: Promovimi i aseteve të trashëgimisë natyrore në funksion të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm

Banimi, Vendbanimet

Qëllimi 28: Krijimi i kushteve për zhvillimin e banimit cilësor e të qëndrueshëm

O28.1: Përmirësimi dhe zhvillimi i infrastrukturës për banim të qëndrueshëm dhe cilësor deri në vitin 2033

O28.2: Rritja e proporcionit të banimit kolektiv deri në 2033

O28.3: Trajtimi i ndërtimeve pa leje deri në vitin 2026

O28.4: Ndërtime cilësore sipas standardeve të aplikueshme

Qëllimi 29. Shtrirja e vendbanimeve sipas parimit të kompaktësisë dhe multifunksionalitetit

O29.1: Shfrytëzimi racional i tokës ndërtimore

O29.2: Rikonstruktimi i rrjeteve ekzistuese dhe zhvillimi i rrjeteve të reja infrastrukturore me koncepte të efijencës dhe shfrytëzimit racional të resurseve, deri në vitin 2033.

O29.3: Kompletimi i të gjithë infrastrukturës bazike teknike (rrugë, ujësjellës, kanalizim, furnizim stabil me energji elektrike, internet, hapësira publike dhe të gjelbërta, ndricim publik etj.) në të gjitha vendbanimet e komunës, deri në vitin 2033.

O29.4: Rritja e cilësisë së shërbimit në infrastrukturën bazike teknike (rritja e efijencës, minimalizimi i humbjeve në rrjet, rritja e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve sipas standardeve të aplikueshme etj.).

Shfrytëzimi i Tokës

Qëllimi 30. Shfrytëzim racional i tokës dhe konsolidim i tokës bujqësore të klasit I-IV

O30.1: Implementimi i konceptit të zhvillimit hapësinor të përcaktuar me këtë PZHK

O30.2: Aplikimi i modelit të qytetit dhe vendbanimit kompakt

O30.3: Ruatja strikte dhe konsolidimi i tokës bujqësore



4.3. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Koncepti i Zhvillimit Hapësinor për Komunën e Klinës është formuluar mbi bazën e analizave të detajuara të gjendjes aktuale, vizionit të përgjithshëm të zhvillimit të qëndrueshëm dhe objektivave të përcaktuara për çdo sektor specifik. Ky proces ka marrë në konsideratë dokumentet strategjike në nivel lokal dhe kombëtar, duke përfshirë edhe direktivat për zhvillim hapësinor.

Në përgatitjen e këtij koncepti, Komuna e Klinës ka pasur si synim që plani të jetë i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm nga të gjithë aktorët e përfshirë në procesin e planifikimit. Prandaj, është siguruar që struktura e dokumentit të përmbajë të dhëna të sakta dhe të mjaftueshme për t'u përdorur si udhëzues kryesor për zhvillimin hapësinor. Ekipi teknik i komunës, së bashku me ekspertët e jashtëm, ka përgatitur këtë koncept në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet teknike të nevojshme.

Ky koncept përcakton drejtimet kryesore për përdorimin e qëndrueshëm të hapësirës në komunë, dhe do të jetë baza për vendimmarrjen lidhur me zhvillimin e ardhshëm urban dhe rural, duke u reflektuar në mënyrë të qartë në Hartën Zonale të Komunës së Klinës.

Komuna synon të zhvillohet në mënyrë të balancuar, duke përfshirë sektorë si banimi, industria dhe turizmi, gjithnjë duke pasur parasysh harmonizimin me mjedisin, shëndetin publik dhe sigurinë e komunitetit. Për të arritur këtë, zhvillimi hapësinor bazohet në disa parime kryesore, të tilla si:

- Rritje dhe decentralizim të administratës publike
- Menaxhim i qëndrueshëm i burimeve natyrore dhe tokës bujqësore
- Infrastruktura moderne dhe e integruar
- Zhvillim ekonomik të balancuar dhe të qëndrueshëm
- Mbështetje për vendbanime kompakte dhe të organizuara mirë
- Ruajtje dhe promovim të një mjedisi të pastër dhe atraktiv

4.3.1. Skenarët e propozuar hapësinor

Përgatitja e skenarëve hapësinor për Komunën e Klinës është një metodë e rëndësishme në procesin e planifikimit strategjik, e cila synon të vlerësojë skenarë të ndryshëm zhvillimi për të ardhmen. Kjo përfshin parashikimin e situatave të ndryshme të mundshme dhe përcaktimin e drejtimeve që do të kontribuonin në arritjen e objektivave të zhvillimit. Skenarët marrin në konsideratë pasojat e mundshme të vendimeve dhe veprimeve, duke ndihmuar në analizën e proceseve që ndikojnë në zhvillimin hapësinor të komunës.

Në kuadër të këtyre skenarëve, janë shqyrtuar aspektet pozitive dhe negative të secilit skenar dhe janë analizuar faktorët kyç që ndikojnë në zhvillimin e ardhshëm të Klinës. Urbanizimi në këtë kontekst shihet si një proces dinamik që ndikohet nga faktorë ekonomikë, socialë dhe politikë, si dhe nga zhvillimi i infrastrukturës dhe investimet publike, të cilat shtyjnë përpara zhvillimin urban dhe rural.

Shtrirja urbane, e nxitur nga rritja e popullsisë dhe zhvillimi ekonomik, sjell ndryshime të konsiderueshme në përdorimin e tokës dhe mbulueshmërinë e saj. Ekipi i planifikimit të Komunës së Klinës, së bashku me ekspertët e jashtëm, kanë vlerësuar potencialin e zhvillimit përmes disa skenarëve të mundshëm, duke u mbështetur në analizat e detajuara të gjendjes aktuale.

Të tre skenarët përmbajnë një qasje të përgjithshme për zhvillimin e qëndrueshëm të Klinës, duke marrë parasysh karakteristikat specifike të territorit dhe duke synuar të balancojnë nevojat e zhvillimit urban me ruajtjen e integritetit mjedisor dhe rural.



4.3.1.1. Skenari 0 - Trendi aktual me zhvillim monocentric

Pikat e favorshme: Komuna e Klinës ka vazhduar të zhvillohet kryesisht rreth qendrës urbane/qytetit dhe ky lloj i zhvillimit ka ndodhur kryesisht edhe për shkak të afërsisë së qendrës urbane me vendbanimet tjera (distanca më e madhe nga qendra është 12 km). Varësisht nga mundësitë buxhetore, por edhe përkrahja me donacione nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare, si dhe donatorët e ndryshëm, komuna e Klinës ka realizuar projekte që kanë ndikuar dukshëm në zhvillimin socio-ekonomik dhe infrastrukturor të Komunës. Projektet janë realizuar kryesisht në infrastrukturën teknike dhe falë këtyre investimeve shumica e vendbanimeve dhe banorëve kanë qasje në infrastrukturën bazike teknike (ujësjellës, kanalizim, menaxhim i mbeturinave etj.), infrastrukturën sociale dhe publike, infrastrukturë të transportit etj.. Hpaësirat publike dhe të gjelbërta ka qenë një pike tjetër e fokusit të investimeve dhe kjo ka bërë që Komuna e Klinës të tejlikojë kriteret minimale sa i përket sipërfaqes së hapësirave të hapura dhe të gjelbërta për kokë banori.

Investimet e vazhdueshme në infrastrukturën e transportit kanë bërë që komuna të zhvillojë një rrjet të mirë të infrastrukturës rrugore dhe lidhje të mira me komunat fqinje.

Kushtet optimale për zhvillimin e bujqësisë (pozita e volitshme gjeografike, toka pjellore, kushtet klimatike, resurset humane dhe natyrore si dhe relievi) kanë ndikuar në orientimin e ekonomisë kah bujqësia, ndonëse jo në masën dhe nivelin që do të duhej, marrë parasyshë potencialin bujqësor që ka komuna. As shkalla e lartë e Bonitetit të Tokës së Kategorive I-IV (58 %), as përqindja e lartë e Tokës Bujqësore (47.24%) dhe Tokës Pyjore (34.94%), e as numri i mjaftueshëm i barnatoreve bujqësorë aktive (5) nuk kanë ndikuar mjaftueshëm që bujqësia të jetë sektori dominant ekonomik në komunën e Klinës. Sektori i Tregtisë me Shumicë dhe Pakicë (23 %) ka vazhduar të dominojë ekonominë e Klinës, ndërsa sa i përket numrit të punësuarve në ndërmarrje, ekonomia e Klinës karakterizohet me dominim të ndërmarrjeve të vogla (2,5 punëtorë/ndërmarrje).

Ujëvara e Mirushës ka vazhduar të shfrytëzohet si atraksioni më i rëndësishëm turistik i komunës dhe i rrethines, ndërsa komuna ka investuar në infrastrukturën përcjellëse për të promovuar këtë aset natyror dhe turistik- ndonëse jo mjaftueshëm. Monumentet dhe tërësitë natyrore të mbrojtura me Ligjin për Konservimin e Natyrës janë një aset tjetër natyror dhe turistik për komunën e Klinës, i cili është shfrytëzuar-ndonëse jo mjaftueshëm- për zhvillimin e turizmit.

Caktimi i perimetrit të Zonave të Mbrojtura ka luajtur rol të rëndësishëm në ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore nga degradimi dhe dëmtimi që mund të vije nga ndërtimi dhe aktiviteti tjetër njerëzor.

Mos tejkalimi i vlerave limite të mesatares vjetore për ruajtjen e cilësisë së ajrit ka qenë një zhvillim tjetër pozitiv në komunën e Klinës e cili duhet të theksohet në raport me trendet aktuale të zhvillimit.

Pikat kritike: Përkundër zhvillimeve pozitive dhe projekteve të realizuara deri më tani në komunën e Klinës, trendet aktuale nuk janë të mjaftueshme për zhvillim të qëndrueshëm- rrjedhimisht ky skenar nuk ofron mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen. Aktualisht kemi një zhvillim ekonomik jo të qëndrueshëm i cili karakterizohet me disproporcion mes potencialit real zhvillimor të bazuar në resurse rezerva natyrore dhe zhvillimit të aktivitetit aktual ekonomik. Ekonomia nuk dominohet nga bujqësia, për të cilën komuna ka potencial real zhvillimor (për shkak të tokës së mjaftueshme bujqësore, dhe ekzistimit të mjaftueshëm të bonitetit të lartë të tokës: I-IV), ndërsa tregtia është sektori dominant ekonomik në Klinë.

Dominimi i tregtisë si dega më e zhvilluar ekonomike në një vend me potencial krejt të ndryshëm zhvillimor është tregues i rëndësishëm për nevojën e intervenimit me mekanizma rregullues,



përkatësisht planifikim- për komunën e Klinës. Edhe ky është tregues në vete i mos-qëndrueshmërisë së trendeve aktuale zhvillimore në komunën e Klinës.

Trendet aktuale të zhvillimit të vendbanimeve kanë ndikuar negativisht në zënien e tokës bujqësore që konsiderohet si njëri nga resurset kryesore të komunës së Klinës. Bujqësia përballlet me shumë probleme si në aspektin e investimeve, fragmentim të pronave, pamjaftueshmërisë së sistemit të ujitjes (aktualisht vetëm 1,500 Ha.), vjetërsimi i mjeteve të punës në bujqësi, shkalla e ulët e rendimenteve për të gjitha kulturat bujqësore dhe qumështit etj.

Industria ende mbetet në shkallë të ulët të zhvillimit si dhe potencialet turistike nuk shfrytëzohen në nivelin e duhur.

Infrastruktura në përgjithësi kërkon të ketë një përmirësim në cilësinë e shërbimit- fokus i veçant duhet të ketë minimalizimi i humbjeve në rrjet (Humbjet në rrjetin e ujit të pijes aktualisht janë 50%), përmirësim të furnizimit me energji elektrike në të gjitha vendbanimet, mbulueshmëri e plotë e të gjitha vendbanimeve të banuara me rrjetin e transportit publik etj.

Ndotja e mjedisit nga zgjerimi i zonave të banimit, ndërtimet pa leje, eksploatimi i gurit dhe gurthyesit, prerja ilegale e pyjeve etj. ka qenë një problem i rëndësishëm i cili i ka karakterizuar trendet aktuale të zhvillimit në komunën e Klinës.

I gjithë trendi i zhvillimeve aktuale në komunën e Klinës është karakterizuar me një shkallë të ulët të urbanizimit (aktualisht vetëm 15 %). Kjo shkallë e ulët e urbanizimit, edhe pse ka parandaluar presionin për ndërtime dhe zhvillim të pakontrolluar të zonës urbane, në parim është tregues jo pozitiv, kur merren parasyshë anët pozitive të urbanizimit si proces dhe fenomen pozitiv socio-ekonomik.

Ndërtimet pa leje kanë pasur kryesisht dy efekte negative për komunën e Klinës: në njërin anë kanë ndikuar në zhvillim të pa-koordinuar hapësinor dhe nevojë për infrastrukturë teknike e cila është dashur t'i përgjigjet kërkesës në vend se t'a orientojë atë. Ndërsa në anën tjetër, ka ndikuar në humbjen e vazhdueshme të tokës së punueshme bujqësore- kjo po ashtu ka ndikuar në zbehjen e rolit të sektorit të bujqësisë në ekonominë e përgjithshme të komunës së Klinës.

Komuna e Klinës ka një pasuri të çmuar të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, por aktualisht ka pamjaftueshmëri të investimeve mbështetëse infrastrukturore si dhe pamjaftueshmëri në menaxhimin dhe promovimin e këtij potenciali të rëndësishëm zhvillimor.

Pikat tjera kritike / dobësitë e trendeve aktuale zhvillimore në komunën e Klinës janë identifikuar si më poshtë:

- Disproporcion mes potencialit real zhvillimor të bazuar në resurse dhe rezerva natyrore dhe zhvillimit të aktivitetit aktual ekonomik
- Mos përfshirja e 10 vendbanimeve në shërbimin e transportit publik
- Degradimi i lumenjve nga ndërtime të ndryshme, devijime të shtretërve të lumenjve dhe nxjerrja e rërës;
- Degradimi i mjedisit dhe ndotja e lumenjëve nga mos-trajtimi i ujërave të zeza nga amvisëria dhe nga aktivitetet e ndryshme industrial;
- Ekzistimi i deponive ilegale të mbeturinave (31 deponi ilegale në vitin 2021);
- Vërshimet e kohëpaskohshme nga lumi Drini i Bardhë;
- Prerja ilegale e pyjeve
- Humbja e vazhdueshme e Tokës Bujqësore;
- Mungesa e trajtimit të ujërave të zeza;
- Mungesa e selektimit dhe riciklimit të mbeturinave.
- Jo qëndrueshmëri e furnizimit me energji elektrike me përçues jo të diemnzionuar mire;

Sa i përket trendeve të zhvillimit hapësinor dhe ndërtimeve, vazhdimi i trendeve aktuale pa intervenim adekuat do të shtonte presionin për ndërtim dhe zhvillim të pakontrolluar dhe ekspansion të zonës urbane përtej kufijëve aktual ndërtimor. Ky zhvillim potencial do të vazhdojë të përbëjë rrezik serioz për humbjen dhe degradimin e mëtutjeshëm të tokës bujqësore si dhe do të shtonte presion e ndërtimit në afërsi të zonave të mbrojtura natyrore dhe kulturore të komunës. Prandaj, si i tillë ky skenar nuk sygjerohet si skenar zhvillimor për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Klinës. Ky qëndrim ka dominuar në Shqyrtimin Publik ku janë diskutuar skenarët e ardhshëm hapësinor për Komunën e Klinës.




Figura 20. Skenari 0 - Trendi aktual me zhvillim monocentric



4.3.1.2. Skenari 1 - Zhvillim Policentrik dhe Linear

Pikat e favorshme: Skenari i zhvillimit policentrik promovon zhvillimin gjithëpërfshirës, koheziv, multi-sektoral dhe multi-funksional për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social, gjithnjë në harmoni me mbrojtjen dhe promovimin e mjedisit. Për më tepër, ky skenar propozon një qasje territoriale gjithëpërfshirëse dhe të integruar duke marrë parasysh:

- të gjitha fushat (çështjet) e identifikuar të planifikimit;
- identifikimin dhe gjetjen e logjikës së zbatimit të skemave të qeverisjes horizontale dhe vertikale përmes harmonizimit të politikave dhe bashkërendimit të aktiviteteve;
- krijimin e një mekanizmi të përhershëm dhe të qasshëm për publikun, me një program specifik aktivitetsesh të cilat do të mundësojnë që projektet lokale t'i përgjigjen çështjeve/sfidave në zhvillim. Përmes qasjes proaktive dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, ky mekanizëm zgjeron arenën e vendimmarrjes në nivel lokal / dhe akterëve vendor, duke përfshirë edhe PPP (Partneritetet Publiko-Private).

Sa i përket zhvillimit linear, ka disa **aspekte pozitive** potenciale të zhvillimit linear të komunave, e sidomos atyre të vogla. Këto aspekte pozitive përfshijnë:

Rrjet efikas të transportit

Zhvillimi linear, veçanërisht nëpër korridoret e transportit të mirëplanifikuara, mund të kontribuojë në rrjetet e efikase transportit.

Koncentrimi i zhvillimit nëpër akse lineare, si rrugët kryesore apo hekurudhat, mund të ndihmojë në lehtësimin e fluksit të trafikut dhe zvogëlimin e kohës së udhëtimit. Kjo mund të ndihmojë në përmirësimin e lidhjeve midis pjesëve të ndryshme të komunës dhe në përmirësimin e efikasitetit të përgjithshëm të transportit.

Investime të Përqendruara në Infrastrukturë: Zhvillimi linear mundëson investime të përqendruara në infrastrukturë në rrugë të caktuara. Kjo qasje mund të çojë në zhvillim më efikas të infrastrukturës, pasi burimet përqendrohen nëpër korridoret kyçe të transportit ose infrastrukturës. Mund të rezultojë në rrugë, infrastrukturë dhe shërbime publike më cilësore, nga të cilat përfitojnë banorët dhe ekonomitë e koncentruara në këto aksa lineare.

Zhvillim Ekonomik nëpër Korridoret e Transportit: Zhvillimi linear mund të nxisë aktivitete ekonomike dhe rritje të bizneseve nëpër korridoret e transportit. Bizneset, industritë dhe aktivitetet tregtare zakonisht zhvillohen në zona me qasje të mirë të transportit. Zhvillimi linear mund të tërheqë investime dhe të kontribuojë në zhvillim ekonomik, të krijojë mundësi punësimi dhe mbështesë ekonominë lokale nëpër aksa lineare. Mirëpo, duhet të merret parasysh fakti se, përderisa ka aspekte pozitive në zhvillimin linear hapësinor, një planifikimi i kujdesshëm është gjithmonë i nevojshëm për të mbajtur një ekuilibër mes avantazheve dhe ndikimeve të mundshme negative të këtij zhvillimi, si dhe për të siguruar zhvillim hapësinor të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës dhe rezilient.

Anët negative

Përveç aspekteve pozitive dhe pikat kyçe të cekura më lart, zhvillimi policentrik- rrjedhimisht decentralizimi shpesh konsiderohet një mënyrë për të promovuar zhvillim të balancuar dhe për të reduktuar koncentrimin e burimeve në një qendër të vetme. Mirëpo, ky gjithashtu ka dhe të metat/anët negative të veta, ndërsa më poshtë janë identifikuar disa prej tyre:

Shpërndarja e pakontrolluar e ndërtimit dhe zhvillimit të zonave të reja të banimit: Zhvillimi policentrik mund të çojë në shpërndarjen e ndërtimit në zona më të gjera, ndërsa kjo ndikon



drejtpërsëdrejti në humbjen edhe më të madhe të tokës bujqësore. Përveç kësaj, zhvillimi i nën-qendrave të reja në komunën e Klinës do të krijonte kosto më të larta të infrastrukturës dhe rrjedhimisht presion më të lartë buxhetor e financiar për komunën. Zhvillimi i shpërndarë urban-përmes nënqendrave të reja- mund gjithashtu të ndikojë në degradim të mëtutjeshëm të mjedisit.

Zhvillimi i disbalancuar infrastrukturor: Zhvillimi i decentralizuar/policentrik mund të rezultojë në ndarje jo të barabartë të investimeve në infrastrukturë dhe shërbime. Në këtë konteskt, dallimet mund të jenë në investim disproporcional në mes të qendrës dhe nën-qendrave, apo edhe në mes të dy nën-qendrave ndërmjet vete. Vështirësitë potenciale në ofrimin e infrastrukturës dhe shërbimeve me cilësi të njëjtë në të gjitha qendrat dhe nën-qendrat administrative mund të qojnë në dallime, madje edhe në diskriminim socio-ekonomik mes banorëve të komunës. Në këtë mënyrë, ekziston rreziku që qasja në shërbimet themelore si transporti, arsimi dhe kujdesi shëndetësor mos të ofrohet njëjtë për të gjithë qytetarët e komunës. Ndërsa kjo do të thellonte ndasitë socio-ekonomike edhe ashtu ekzistuese në komunën e Klinës.

Vonesat kohore në zhvillimin e infrastrukturës dhe ofrimin e shërbimeve në nënqendrat potenciale do të shkaktonte po ashtu pabarazi sociale në komunë.

Humbje e Tokës Bujqësore: Zgjerimi dhe zhvillimi policentrik urban do të ndodhte në kurriz të tokës bujqësore, rrjedhimisht do të ndikonte në humbjen dhe zvogëlimin e fondit të tokës bujqësore në komunën e Klinës. Ndërsa në anën tjetër, humbja e tokës bujqësore (sidomos e tokës bujqësore me bonitet të lartë) mund të ketë pasoja për sigurinë ushqimore, jetën rurale dhe biodiversitetin. Ajo gjithashtu mund të çojë në një varësi të rritur nga ushqimi i importuar, duke ndikuar negativisht në ekonominë lokale.

Qeverisje e Fragmentuar Lokale: Zhvillimi policentrik mund të çojë në struktura të fragmentuara të qeverisjes lokale dhe rrjedhimisht në cilësi dhe efikasitet jo të njëjtë të shërbimeve administrative. Mungesa e koordinimit dhe sinkronizimit të shërbimeve administrative, si dhe mungesa e sinkronizimit dhe bashkërendimit të hartimit dhe implementimit të politikave zhvillimore mund të vonojë dhe të ndikojë negativisht në zhvillimin koheziv dhe të balancuar të komunës.

Anët negative të zhvillimit linear

Dyndje e Trafikut: Zhvillimi linear, veçanërisht nëpër rrugët kryesore të transportit, mund të çojë në rritje të qarkullimit nëpër akse të caktuara, dhe rrjedhimisht të shkaktojë dyndje të vazhdueshme të trafikut. Kjo ndodhë për shkak të koncentrimit/dendësisë së aktivitetet ekonomik, shërbimeve dhe banorëve nëpër këto akse. Dyndjet potenciale në të trafik ndikojnë jo vetëm në efikasitetin e sistemit të transportit, por kanë gjithashtu impakt negative në mjedis dhe ndikojnë gjithashtu edhe në zvogëlimin e cilësisë së jetës në përgjithësi.

Hapësirat e Kufizuara të Gjelbra dhe Publike: Zhvillimi linear ka tendencë të prioritetizojë përdorimin e tokës në një aks të caktuar, duke sjellur kështu zhvillim të kufizuara të hapësirave të gjelbra dhe hapësirave publike. Ndërsa në anën tjetër, mungesa e hapësirave të gjelbra, hapësirave publike, si dhe zonave rekreative ndikon negativisht në mirëqenien fizike dhe psikologjike të banorëve. Ndikon negativisht edhe në çështje të lidhura me cilësinë e ajrit dhe cilësinë e jetës në përgjithësi.

Degradimi Mjedisor: Zhvillimi linear mund të rezultojë në degradimin e habitateve natyrore dhe ekosistemeve. Ndërtimi dhe zgjerimi i infrastrukturës lineare mund të çojë në humbje të habitateve, shpyllëzim dhe ndërprerje të korridoreve të faunës. Kjo pastaj mund të ketë efekte negative në biodiversitet dhe ekuilibrin ekologjik.

Qasja dhe Lidhshmëria e Kufizuar: Mungesa e qasjes dhe lidhshmërisë midis pjesëve të ndryshme të një komune/mungesa e komunikimit infrastrukturor mund të kufizojë mundësitë

ekonomike, ndërveprimet sociale dhe reziliencën e përgjithshme hapësinor në komunë. Kjo gjendje mund të çojë edhe në një varësi të tepërt nga llojet e caktuara të transportit si dhe të ulë cilësinë e jetës në përgjithësi.

Prandaj, si i tillë as ky skenar nuk sygjerohet si skenar zhvillimor për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Klinës. Ky qëndrim ka dominuar në Shqyrtimin Publik ku janë diskutuar skenarët e ardhshëm hapësinor për Komunën e Klinës




Figura 21. Skenari 1 - Zhvillim Policentrik dhe Linear



4.3.1.3. Skenari 2 - Zhvillimi i IntegrUAR dhe i bazuar në ndërlidhjen funksionale, infrastrukturë, mjedisore dhe socio-ekonomike të gjithë territorit të komunës

Zhvillimi i integruar hapësinor bazohet në përqendrim rreth një qendre të vetme ose një zone qendrore komunale, mirëpo me shpërndarje të balancuar të shërbimeve dhe lidhëshmëri funksionale mes hapësirave, territoreve dhe aktiviteteve të ndryshme në komunë.

Ky skenar planifikon zhvillim kompakt të qendrës komunale të Klinës, duke koncentruar të gjitha shërbimet dhe veprimtaritë kryesore ekonomike në këtë pjesë të komunës. Në të gjithë sektorët reflektohet zhvillimi i bujqësisë, industrisë së lehtë përpunuese, industrisë bujqësore dhe turizmit natyror e kulturor si veprimtari kryesore të këtij skenari. Diversifikimi i aktivitetit ekonomik, në raport me potencialin real zhvillimor përbënë pikën qendrore të këtij skenari në kontekst të zhvillimit ekonomik. Zhvillimi i integruar dhe i balancuar hapësinor, infrastrukturor dhe socio-ekonomik i mundësuar nga eficientia e përdorimi të resurseve përbënë thelbin e zhvillimit monocentrik të komunës.

Anët pozitive të konceptit

Zhvillimi Efikas i Infrastrukturës: Zhvillimi monocentrik lejon planifikimin dhe zhvillimin efikas të infrastrukturës që përqendrohet rreth një zone qendrore, ndërsa eficientia buxhetore lejon investime të balancuara në të gjitha pjesët tjera të komunës. Përqendrimi i infrastrukturës në një qendër zvogëlon kostot e komunës pasi burimet optimizohen brenda një zone gjeografike të kufizuar. Kjo mundëson koordinimin dhe planifikimin më të mirë të rrjeteve të transportit, shërbimeve komunale dhe shërbimeve tjera publike, duke u fokusuar edhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Përmirësim i Qasjes dhe Lidhshmërisë: Përhapja e zhvillimit rreth një zone qendrore nxit qasjen dhe lidhshmërinë e përmirësuar në komunë. Në anën tjetër, përmirësimi i qasjes inkurajon përdorimin e përzier të tokës dhe aktiviteteve ekonomike të ndryshme, duke lehtësuar lëvizjen brenda zonës urbane. Ky faktor pozitiv mund të çojë në zhvillimin e një qendër më kompakte, më të gjallë dhe më dinamike ekonomikisht. Ndërsa i gjithë komunikimi do të mbështetet nga transporti efikas publik i bazuar në konceptin e Ekombilitetit.

Nxjtja e Një Ndjenje të Bashkësisë dhe Identitetit / Impakti Pozitiv Social: Përhapja e zhvillimit rreth një zone qendrore nxit një ndjenje të bashkësisë dhe identitetit / ndjenja e përkatësisë në komunitet. Banorët kanë më shumë gjasa të identifikohen me një zonë qendrore, të krijohet një identitet urban i përbashkët. Ky faktor mund të çojë në një angazhim dhe ndërveprim më të lartë të komunitetit, përvoja të përbashkëta kulturore dhe një strukturë sociale më të fortë brenda komunës.

Optimizimi i Efikasitetit të Përdorimit të Tokës: Zhvillimi monocentrik promovon optimizimin e efikasitetit të përdorimit të tokës duke koncentruar aktivitete dhe funksione të ndryshme në një zonë qendrore. Centralizimi lejon zhvillimin e ndërthurur të përdorimit të tokës, ku hapësira banuese, komerciale, administrative dhe rekreacionale ko-ekzistojnë në afërsi dhe në ndërlidhje të ngushtë. Ky përdorim efikas i tokës zvogëlon shpërndarjen e pa-kontrolluar urbane, maksimizon produktivitetin e tokës dhe mbështet praktikën e qëndrueshme të menaxhimit të tokës.

Shtimi i Hapësirave të Gjëlbra dhe Mbrojtja e Mjedisit: Koncentrimi i zhvillimit në një zonë qendrore mundëson ruajtjen dhe shtimin e hapësirave të gjëlbra si dhe kontribuon në mbrojtjen e



mjedisit. Duke shmangur shpërndarjen e pakontrolluar urbane, zhvillimi monocentrik ndihmon në ruajtjen dhe shtimin e hapësirave të gjelbra dhe të hapura, parqeve dhe habitatit natyror. Ruajtja dhe shtimi i hapësirave të gjelbra përkrah biodiversitetin, përmirëson cilësinë e ajrit dhe lehtëson efektin 'ishujt e nxehtësisë urbane' të shkatuara nga aktiviteti i përditshëm socio-ekonomik. Kjo qasje është po ashtu edhe në linjë me synimet dhe politikat e mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes së tokës bujqësore dhe promovimin e tranzicionit të gjelbërt, duke krijuar një mjedis më të shëndetshëm dhe më të qëndrueshëm urban. Ndërsa i gjithë ky zhvillim ka impekt të dukshëm pozitiv në cilësiënë e ajrit në veçanti dhe cilësinë e jetës në përgjithësi. Është e rëndësishme të theksohet se suksesi i zhvillimit monocentrik varet nga planifikimi urban efikas, politikat e kujdesshme për përdorimin e tokës dhe konsideratat për qëndrueshmërinë mjedisore.

Ndërsa ka ndikime pozitive, duhet të merren parasysh edhe **sfidat potenciale**, e të cilat janë cekur më poshtë:

Rritja e dyndjes në trafik: Përqendrimi i zhvillimit rreth një zone të vetme qendrore mund të çojë në rritjen e dyndjes dhe problemeve tjera në trafik. Kjo zakonisht vije si rezultat i dendësisë më të lartë të popullsisë dhe aktivitetit ekonomik në një zonë/qendër të vetme.

Rritje e Kostove të Pronave & banesave dhe rreziku nga gentrifikimi: Zhvillimi monocentrik mund të kontribuojë në rritjen e kostove të pronave dhe banesave, si dhe në gentrifikimin në zonën qendrore të komunës. Përqendrimi i zhvillimit në një zonë të vetme shpesh çon në rritjen e kërkesës për prona dhe banesa në zonën qendrore, duke çuar në rritje të çmimit të pasurive të paluajtshme dhe rrjedhimisht edhe në rritjen e cmimit të të gjitha shërbimeve tjera. Kjo mund të rezultojë në zhvendosjen e banorëve me të ardhura më të ulëta, duke krijuar dallime socio-ekonomike dhe duke ndryshuar strukturën shoqërore të komunitetit.

Polarizimi Socio-Ekonomik dhe Mungesa e Përfaqësimit të Barabartë: Zhvillimi monocentrik mund të sjellë polarizim në aspektin socio-ekonomik dhe mungesë të përfaqësimit të barabartë. Kjo mund të vije si rezultat i rrezikut të mos ofrimit të mundësive dhe kushteve të barabarta për të gjithë qytetarët, duke u favorizuar vetëm ata që jetojnë në zonën qendrore të komunës. Kjo situatë shpesh rezulton në një polarizim socio-ekonomik, ku një pjesë e zonës qendrore mund të përfitojë më shumë nga zhvillimi krahasuar me zonat periferike.

Problemi dhe ndasitë e njëjta mund të shfaqen edhe në kontekst të gjithëpërfshirjes dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, ku bunorët që jetojnë në zonën urbane/vendbanimin qendror të komunës kanë mundësi më të mëdha përfaqësi, ndërsa banorët tjerë privohen (me apo pa dashje) nga kjo e drejtë dhe vlerë demokratike.

Këto efekte potenciale negative do të mund të adresohen përmes një planifikimi të mirëfillt, zbatim efikas dhe rigoroz të politikave të ruajtjes së mjedisit dhe tokës bujqësore, investim të balancuar dhe gjithëpërfshirës në infrastrukturë dhe rritje të cilësisë së shërbimeve, mbrojtje dhe promovim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, si dhe fuqizim të grupeve të marginalizuara sociale. Rrjetizimi i vendbanimeve përmes infrastrukturës së transportit/komunikimit si dhe kompletimit të infrastrukturës publike sociale dhe teknike, si dhe gjithëpërfshirja e qytetarëve në planifikim dhe vendimmarrje pavarësisht vendit ku ata banojnë dhe jetojnë janë instrumente tjera të rëndësishme të cilat do të duhej të aplikohen në mënyrë që skenari monocentrik të jetë funksional, eficient dhe të situaturojë zhvillim të qëndrueshëm, të balancuar dhe gjithëpërfshirës.



Ky Skenar (Skenari 2 - Zhvillimi i Integruar dhe i bazuar në ndërlidhjen funksionale, infrastrukture, mjedisore dhe socio-ekonomike të gjithë territorit të komunës) është përzgjedhur si skenar i zhvillimit të ardhshëm hapësinor të komunës së Klinës. Ky skenar është përzgjedhur pas Shqyrtimit Publik në të cilin janë prezantuar dhe elaboruar të tre skenarët e cekur më lart.

Në këtë mënyrë, **Skenari i Integruar, i bazuar në zhvillim monocentric dhe kompakt si dhe në ndërlidhjen funksionale, infrastrukture, mjedisore dhe socio-ekonomike të gjithë territorit të komunës së Klinës** do të fokusohet në fushat dhe dimensionet si më poshtë:

Decentralizimi i shërbimeve administrative përmes dixhitalizimit: Administrata komunale do të vazhdojmë me dixhitalizimin e shërbimeve, mirëpo tash e tutje procesi i dixhitalizimit do të jetë më i shpejtë dhe gjithëpërfshirës. Decentralizimi i shërbimeve administrative përmes dixhitalizimit të shërbimeve dhe e-kiosqeve – pa patur nevojë për themelimin e qendrave të reja administrative – do të rrisë efikasitetin e shërbimeve dhe do t'u mundësojë të gjithë qytetarëve qasje më të lehtë, më të shpejtë dhe më efikase në të gjitha shërbimet e komunës. Ky decentralizim i shërbimeve pa patur nevojë të themelohen qendra të reja administrative do të parandalojë ngarkesat e reja buxhetore për komunën si dhe do të parandalojë efektet negative të skenarit policentrik – të cekura më lart.

Përmirësimi i shërbimeve publike dhe rritja e efikasitetit në infrastrukturën teknike: Shërbimet dhe veprimtaritë kryesore publike dhe sociale do të përmirësohen varësisht nga nevoja për zhvillim si dhe duke u bazuar në trendet e ardhshme të dixhitalizimit. Përveç infrastrukturës bazike publike-sociale dhe teknike, investimet do të fokusohen edhe në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve që ndërlidhen me infrastrukturën. Ndërsa shërbimet nga sektori publik, social dhe teknik do të mbështesin investimet në sektorin e turizmit natyror dhe kulturor, kryesisht në zonat periferike të komunës. Këto shërbime do të mbështesin bujqësinë si veprimtaria kryesore ekonomike, duke ndihmuar zhvillimin e saj në të gjitha vendbanimet e komunës. Zhvillimi i industrisë bujqësore do ta mbështesë po ashtu zhvillimin e bujqësisë, ndërsa industria e lehtë përpunuese do të jetë po ashtu në fokus të politikave zhvillimore në ekonomi.

Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve dhe potencialit real zhvillimor si dhe diversifikim të aktiviteteve ekonomike: Sa i përket zhvillimit ekonomik, skenari parasheh dhe i paraprinë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve dhe potencialit real zhvillimor si dhe diversifikim të aktiviteteve ekonomike. Zhvillimi ekonomik do të orientohej drejt ekonomisë së bazuar në Bujqësi dhe Blegtori, Industri Bujqësore dhe Përpunuese, Shërbime si dhe ICT. Me këtë orientim të ri të zhvillimit ekonomik synohet vecanërisht rritja e pjesëmarrjes së sektorit të bujqësisë dhe blegtorisë në relacion me sektorët tjerë ekonomik, ndërsa asetet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore do të shfrytëzohen si potencial për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm natyror, rural dhe kulturor. Rritja e punësimit synohet të bëhet përmes përkrahjes së NVM-ve, Start-Up dhe Inovacionit, ndërsa fokus i vecantë do t'i kushtohet edhe luftimit të informalitetit dhe zbutja e pabarazive në zhvillim ekonomik.

Organizim i NVM-ve dhe aktiviteteve të ndërlidhura prodhuese rreth modelit të zhvillimit kompakt dhe të qëndrueshëm: Politikat lokale duhet të përkrahin krijimin e ndërmarrjeve të reja si dhe t'i ri-organizojë bizneset ekzistuese në aspekt hapësinor dhe tematik. Riorganizimi hapësinor i bizneseve do të ndikonte në ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët, ndërsa do të



mundësonte edhe një zhvillim më koheziv të hapësirës. Në anën tjetër; grumbullimi i sektorit prodhues në një hapësirë, jo shumë larg zonës urbane, do të ofrojë të gjitha shërbimet e nevojshme teknike dhe logjistike.

Ndërlidhja e arsimit të mesëm të lartë me nevojat e ekonomisë lokale: I gjithë sistemi shkollor, veçanërisht ai i nivelit të lartë, do të trajtojë personat e gatshëm për të mbështetur biznesin e lidhur me bujqësinë, industrinë e lehtë përpunuese dhe turizmit natyror e kulturor si një strategji e duhur dhe e përshtatur për kontekstin lokal.

Efiçenca në investime kapitale: Zhvillimi monocentrik i komunës së Klinës do të mundësojë efiçencë në investime kapitale duke i fokusuar ato kryesisht në një qendër të vetme. Ndërsa kursimet buxhetore do të krijojnë mundësi për kompletimin e infrastrukturës publike-sociale dhe infrastrukturës teknike në masë 100 % për 8 vitet e ardhshme dhe atë në të gjitha vendbanimet e komunës.

Përmirësimi i qasjes përmes fuqizimit të lidhjeve/korridoreve të transportit: Qasja në Klinë është e përmirësuar, ndërsa vëmendje e veçantë duhet dhënë promovimit të lidhjeve që lidhin qytetin e Klinës me qendrat e afërta, me kryeqytetin si dhe me rajonin. Mobiliteti i qëndrueshëm urban do të përbëjë skenarin kryesor të mobilitetit brenda zonës urbane të Klinës. Ky mobilitet është i mbështetur në konceptin e lëvizshmërisë pa ndikim negativ në mjedik (ndikim 0), përkatësisht Ekomobilitet.

Harmonizimi i shfrytëzimit të tokës- sidomos për banim, biznese dhe industri me nevojën e domosdoshme për ruajtjen e sipërfaqes bujqësore dhe resurseve tjera natyrore- në funksion të zhvillimit të bujqësisë. Në këtë pikë do të merren parasysh edhe nevojat për zhvillimin e turizmit dhe industrisë së lehtë përpunuese, si dhe nevojat lokale për banim dhe aktivitete ekonomike. Në këtë kontekst, rëndësi të veçantë do t'i kushtohet raportit për mbështetje të kërkesave për banim/biznese në mes të qendrës dhe pjesëve tjera të qytetit dhe komunës. Për më tepër; shfrytëzimi i tokës do të mbështesë zhvillimin e balancuar dhe kompakt brenda zonës urbane dhe në zonat periferike/rurale.

Krijimi i një sistemi për mobilitet të qëndrueshëm dhe ekologjik me fokus në qarkullimin e ngadaltë në zonën urbane, këmbësorë, biçikleta, masa efektive për parkim si dhe lidhje rajonale: Qasja në zonën urbane, me theks të veçantë në qendër të qytetit do të përmirësohet duke hartuar politika dhe ndërmarrë veprime konkrete që inkurajojnë qarkullimin e ngadaltë në zonën urbane, transportin jo-motorik, politikat e parkimit, rrjetin e hapësirave publike dhe parqet. Për më tepër, politikat do të fokusohen në qasje më të lehtë në pjesën qendrore të qytetit, sipas logjikës së lëvizshmërisë pa ndikim negativ në atmosferë (ndikim 0). Mobiliteti i qëndrueshëm urban do të përbëjë skenarin kryesor të mobilitetit brenda zonës urbane të Klinës. Nën-qendrat e komunës (Zllakuqani dhe Gllareva) do të lidhen edhe me shumë me qytetin e Klinës me lidhje më të shpeshta me transport ndërurban dhe rrjet të rrugëve, duke krijuar mundësi për zhvillim të bujqësisë dhe biznese lokale dhe duke kontribuar në shfrytëzim kompakt të tokës.

Mbrojtja e mjedisit: Duke konsideruar mbrojtjen e mjedisit jo vetëm problematikë ekologjike, por edhe problematikë sociale dhe ekonomike, ky skenar zhvillimor parasheh përcaktimin dhe implementimin e masave mbrojtëse përkatëse për amortizim të efekteve negative në mjedis,



mbrojtje ndaj ndotësve dhe kërcënuesëve të tjerë mjedisor, si dhe masa për zhvillim kualitativ mjedisor. Këto masa përfshijnë, mirëpo nuk kufizohen vetëm me: mbrojtje e ujërave, burimeve ujore dhe sipërfaqeve ujore, mbrojtje e ajrit, tokës bujqësore dhe pyjeve, mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore, erozioni si dhe mbrojtje nga zhurma.

Në raport me mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri, skenari i kushton vëmendje të theksuar mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të resurseve mjedisore, mbrojtjes së mjedisit, ruajtjes dhe përmirësimit të tij, parandalimit dhe pakësimit të rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të qytetarëve. Ndërgjegjësimi i banorëve nëpërmjet promovimit të politikave edukuese për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit përbënë po ashtu një instrument të rëndësishëm për arritjen e objektivave të këtij qëllimi. Marrja e masave për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore, trajtimi adekuat dhe marrja e masave parandaluese në sipërfaqet me rrezikshmëri si dhe ri-organizim i sistemit të Menaxhimit dhe Riciklimit të Mbeturinave dhe fillimi i trajtimit të tyre janë po ashtu ndër masat e rëndësishme në të cilat do të bazohet ky skenar në raport me mjedisin dhe sipërfaqet me rrezikshmëri.

Në raport me energjinë, skenari parasheh dhe do t'i paraprijë përmirësimit të rrjetit energjetik dhe rritjes së kapaciteteve ekzistuese në të gjithë komunën, ndërsa do t'i paraprijë edhe orientimit drejt diversifikimit të burimeve të energjisë. Në këtë kontekst skenari parasheh eksplorimin e vazhdueshëm të potencialit për burime të ripërtërishme të energjisë si dhe instalimin e paneleve solare në ndërtesat publike dhe instalimin e sistemit të ngrohjes solare në Klinë.

Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore: Duke pasur parasyshë faktin se mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore janë shumë të rëndësishme për ruajtjen e diversitetit kulturor dhe identitetit të komunës, ky skenar parasheh mbrojtjen dhe promovimin e kësaj trashëgimie duke përfshirë 13 asetet e trashëgimisë arkeologjike, 7 asetet e trashëgimisë arkitekturore, 13 asetet e trashëgimisë natyrore si dhe 4 Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Ruajtja e kapacitetit të bartjes tek monumentet e trashëgimisë kulturore si dhe ruajtja e biodiversitetit dhe balancit ekologjik tek asetet e trashëgimisë natyrore janë thelbësore për ruajtjen, mirëmbajtjen, promovimin dhe shfrytëzimin eficient të këtyre resurseve për zhvillim të balancuar socio-ekonomik dhe ekologjik të komunës.

Zhvillimi dhe promovimi i turizmit natyror, rural dhe kulturor: Duke pasur parasyshë potencialet reale që i ka Komuna e Klinës për zhvillimin e turizmit natyror, rural dhe kulturor-sidomos në lokalitetet në Zonën e Mirushës, Dushit, Ujëmirrit, Pograxhes, Budisavcit, Çabiqit, Dresnikut, Ularicës, Dollcit etj. planifikohet zhvillimi i këtij sektori me shumë inters ekonomiko-social, kulturor dhe mjedisor.

Prandaj ky skenar është propozuar dhe është përzgjedhur si skenar zhvillimor rreth të cilit do të bëhet planifikimi dhe zhvillimi i ardhshëm i komunë së Klinës.




Figura 22. Skenari 2 - Zhvillimi i IntegrUAR dhe i bazuar në ndërlidhjen funksionale, infrastrukture, mjedisore dhe socio-ekonomike të gjithë territorit të komunës



4.3.2. Koncepti i zhvillimit hapësinor të skenarit të përzgjedhur

4.3.2.1. Elementet e konceptit të zhvillimit hapësinor

Si përmbajtje dhe elemente të trajtuara në skenare dhe të përvetësuara në konceptin kryesor janë Nyejt, Korridoret, Plotësimi dhe Dendësimi, Mbajtja nën kontroll, Mbrojtja dhe Zonat e rritjes, të cilat të skenaret janë analizuar edhe me implikime financiare përveç si përmbajtje dhe elemente hapësinore.

NYJET	Ky skenar propozon zhvillimin e një numri të vogël të nyejve, kjo për shkak të synimit për të siguruar një zhvillim të integruar dhe të koncentruar territorial dhe hapësinor të komunës së Klinës. Në këtë kontekst, nyja kryesore do të jetë zona urbane e Klinës, ndërsa kjo do të mbështetet nga nyjet tjera si Zllakuqani, Klinafç, Gllareva, Zajmi dhe Dollci.
KORRIDORET	Korridoret trajtojnë vijat më të rëndësishme të zhvillimit dhe transportit dhe telekomunikacionit në komunë e Klinës. Këto korridore përfshijnë linjat e transportit që bëjnë ndërlidhjen e vendbanimeve të komunës në mes veti, ndërlidhjen e komunës me komunat tjera si dhe fuqizojnë pozicionin e Klinës si korridor i rëndësishëm që ndërlidhë Rrafshin e Kosovës me Rrafshin e Dukagjinit. Korridor i rëndësishëm i këtij skenari është korridori hekurudhor që lidhë Klinën me portin e Durrësit përmes Prizrenit. Sa i përket korridoreve të zhvillimit ekonomik, ky skenar propozon fuqizimin e korridorit që kalon kah rruga M9 në drejtim të Prishtinës , që lidhë segmentin Prishtinë-Prizren, po ashtu propozohet që të fuqizohet korridori M 9-1 që lidh segmentin Klinë-Gjakovë, si dhe fuqizimin e arteries kryesore të qarkullimit rrugor të Klinës e që është magjistralja Prishtinë-Pejë. Korridoret zhvillimore ekzistuese monitorohen dhe rehabilitohen, kurse zhvillimi përreth korridoreve të reja është planifikuar me kujdes, duke respektuar politikat dhe qëllimet e këtij Plani Zhvillimor Komunal në raport me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimit të balancuar hapësinor të komunës.



PLOTËSIMI DHE DENDËSIMI	Skenari i përzgjedhur propozon plotësim dhe dendësim në zonën urbane, duke u zgjeruar kah jug-lindja e qytetit. Sipas nevojave plotësim dhe dendësim është planifikuar edhe në vendbanime tjera, sidomos në Zllakuqan, Zajm, Dollc, mirëpo dendësimi dhe plotësimi do të jenë të monitoruara si dhe do të bëhen në atë mënyrë që të respektojnë ruajtjen e resurseve natyrore, sidomos të tokës bujqësore. Dendësimi dhe plotësimi i kontrolluar do të bëhet para së gjithash duke respektuar synimin e këtij Plani Zhvillimor Komunal për të siguruar një zhvillim të integruar dhe të koncentruar territorial dhe hapësinor të komunës së Klinë
MBAJTJA NËN KONTROLL	Synohet mbajtja nën kontroll të zhvillimit ndërtimor, si për zonat urbane ashtu edhe për ato rurale, me fokus të veçantë në zonat rurale me densitet më të ulët të popullsisë. Kjo përfshin kufizimin e shtrirjeve të reja dhe parandalimin e rritjes së intensitetit të ndërtimeve jashtë zonave të përcaktuara për ndërtim, duke ruajtur kështu integritetin e hapësirave të definuara për zhvillim.
MBROJTJA	Në lidhje me konceptin e Mbrojtjes, evidentohet nevoja e mbrojtjes së resurseve të tokës bujqësore, pasurive nëntokësore të cilat në rastë shfrytëzimit duhet të jenë të përcaktuara me plane konkrete për ndërmarrjen e masave të duhura për të siguruar që shfrytëzimi i tyre është i qëndrueshëm dhe pa ndikime negative në mjedis.
ZONAT E RRITJES	Në kuadër të menaxhimit të zgjerimit hapësinor Zonat e rritjes përcaktohen duke u bazur në resurse dhe potencial për zhvillim, me mundësi drejt tokës së zbrazët të përshtatshme për plotësim për të siguruar shfrytëzim efektiv të tokës.



4.3.3. Zhvillimi sipas Sektorëve

4.3.3.1. Zhvillimi Ekonomik

Plani Zhvillimor Komunal (2014-2021+) ka paraparë që zhvillimi ekonomik të bazohet kryesisht në Agrikulturë-blegtori, Apikulturë, Agroturizëm si dhe turizëm rural dhe turizëm kulturor. Edhe Plani Zhvillimor Komunal për Komunën e Klinës 2025-2033 propozon që zhvillimi ekonomik të orientohet kryesisht nga këta sektorë, mirëpo kësaj radhe kemi një planifikim më të konsoliduar dhe i cili reflekton të gjithë potencialin real zhvillimor të komunës si dhe nevojën dhe potencialin për të përdorur avancimin e teknologjisë si instrument i rëndësishëm në pothuajse të gjithë sektorët ekonomik. Në këtë kontekst, ky PZHK propozon një ‘Orientim të zhvillimit ekonomik drejt ekonomisë së bazuar në Bujqësi, Industri Bujqësore dhe Përpunuese, si dhe Shërbime’, e po ashtu propozon që potenciali ekonomik i resurseve natyrore të shfrytëzohet në mënyrë racionale, eficiente dhe gjithmonë në pajtim me standardet mjedisore, në mënyrë që i tërë potenciali zhvillimor i komunës të shfrytëzohet për të siguruar një ekonomi të qëndrueshme dhe rritje të cilësisë së jetesës për të gjithë qytetarët e komunës.

Bazuar në planifikimin për zhvillimet në bujqësi të paraparë me PZHK 2014-2021+ i cili është adoptuar edhe në këtë PZHK, e paraprirë edhe nga deklaratat e vizionit “Klina qendër rajonale e zhvillimit bujqësor...”, janë identifikuar kulturat bujqësore bashkë me hapësirat për kultivimin e tyre. Në këtë mënyrë, në pjesën më të madhe të sipërfaqeve bujqësore është planifikuar mbjellja e drithrave si grurit dhe misrit, pastaj elb, thekër dhe tërshërë në sipërfaqe më të vogla. Poashtu është planifikuar edhe mbjellja dhe shtimi i sipërfaqeve me perime me fokus në ambiente të mbyllura apo serra, mbjellja dhe shtimi i sipërfaqeve me pemë të larta si kumbulla dhe arra të shpërndara në tokat bujqësore të Komunës së Klinës.

Kultivimi i drithërave, është planifikuar në mënyrë të shpërndarë në pothuajse gjithë territorin e komunës, por me një fokus të vecantë në tokat e tipit smonicë që përmbjellin kufirin lindor të komunës së Klinës dhe të cilat evidentohen në Caravik, Çabiç, Dobërdol e Ujmirë.

Zhvillimi i perimtarisë është planifikuar në të gjitha lokalitetet por me fokus të vecantë në tokat aluviale të cilat evidentohen në pjesën qendrore të komunës së Klinës. Këto toka janë tipike në afërsi të rrjedhave lumore siç janë në rastin konkret ato të Drinit të Bardhë, Lumbardhit të Pejës etj. Në kuadër të zonave kadastrale këto toka gjenden kryesisht në Klinë, Zajm, Deiq, Petriq i Epërm, Petriq i Poshtëm, Drenoc, Nagllvakë, Stupë, Budisal, Rudicë, Berkovë si dhe në një pjesë të Zllakuqanit. Për periudhën 2025-2033 është planifikuar edhe ngritja e 400 mini serrave në sip.prej 32m2 për secilën.

Zhvillimi i pemtarisë është planifikuar në të gjitha lokalitetet, por me koncentrim të veçantë në tokat që gjenden në kuadër të zonave kadastrale Klinafç, Dresnik, Gremnik e Qupevë, Dranashiqi, Zllakuqani, Kpuzi, Volljaku, Dushi, një pjesë e Sferkës, Qeskovës, Grabanicës, Dugajevës. Siqeva, Dushi i Vogël, Binxhë, Shtupielit, Dranashiq, një pjesë të Jashanicë, Gjurgjevikut i Madh, Siqevës, Ujmiri, Dobërdoll, Çabiç. Në fokus do të jenë edhe subvencionimet për mbjelljen e 80 ha me kumbull dhe 80 ha me arrë, gjatë viteve 2025-2033.

Për ti evituar vërshimet dhe dëmet në bujqësi dhe amvisëri është planifikuar rregullimi dhe zgjerimi i lumenjëve në 24 km gjatësi: Drini i bardhë me 7km gjatësi, Lumi Klina me 7km gjatësi, Lumbardhi i Pejës nga ura e Pejës deri te Pjetërq i Epërm me 7km gjatësi, Lumi Mirusha me 3km gjatësi dhe Lumi Istogu 2km gjatësi. Me qëllim të rritjes së rendimenteve për njësi sipërfaqe të kulturat bujqësore është planifikuar shtrirja e rrjetit të ujitjes në sipërfaqet e targetuara me planin për zhvillimin e bujqësisë si dhe hapja e kanaleve të ujitjes me 8500m gjatësi. E gjithë kjo duhet të realizohet gjatë viteve 2025-2033.



Me qëllim të zhvillimit ekonomik të orientuar nga bujqësia dhe me qëllim të maksimalizimit të rendimeteve bujqësore, është planifikuar edhe mbështetj administrative dhe financiare për projektet kapitale nga Drejtoria e Bujqësisë dhe nga Komuna me subvencionime dhe mbështetje profesionale konsulencë, për vitet 2025 – 2033.

Është planifikuar edhe subvencionimi i fermerëve me motokultivatorë (450 copë), me një shpërndarje uniforme përgjatë viteve 2025-2033.

Me qëllim të zbutjes së humbjeve gjatë punimit të tokës dhe kulturave bujqësore dhe rritjes së rendimeteve, është planifikuar subvencionimi i fermerëve me agregatë të traktorëve – me rotofrezë, makina spërkatëse atomizerë, makina për shpërndarjen e plehut artificial etj. Është planifikuar edhe përkrahja e prodhuesve dhe kultivuesve të qumështit, mishit, vezëve, bletëve, pemëve, perimeve, drithërave, turizmit rural etj. Kjo përkrahje do të realizohet përmes asistencës teknike dhe subvencioneve nga komuna, ndërkohë që synon ngritjen e kapaciteteve prodhuese, cilësisë dhe sigurisë ushqimore, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e ekonomisë qarkore, avancimin e infrastrukturës prodhuese në ferma, rritjen e granteve nga donatorët e jashtëm etj.

Me hartimin e Strategjisë së Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Blegtorisë, hartimi i së cilës është paraparë me këtë PZHK do të hartohen politika më konkrete dhe do të identifikohen resurse për shtimin e përkrahjes dhe subvencioneve për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë në vendbanimet dhe zonat kadastrale të lartëcekura. Krijimi i kushteve në sektorin privat për ngritjen e plantazheve me fidane dhe pemishte (molla, dardha, kumbulla etj.) dhe fruta të imëta (mjedra, lajthi, dredhëza etj.) si dhe për ngritjen e serrave të reja dhe zgjerimi dhe modernizimi i atyre ekzistuese janë ndër mundësitë të cilat do të analizohen dhe të planifikohen detajisht në Strategjinë e Integruar për Zhvillim të Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Blegtorisë në komunën e Klinës. Zhvillimi i qëndrueshëm i bletarisë do të analizohet dhe planifikohet po ashtu me këtë strategji të integruar.

Zhvillimi i blegtorisë është bazuar në PZHK 2014-2021+ propozimet e të cilit janë adoptuar edhe në këtë PZHK. Në këtë mënyrë, zhvillimi i blegtorisë është planifikuar në vendbanimet dhe zonat kadastrale si vijon: Caravik, Çabiç, Dobërdol, Ujmirë, Zajm, Deiq, Petriq i Epërm, Petriq i Poshtëm, Drenoc, Nagllvakë, Stupë, Budisal, Rudicë, Berkovë, Zllakuqan, Klinafç, Dresnik, Gremnik, Qupevë, Dranashiq, Kpuz, Volljaku, Dushi, një pjesë e Sferkës, Qeskovës, Grabanicës, Dugajevës, Siqev, Dushi i Vogël, Binxhë, Shtupel, Jashanicë, Gjurgjeviku i Madh, Siqevës, Ujmir dhe lokalitete tjera të komuës.

Zhvillimi i Industrisë Bujqësore dhe asaj përpunuese do të përkrahet përmes programeve promovuese - mbështetëse si dhe lehtësimeve fiskale përmes mbështetjes së investimeve nga komuna. Përkrahja e qumështoreve egzistuese ‘Ital Kos’ dhe ‘Shoqata e Agrikultures sociale’ do të ndikonte në rritjen e kapaciteteve prodhuese të tyre nga 2,500 litra për secilën sa prodhojnë aktualisht në të paktën 5,000 litra prodhim për secilën në të ardhmen. Është planifikuar po ashtu edhe trajnimi dhe subvencionimi i prodhuesve të mjaltit dhe produkteve tjera nga bletët, për 250 bletarë.

Zhvillimi i Turizmit Natyror, Rural dhe Kulturor

Duke pasur parasysh potencialet reale që i ka Komuna e Klinës në turizmin natyror dhe kulturor rural sidomos lokalitetet në Zonën e Mirushës, Dushit etj. Planifikohet zhvillimi i këtij sektori me shum inters ekonomik social dhe kulturor duke hartuar Strategjinë Komunale për Zhvillimin e Integruar të Turizmit si dhe përmes investimeve në infrastrukturë, kapacitete turistike, promovimit



si dhe përkrahjes së sektorit të shërbimeve të ndërlidhura me turizmin natyror dhe rural në Budisavc, Ularicë, Dollc etj, duke hartuar Strategjinë Komunale për Zhvillimin e Integruar të Turizmit si dhe përmes investimeve në infrastrukturë, kapacitete turistike, promovimit si dhe përkrahjes së sektorit të shërbimeve të ndërlidhura me turizmin kulturor. Të gjitha këto investime do të realizohen në periudhën 2025-2033.

Është planifikuar edhe inventarizimi i detajizuar i Aseteve Turistike dhe Potencialit Turistik të Komunës së Klinës, si dhe dixhitalizimi i këtij inventari.

Me qëllim të një zhvillimi në harmoni me tregun dhe nevojat e tij për fuqi punëtore, planifikohet ndërlidhja e Arsimit me Ekonominë dhe Sinkronizimi i programeve arsimore në shkollat profesionale me potencialin real dhe nevojat për zhvillim ekonomik (Bujqësia, drejtimi kuzhinjer, Industria Bujqësore dhe Industria e Lehtë Përpunuese, Hoteleria, Shërbimet, Turizmi IT).

Po ashtu është planifikuar edhe përkrahja e “Mësimit Gjatë Tërë Jetës” për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, me fokus në sektorët primar për zhvillim ekonomik.

Zhvillimi i integruar dhe i balancuar i bujqësisë dhe blegtorisë, krahas shndërrimit të këtij sektori në njërën nga shtyllat kryesore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të komunës, po ashtu do të ndihmojë edhe në zbutjen e pabarazisë së zhvillimit ekonomik në terma të shpërndarjes jo të barabartë të kapitalit dhe koncentrimit të aktiviteteve ekonomike.

Bazuar në rekomandimet e VSM-së për arritjen e shfrytëzimit të potencialeve turistike në komunën e Klinës duhet që komuna të: hartojë rregullore komunale me kërkesa specifike për lejet e turizmit që do të përfshijnë integrimin e VSM-ve dhe VNM-ve për programet dhe projektet e turizmit, trajtimin e ujërave të ndotura dhe menaxhimin e mbeturinave të koordinuar nga investitori/pronari nëse dëshirojnë t'u jepet një leje, ripërdorimin e detyrueshëm të ujit dhe riciklimi i të gjithë elementëve të mundshëm, monitorimin e vazhdueshëm të respektimit të kushteve mjedisore që dalin nga zbatimi i ligjeve në fuqi, Bashkëpunim dhe bashkërendim me institucionet e nivelit qendror në zbatimin e përcaktimeve të planifikuara me planet hapësinore të nivelit më të lartë si dhe zhvillimin e planeve rregulluese të hollësishme për zonat turistike, Bashkëpunim dhe bashkërendim me institucionet e nivelit qendror në zbatimin e përcaktimeve dhe masave që rrjedhin nga strategjitë e ndryshme që ndërlidhen me mjedisin.

Pylltaria

Duke u bazuar në propozimet e PZHK 2014-2021+ e të cilat janë adoptuar në këtë PZHK, është paraparë pyllëzimi i një sipërfaqe totale prej 1,500 Ha dhe atë në fshatrat Bërkovë, Binxhë, Bokshiq, Budisalc, Caravikë, Çabiq, Deiq, Dobërdol dhe Dollc.

Në kuadër të ruajtjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm të sipërfaqeve pyjore, janë planifikuar edhe ripyllëzime të sipërfaqeve të zhveshura me pishë të zezë (500 ha). Përveç pyllëzimit, duke u bazuar po në propozimet e PZHK 2014-2021+ e të cilat janë adoptuar në këtë PZHK, është paraparë edhe melORIZIMI i pyjeve (20 Ha).

Është planifikuar edhe subvencionimi i vendgjuetive në funksion të mbrojtjes së florës dhe faunës.

Tregtia

Sektori me numrin më të madh të bizneseve të regjistruara në Komunën e Klinës është sektori i Tregtisë me 343 biznese në total, apo 23 % të totalit të bizneseve të regjistruara në të gjithë komunën. Kjo e bën Tregtinë sektorin më të madh ekonomik në Komunën e Klinës dhe rrjedhimisht sektorin më të rëndësishëm ekonomik, krahas bujqësisë, shërbimeve dhe akomodimit/hotelerisë.



Edhe në SWOT Analizën për Zhvillim Ekonomik të komunës, dominimi i sektorit të Tregtisë me Shumicë dhe Pakicë (23 %) është identifikuar si një nga mundësitë e mëdha për zhvillimin e ardhshëm ekonomik të komunës së Klinës. Sa i përket dokumentit të “PLANIT HAPËSINOR TË KOSOVËS – STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR 2010 – 2020+”, në pjesën e Udhëzimeve, Përgjegjësitë dhe Kërkesat theksohet se “me konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, Kosova ndahet në katër zona të cilat janë caktuar në bazë të tipareve që janë karakteristike për këto zona” (referenca). Klina bënë pjesë në hapësirën e quajtur “Kopshti i Kosovës (Hapësira e portokalltë) - kulturore-turistike, shërbyese tregtare, agro-industriale – Peja”. Kjo hapësirë- ndër të tjera- karakterizohet edhe një traditë në kultivim të agro-industrisë, tregtisë dhe turizmit. Tutje; duke u bazuar edhe në PZHK-në paraprak, propozimet e pjesëshme të të cilit janë adoptuar në këtë PZHK, fuqizimi i sektorit të tregtisë do të bëhet kryesisht përmes koncentrimit të bizneseve të tregtisë me shumicë në zonat e parapara ekonomike. Ofrimi i infrastrukturës së nevojshme për këto zona industriale, por edhe për bizneset e këtij sektorit të koncentruara në zona të tjera janë po ashtu ndër masat e parapara me këtë PZHK. Shfrytëzimi i mundësive që ofron sektori i IT-së për fuqizimin e bizneseve dhe rritjes së prezencës së tyre virtuale përveç që do të ndihmoj rritjen e sektorit të tregtisë, kjo do të ndihmojë edhe komunën në implementimin e vizionit të ri ekonomik të bazuar në IT- ndër të tjera. Edhe bizneset e tregtisë me pakicë do të përkrahen përmes politikave stimuluese dhe lehtësuese të të bërit biznes, ndërsa masat konkrete për këtë sektorë janë paraparë në Planin e Veprimit të këtij PZHK-je. Plani i Veprimit si i tillë është bazuar në nevojat për zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të Tregtisë, potencialit zhvillimor të këtij sektorit, si dhe në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Komunës së Klinës.

Industria

Nga 1,510 ndërmarrje të regjistruara në Komunën e Klinës, vetëm 7 prej tyre (0.5 % e totalit) i takojnë sektorit të Industrisë Përpunuese, ndërsa kjo pjesëmarrje e ulët e industrisë përpunuese në ekonominë e Klinës tregon për shpërputhje mes potencialit zhvillimor dhe aktivitetit aktual ekonomik në komunë.

Përkundër mungesës së një pasqyre më konkrete dhe të detajizuar për fushën e Industrisë në Komunën e Klinës, grupi punues i këtij PZHK vlerëson se orientimi strategjik i Komunës së Klinës në raport me sektorin e industrisë duhet të fokusohet në dy komponente kryesore: Gjetja e mënyrave dhe rrugëve më të përshtatshme për të shfrytëzuar në mënyrë efçente dhe të qëndrueshme potencialin e pasurive minerale si dhe fokusimin në industrinë e lehtë prodhuese dhe përpunuese, sidomos duke u fokusuar në prodhimin dhe përpunimin e produkteve bujqësore (Industri Bujqësore).

Ky orientim i komunës mbështetet po ashtu edhe në objektivat e Plani Zhvillimor Komunal (2014-2021+) i cili ndër të tjera kishte përcaktuar objektiva zhvillimore si ‘Rivitalizimi i industrisë bujqësore – produktet themelore dhe përpunimi i prodhimeve’ (referenca).

Sa i përket zonave ekonomike- të cilat janë të rëndësishme për koncentrimin e bizneseve dhe për rritjen e produktivitetit prodhues/industrial, ky PZHK propozon që Zona Industriale ekzistuese në qytet të vazhdojë të mbetet si Zonë Industriale ku përveç prodhimit do të ketë edhe shërbime tjera si tregtia dhe shërbimet që përkrahin prodhimin. Meqenëse zona është e pajisur me infrastrukturë dhe ka lidhje direkte me rrugën rajonale për Skënderaj dhe me hekurudhën, konsiderohet se zona ka potencial të mirë për t’u shndërruar në një qendër të suksesshme biznesi. Kjo Zonë Industriale ka një sipërfaqe prej 20.09 Ha.



Edhe Zona Industriale në Pograxhë e cila është e propozuar me Harten Zonale Komunale 2020-2028+ si Zonë Industriale dhe e cila është në kufi me perimetrin e caktuar për zonën e mbrojtur të burimit të ujit propozohet që të zhvillohet si Zonë Industriale.

Në anën tjetër, Zona Industriale në Nagllavkë me sip 6.06 Ha dhe e cila me Hartën Zonale Komunale 2020-2028+ është propozuar të zhvillohet si Zonë Industriale, me këtë PZHK nuk propozohet të zhvillohet si e tillë. Edhe ashtu, aktualisht në terren nuk ka infrastrukturë dhe kushte për zhvillimin e saj, ndërsa as Komuna e Klinës nuk sheh interes për zhvillimin e një Zone Industriale në atë pjesë të komunës.

Zhvillimi i sektorit të industrisë në Komunën e Klinës duhet të zhvillohet në përputhje me Objektivin nr. 9 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) *Objektivi 9: 'Ndërtimi i infrastrukturave rezistuese, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm dhe nxitja e Inovacionit'.*

Përtej kësaj; nën **Qëllimin nr. 7** (Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i bazuar në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve dhe potencialit real zhvillimor si dhe diversifikim të aktiviteteve ekonomike) ky PZHK ka vendosur objektiva specifike për zhvillimin e sektorit të industrisë, përkatësisht *'Shfrytëzimin racional të resurseve njerëzore dhe natyrore si dhe shfrytëzimi i potencialit real zhvillimor; sidomos në Bujqësi, Industri Bujqësore...'*. (**Objektivi 7.1**)

Tutje; nën **Qëllimin nr 9** (Ndërlidhja e Arsimit me Ekonominë dhe zhvillimi i 'Mësimit Gjatë Tërë Jetës') ky PZHK ka vendosur objektivin e *'sinkronizimit të programeve arsimore në shkollat profesionale me potencialin real dhe nevojat për zhvillim ekonomik (Bujqësi, Industria Bujqësore dhe Industria e Lehtë Përpunuese.....'* (**Objektivi 9.1**).

Ndërsa **Qëllimi 8** i zhvillimit ekonomik i dedikohet drejtpërsëdrejti 'Orientimit të zhvillimit ekonomik drejt ekonomisë së bazuar në Bujqësi, Industri Bujqësore dhe Përpunuese, si dhe Shërbime'. Ky qëllim para së gjithash mund të arrihet përmes 'hartimit të Strategjisë për Zhvillimin e Integruar të Bujqësisë dhe Industrisë Bujqësore. Strategjia duhet të përfshijë edhe objektivat zhvillimore nga Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal' (**Objektivi 08.1**).

Zejtaria


Edhe pse mungojnë të dhënat për numrin e sakt të bizneseve të regjistruara e të cilat aktivitete primar i kanë aktivitetet zeytare, shumë banorë të komunës së Klinës aktivitetin e tyre zeytar e zhvillojnë në kuadër të objekteve të banimit përgjatë rrugëve kryesore. Megjithatë, zeytaria nuk është e zhvilluar në një nivel sa të jetë e rëndësishme për ekonominë e Klinës, prandaj ky sektor duhet të përkrahet me programe, masa dhe mjete konkrete. Kjo për shkak të rrezikut të mos-vazhdim, përkatësisht të shuarjes së shumë aktiviteteve zeytare, ndërsa kjo e fundit përbën rrezik jo vetëm në aspektin ekonomik (edhe ashtu të zbehtë) por edhe në aspektin socio-kulturor të komunës.

Tek qëllimet dhe objektivat për zhvillim ekonomik, ky PZHK ka vendosur **Qëllimin 8: 'Orientimi i zhvillimit ekonomik drejt ekonomisë së bazuar në Bujqësi, Industri Bujqësore dhe Përpunuese, si dhe Shërbime'**, ndërsa tek objektiva 08.3 e këtij qëllimi ky PZHK ka planifikuar 'përkrahjen e zeytarisë dhe sektorëve tjerë të marginalizuar ekonomik, përmes masave stimuluese, infrastrukturës dhe promovimit publik'.



Kuvendi Komunal Klinë

Plani Zhvillimor Komunal 2025-2033



Harta 36. Harta e Planit të zhvillimit ekonomik

4.3.3.2. Infrastruktura Teknike

Infrastruktura e ujësjellësit: Sipas te gjeturave që kanë dalur nga dokumenti i cili është punuar nga Komuna e Klinës dhe KRU Hidrodrini, ekspertët e jashtëm kanë paraqitur propozimet për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë në komunën e Klinës siç janë:

- Sigurimi i mjeteve financiare dhe ndërtimi i sistemeve të reja të ujësjellësit apo gjetja e zgjidhjeve alternative për fshatrat që nuk kanë qasje në ujë të pijshëm;
- Investimi në Fabrikën e Ujit në Klinë si në aspektin kualitativ ashtu edhe në atë kuantitativ, për eliminimin e turbullirave dhe rritjen e kapacitetit prodhues.
- Sigurimi i mjeteve dhe ndërtimi i gypit të furnizimit kryesor nga Burimi i Jarinës deri tek Stacioni i Pompimit.
- Investimi në përcaktimin e Zonave Mbrojtëse Ujore rreth resurseve ujore e posaqërisht rreth Burimit të Jarinës me qëllim të mbrojtjes së resurseve edhe ashtu të pakta ujore.
- Mirëmbajtja me kujdes të shtuar e sistemeve ekzistuese me fokus të vecantë në zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Në mënyrë që të kemi një furnizim për të gjitha vendbanimet propozohet shtimi i dy sistemeve të reja:

1. Sistemi i furnizimit me vetë rrjedhje

Ky sistem nuk shfrytëzon energji tjetër për përcjelljen e ujit, por aftësinë që ka uji për të lëvizur nga kuota më e lartë në kuotën më të ulët nga veprimi i forcës së rëndesës.

- a) Ndërtimi i një Rezervuari mbi fshatin Çabiq nga i cili do të furnizohen me ujë vendbanimet: Siqevë; Ujëmirë; Dobërdoll; Gjurgjevik i Madh; Zabërgjë; Qabiq; Caravik; Burim; Gllarevë; Rigjevë dhe Përqevë.
- b) Shtimi edhe i një rezervuari tjetër tek rezervuari ekzistues mbi qytet. Nga ky rezervar, uji me anë të pompave do të shkojë deri tek rezervuari i ri i planifikuar që do të jetë mbi Leskoc. Furnizimi me ujë i tërë komunës nga një qendër është shumë më ekonomik, më higjienik dhe më i lehtë për mirëmbajtje.

Nga ai rezervuar do të shpërndahet rrjeti i ri i ujësjellësi i cili do të furnizojë me ujë këto vendbanime: Leskoc, Dranashiq, Renoc, Zlakuqan, Radulloc, Krushevë e vogël, Gjurgjevik i Vogël, Rudicë, Stupë, Budisalcë, Nagllavë, Krushevë e Madhe, Jagodë, Videjë, Deiq, Zajm, Dollovë, Petriq i Poshtëm, Petriq i Epërm, Drenoc, Dugajevë dhe Bokshiq.




Figura 10. Sistemi i propozuar i furnizimit me ujë (me vetë rrjedhje)

2. Sistemi i furnizimit me ngritje mekanike

Shfrytëzon energji tjera për përcjelljen e ujit nga ujëmarrësi (burimi) tek përdoruesi. Uji ngitet përmes pompave në impiantin e ngritjes mekanike të ujit deri në një lartësi sa fiton presionin e kërkuar duke i përballuar edhe humbjet e mundshme që mund të ketë rrjeti i shpërndarjes në qytet.




Figura 11. Sistemi i propozuar i furnizimit me ujë (me ngritje mekanike)

Infrastruktura e kanalizimit

Vizioni i përgjithshëm për periudhën e projektimit 2046 sipas projektit të realizuar nga Komuna e Klinës, KRU Hidrodrini dhe ekspertët e jashtëm është krijimi i një sistemi plotësisht funksional të ujërave të zeza që transporton ujërat e zeza në vendin e ardhshëm të trajtimit me kërkesa të ulëta operacionale dhe ndikim të ulët mjedisor.

Në sistemin ekzistues kolektori teorikisht është i ndarë në sisteme atmosferike dhe të ujërave të zeza, por për shkak të lidhjeve pa kriter dhe lidhjeve të paligjshme nuk është realizuar realisht një sistem i veçantë.

Megjithëse gypat ekzistues të kanalizimeve nuk kanë dëmtime të mëdha, jetëgjatësia e pritshme e tyre do të arrihet ose tejkalohet për pjesën më të madhe të rrjetit të kanalizimeve për periudhën e planifikimit 2046 për shkak të cilësisë së materialeve dhe ndërtimit.

Bazuar në çështjet dhe faktet e mësipërme, se sistemi i përbashkët është përgjithësisht sistemi më i favorshëm për qytetin e Klinës, për periudhën përfundimtare të planifikimit 2046 është përcaktuar koncepti strategjik vijues për rrjetin e ujërave të zeza.

Koncepti Strategjik 2046: Rehabilitimi dhe zëvendësimi i pjesshëm i rrjetit të kanalizimeve bazuar në lidhjet shtëpiake.

Për shkak të faktit se sistemi i kombinuar i kolektorëve kryesorë është plotësisht funksional për momentin, ky do të mbetet si një sistem i kombinuar. Por ngarkesat e ujërave të shiut duhet të reduktohen dhe objektet e derdhjes së shiut duhet të ndërtohen pranë pikës së shkarkimit. Lidhja e pikave të ndryshme të shkarkimit të ujërave të zeza dhe ndërtimi i kolektorit kryesor për transportin e ujërave të zeza në impiantin e trajtimit (ËËTP). Rehabilitimi i pjesëve të rrjetit kryesor të kanalizimit duke përfshirë lidhjet shtëpiake. Pastrimi i kanaleve sipërfaqësore nga lidhjet e parregullta të ujërave të zeza. Zgjerimi i rrjetit të kanalizimeve si një sistem krejtësisht i veçantë për zonat e zgjerimit urban.




Figura 12. Sistemi aktual i përzier dhe i ndarë i planifikuar për periudhën 2046 (Burimi : KRU Hidrodrini, njësia në Klinë)

Sipas kësaj, për zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza për qytetin e Klinës dhe fshatrat e përshkruara më sipër, ato që kanë terren të përshtatshëm për t'u lidhur me TUK me anë të gravitetit, duhet të ndërtohet një kolektor i ri me standarde të larta ndërkombëtare dhe ndërtim cilësor. Ky kolektor ka për qëllim grumbullimin e ujërave të zeza nga fshatrat mbi qytetin e Klinës (Zllakuqan, Jagodë dhe Videjë) dhe më pas nga zona e qytetit të Klinës dhe Klinavcit dhe duke vazhduar përgjatë lumit Drini i Bardhë në drejtim të rrjedhjes natyrore dhe grumbullimit të ujërave të zeza të fshatrave Deiq, Zajm, Dollc, Dresnik, Gremnik, Dellovë dhe Qupevë.

Gjatë vizitave në terren, analizës së hartave topografike, konsultimeve me KRU-të përkatëse dhe komunën e Klinës duke respektuar PZHK-në, grupi punues ka konstatuar se lokacioni i përshtatshëm për ndërtimin e impianteve kryesore është vendi/lokacioni i cili pason rrjedhën natyrore të lumit Drini i Bardhë.

Vendi/lokacioni i kërkuar për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza sipas KRU Hidrodrini, njësia në Klinë duhet të plotësojë disa nga kriteret e mëposhtme:

- Të jetë në një distancë të mjaftueshme nga vendbanimi (min 300m);
- Të jetë në një pozicion ku grumbulluesit mund të shkarkohen nga sa më shumë vendbanime të jetë e mundur;
- Të jetë pronë publike (me prioritet);
- Tokë ndërtimore e përshtatshme për ndërtimin e objekteve të TPU;
- Të ketë akses në rrugë, ujë, energji elektrike etj;
- Të jetë jashtë rrezikut nga përmytjet;
- Të ketë akses të lehtë për operim dhe mirëmbajtje.

Nga sa u tha më sipër, janë identifikuar 3 lokacione të cilat potencialisht mund të konsideroheshin si më të përshtatshmet për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, ku prej këtyre lokacioneve është konsideruar që më i përshtatshmi është lokacioni C.

Lokacioni C: Vazhdimi i rrugës në të njëjtin drejtim për rreth 1,200m poshtë lokacionit B. Në zonën kadastrale të Kpuzit është një parcelë shumë e përshtatshme (nr. parcelës: 00035-1) për ndërtimin e Impiantit.



Avantazhi kryesor i këtij lokacioni është pronësia e tij. Parcela me numër: 00035 - 1 është një ngastër e madhe që është pronë publike dhe për rrjedhojë e bën shumë më të lehtë aktivitetin e shpronësimit. Gjithashtu, kjo pjesë është më e lartë se zona e përmbajtjes në atë pjesë (mbi kuotën 410 m), ndërsa toka është e cilësisë së lartë ndërtimore. Shtëpitë më të afërta nga ky vend janë në një distancë prej mbi 400.

Hapësira e propozuar për ndërtimin e Impiantit në Klinë është pronë publike dhe rrjedhimisht komuna e Klinës duhet të angazhohet maksimalisht në rregullimin e çështjes pronësore dhe sigurimin e të gjitha lejeve të nevojshme për ndërtim. Është e rëndësishme që KRU-të të punojnë ngushtë me komunën dhe ministritë përkatëse për të zgjidhur të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me shpronësimet e tokës.

Është propozuar që impianti i trajtimit të ujërave të zeza të qytetit të projektohet për të përfshirë fshatrat që shtrihen përgjatë rrjedhës së lumit Drini i Bardhë dhe që mund të lidhen me kolektorin që do të ndërtohet nga qyteti deri tek impianti. Fshatrat të cilat konfigurimi i terrenit i lejon të lidhen me këtë impiant janë:

Tabelë 80. Lista e fshatrave të përshtatshme për lidhje në Impiantin e Klinës

Fshatrat	Nr/ banorëve (2011)	Nr/banorëve (2046)
Klina	5,471	
Videjë	662	
Jagodë	195	
Zllakuqan	1,013	
Klinavc	480	
Deiq	374	
Zajm	1,274	
Dresnik	1,776	
Dolc	276	
Gremnik	1,131	
Qupevë	584	
Dollovë	444	
TOTAL	13,680	17,544
TOTAL	15,000	20,000

Për të gjitha fshatrat e tjera të komunës së Klinës, ato që nuk mund të përfshihen, duhet të bëhen zgjidhje të decentralizuara, pra me impiante të vogla biologjike.


Veprimet konkrete që duhet të ndërmerren në raport me infrastrukturën e kanalizimit dhe trajtimit të ujërave të zeza:

- Ndërtimi i sistemit të kanalizimit të ujërave të zeza për tërë komunën e Klinës;
- Koncentrimi i të gjithë ujërave të zeza në dy kolektorët kryesor të cilët do të jenë në dy anët e lumit Drini i Bardhë;
- Ndërtimi i kolektorit kryesor në anën e djathtë të lumit Drini i Bardhë ku do të shkarkoheshin ujërat e zeza të këtyre vendbanimeve: Stupë, Budisalc, Nagllavë, Krushëvë e Madhe, Jagodë, Videjë, Deiq, Zajm, Dollovë, Petriq i Poshtëm, petriq I Epërm, Drenoc, Dugajevë, Bokshiq, Grabanicë, Qeskovë dhe Këpuz. Ndërtimi i kolektorit kryesor në anën e majtë të lumit Drini i Bardhë ku do të shkarkoheshin vendbanimet: Bërkovë, Leskoc,



Drashaniq, Zllakuqan, Grapc, Bingjë, Shtupel, Radulloc, Krushëv e Vogël, Gjurgjevik i Vogël, Klinë, Jashanicë e Epërme, Kërnice, jashanicë, Resnik, jellocë, Siqevë, Dush, Pogragjë, Gjurgjevik i Madh, Dërsnik, Dollc, Gremnik, Qupevë, Qabiq, Zabërgjë, Dobërdoll, Ujëmirë, Gllarevë, përqevë, Sferkë, Dushi i Vogël dhe Volljakë.

- Ndërtimi i impiantit në Kpuz;
- Ndërtimi i kolektorit të përbashkët për vendbanimin Rixhevë dhe Burim;
- Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave atmosferik;
- Ndarja e sistemit të shkarkimit të ujërave atmosferik nga kanalizimi i ujërave të zeza;
- Shkarkimi i ujërave sanitare ose industrial të bëhet në sistemin e ujërave të zeza.



Harta 37. Harta e planit të ujësjellësit dhe kanalizimit



4.3.3.3. Energjia elektrike dhe Termike

- Është propozuar ndërtimi i një trafostacioni 110/10(20) që do të stabilizonte dukshëm furnizimin me energji elektrike;
- Për nëstacionin 110/10kV/kV të Klinës propozohet rritje e fuqisë instaluese nga 31.5 MVA në 40 MVA duke shtuar 5 dalje 10 kV;
- Për qytetin e Klinës është propozuar zgjerim i rrjetit elektroenergjetik për ndërtimet e larta, me fuqi instaluese transformatorike 2x4MVA.
- Për Zonën Industriale në Klinë është propozuar **zgjerimi i rrjetit elektroenergjetik me fuqi transformatorike 2x4 MVA**. Ky rrjet do të ketë dy dalje 10 kV në Zonën Urbane (Zona Urbane 1 dhe Zona Urbane 2) si dhe dy dalje 10 kV në Zonën Ekonomike (Zona Industriale 1 dhe Zona Industriale 2). Lokacioni i saktë i nën-stacionit të ri do të përcaktohet pas vlerësimit teknik nga nga komuna, KEK dhe/apo KEDS.


Tutje; gjatë instalimit të rrjetit të ri elektro-energjetik, por edhe gjatë rehabilitimit të rrjetit ekzistues, duhet të zbatohen normat teknike të aplikueshme:

- a. Objketet e ndërtuara në largësi optimale nga pjesët e ndërtuara të vendbanimeve, me përjashtim të ndërtesave industriale të rezistueshme ndaj djegies.
- b. Për linjat ajrore me tension deri 1.00 kv të realizuara me kabllot e fiksuara në tirant, largësia ajrore e linjës nga pjesët e fasadës së ndërtesës (ballkon, lozhë, dritare, verandë) nuk duhet të jetë më e vogël se 2.00 m;
- c. Për linjat nëntokësore, largësia ajrore e linjës duhet të jetë jo më e vogël se 1.00 m nga vija ndërtimore.

Duke marrë parasysh investimet e planifikuara, komuna duhet të bashkërendis investimet kapitale në bashkëpunim me KEDS-in për të harmonizuar ndërtimin e rrjeteve të reja dhe infrastrukturën teknike dhe të transportit.

Sa i përket burimeve të ripërtëritshme të energjisë ky plan parasheh që zonat e përcaktuara me Hartën e Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës si “zona bujqësore me shfrytëzim të përkoshëm për energji të ripërtëritshme” në zonat kadastrale Perqevë, Sferkë, Dush i Vogël dhe Binxhë të shfrytëzohen për këtë qëllim.

Ndërsa, Komuna e Klinës mund gjithashtu të fokusohet në shfrytëzimin e potencialit për burime të ripërtëritshme të energjisë, sidomos në zonat kadastrale në Zllkuaqan, Binxhë, Kpuz, Volljak, Sferkë, Perqevë, Jashanicë, Siqevë, Dobërdoll, Çabiq, Caravik, Zabërgjë, Dobërdoll, Gjurgjevik i Madh, Nagllavkë, , Bokshiq, Qeskovë, Dollovë, Qupevë, Gremnik, Dush etj. Edhe në këto zona kadastrale zona bujqësore me potencial për energji të ripërtëritshme do të jetë zonë me shfrytëzim të përkoshëm për energji të ripërtëritshme, ndërsa fokusi i aktivitetit duhet të jetë në hapësirat të cilat i takojnë klasëve V-VIII të bonitetit të tokës. Aty ku është e domosdoshme që aktiviteti të zhvillohet në hapësirat me bonitet I-IV, shfrytëzimi duhet të bëhet në atë mënyrë që të mos e dëmtojë dhe/apo degradojë tokën bujqësore. Zgjidhjet teknike për gjenerimin e energjisë së ripërtëritshme në këto zona kadastrale me potencial për energji të ripërtëritshme duhet të respektojnë këtë zotim dhe nevojë për të mos dëmtuar dhe degraduar tokën bujqësore.




Harta 38. Harta e planit të energjisë elektrike dhe termike

Sa i përket ndriçimit publik të rrugëve; ky PZHK ka planifikuar investime në sistem eficient të ndriçimit publik, kompletim të ndriçimit publik të rrugëve në të gjithë zonën urbane si dhe zonat qendër të vendbanimeve tjera si dhe orientim drejt energjisë së ripërtërithsme/kalim në sistem eficient të ndriçimit publik.

4.3.3.4. Telekomunikacioni

Plani për zhvillimin e sektorit të telekomunikacionit në Komunën e Klinës synon përmirësimin e infrastrukturës dhe qasjes në shërbime digjitale për të adresuar sfidat ekzistuese, si varësia nga telefonia celulare, qasja e kufizuar në internet dhe posedimi i ulët i kompjuterëve. Për këtë, është i nevojshëm zgjerimi i rrjetit të telefonisë fikse dhe fibrave optike në të gjitha zonat, duke rritur cilësinë e lidhjes dhe mbulimin e sinjalit. Ky PZHK parasheh instalimin e një antene të PTK-së në qytetin e Klinës. Gjithashtu, do të vendosen pika të reja Wi-Fi në hapësira publike për të lehtësuar qasjen në internet për familjet pa lidhje të përhershme. Përmirësimi i cilësisë së sinjalit të telefonisë celulare do të arrihet përmes instalimit të stacioneve të reja bazë në zona rurale dhe zonat me mbulim të dobët. Po ashtu, do të krijohen qendra komunitare të pajisura me kompjuterë për përdorim publik dhe programe për subvencionimin e pajisjeve digjitale për familjet me të ardhura të ulëta. Këto masa do të shoqërohen me trajnime për rritjen e njohurive digjitale dhe përdorimin e shërbimeve online, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik dhe social për të gjithë komunitetin.




Harta 39. Harta e planit të telekomunikacionit dhe instalimeve të ngjajshme

4.3.3.5. Menaxhimi dhe grumbullimi i mbeturinave

Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Mbeturinave 2023-2027 do të jetë thelbësor për arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në Komunën e Klinës dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të saj.

Zhvillimi i sektorit për menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave në Komunën e Klinës, në kuadër të Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033, do të ndjekë udhëzimet dhe prioritetet e përcaktuara në Planin për Menaxhim të Mbeturinave 2023-2027. Qëllimi është të krijohet një sistem efikas dhe i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve që promovon ndarjen në burim, riciklimin dhe zvogëlimin e mbetjeve që shkojnë në deponi. Aktivitetet kryesore përfshijnë përmirësimin e infrastrukturës për grumbullim dhe trajtim, ndërtimin e qendrave të riciklimit dhe kompostimit, modernizimin e deponive dhe zbatimin e një sistemi elektronik për monitorimin e performancës. Plani do të mbështetet nga masa të ndryshme politike, duke përfshirë taksa të diferencuara dhe incentiva për investimet në teknologji të qëndrueshme, ndërsa do të promovohet pjesëmarrja aktive e komunitetit përmes edukimit dhe fushatave të ndërgjegjësimit. Këto masa do të ndihmojnë në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe në ruajtjen e mjedisit në përputhje me standardet ligjore dhe të zhvillimit të qëndrueshëm.



Harta 40. Harta e Planit të menaxhimit të mbeturinave

4.3.3.6. Infrastruktura e Transportit dhe Transporti

Përkundër investimeve të vazhdueshme në infrastrukturën rrugore e cila mbulon qasjen në rrugë të asfaltuara të qytetarëve është e nevojshme të vazhdohet me investime në rrugë të reja dhe në mirëmbajtjen e atyre egzistuese, me qëllim që të përmirësohet kualiteti i jetës së qytetarëve. Në funksion të zhvillimit të infrastrukturës rrugore dhe lehtësimit të qasjes në rrugë për të gjithë qytetarët dhe aktivitetet ekonomike në tërë territorin e komunës së Klinës është e nevojshme që të investohet në projekte të reja për hapjen e traseve të rrugëve, asfaltimin e traseve egzistuese, ndërtimin e trotuareve, akomodimin në qarkullim të biciklistëve (në zonën e qytetit) dhe mirëmbajtjen e tyre në të gjitha kategoritë. Bazuar në gjendjen ekzistuese, vizionin dhe qëllimet e përcaktuara në këtë dokument, kërkohet që të kemi një mbulueshmeri të mjaftueshme hapësinore me infrastrukturë rrugore, plotësimin e nevojave për popullsinë dhe ekonominë në tërë territorin e komunës. Planifikimi i infrastrukturës së transportit dhe transportit në komunën e Klinës do të jetë i bazuar në:


- Hapjen e traseve të reja në kategorinë e rrugëve lokale dhe rajonale;
- Asfaltimin e rrugëve lokale që lidhin vendbanimet periferike dhe hapësirat brenda zonave të banuara;
- Rregullimin e trotuareve përgjatë rrugëve kryesore në zonat e banuara;
- Ndërtimin dhe riparimin e urave në rrugët lokale dhe rajonale;
- Rregullimi i kryqëzimeve në rrugët të gjitha kategoritë e rrugëve, përfshirë kryqëzimet e

rrugëve me hekurudhat;

- Ndërtimin e mureve mbrojtëse në rrugët regjionale, për mbrojtje nga zhurma në hapërsirat e banuara;
- Zhvillimi i rrjetit ekzistues dhe ndërtimi i shtigjeve të reja për biciklistët;
- Rregullimi dhe menaxhimi i parkigjeve publike në zonat urbane;
- Rregullimi i sinjalistikës rrugore në të gjitha kategoritë e rrugëve.

Rrugë regjionale - Në kategorinë e rrugëve regjionale (R104 dhe R105) është e nevojshme të vazhdohet me shtrimin e trotuareve në zonat e banuara. Poashu nëdy kryqëzimet me hekurudhën duhet rregulluar kalimet me qëllim të rritjes së sigurisë rrugore. Brenda zonës së qytetit, është e nevojshme të rregullohet çështja e parkingjeve publike dhe menaxhimit të tyre. Shtegu i biçiklistëve është e nevojshme të ndërtohet duke filluar nga qendra e qytetit në drejtim të periferisë përgjatë rrugëve regjionale. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal është e nevojshme të rishikohet, plotësohet me qëllim të përmbytjes së funksionit të tij.

Rrugë lokale - Në kategorinë e rrugëve lokale është e nevojshme që të investohet në asfaltimin e rrugëve që lidhin vendbanimet periferike, si dhe të asfaltohen rrugët që lidhin lagjet e caktuara brenda zonave të banuara. Rrugët ekzistuese lokale është e nevojshme të përmirsohen në gjerësinë e tyre si dhe akomodimin e këmbësorëve. Kryqëzimet me rrugët e nivelit më të lartë (nacionale dhe regjionale), është e nevojshme të vendoset sinjalistikë adekuate (kryqëzimet me rrugët (N9, R104 dhe R105).



Harta 41. Harta e planit të infrastrukturës së transportit




Transporti - Duke pasur parasysh që zona urbane e Klinës, shtrihet në largësi të ndryshme nga vendbanimet periferike të komunës (deri 19 km), është e nevojshme që transporti i udhëtarëve të organizohet në funksion të lehtësimit për qarkullimin e qytetarëve.:

- Stacioni i autobuseve të rregullohet sipas standardeve dhe të paiset me pajisje të TI të kohës.
- Të ndërtohen stacionet e vendndaljes së autobusëve për linjat ndërrurbane dhe lokale të tipit SMART station (stacione të menqura).
- Të gjithë autobusët e linjave lokale të jenë të paisur me GPS.
- Të përfshihen në rrjetin e transportit lokal edhe vendbanimet që nuk përfshihen aktualisht (Binxhë, Dugajevë, Dush, Grapc, Gjyrgjevik i Madh, Jashanicë, Jelloc, Ranoc, Rudicë, Stupë,
- Transporti lokal do të mbulohet nga operatorët të cilët do të mbulojnë të gjitha vendbanimet lokale, varësisht nga distanca. Itinerari i lëvizjes do të jetë nga 60 deri 120 minuta, varësisht nga distanca e vendbanimit. Orari i qarkullimit të linjave do të jetë nga ora 6:30 deri 20:00. Të gjitha linjat lokale do të kenë pikënisje stacionin e autobusëve në Klinë, si në tabelën në vijim

Tabelë 81. Vendbanimet sipas transporti lokal

LINJAT LOCALE TË TRANSPORTIT PUBLIK					
Nr	Vendbanimi	Nr i popullsisë	Qasja	Distanca [km]	Itinerari [min]
1	Leskoc	239	Me transport publik	12	60
2	Siqevë	1,338	Me transport publik	11.6	30
3	Ujmirë	544	Me transport publik	17	30
4	Shtupel	771	Me transport publik	7	30
5	Kernicë	794	Me transport publik	6	30
6	Budisalc	398	Me transport publik	11	60
7	Bokshiq	438	Me transport publik	9	60
8	Këpuz	622	Me transport publik	13	30
9	Resnik	399	Me transport publik	10	60
10	Caravik	1,241	Me transport publik	19	30
11	Perqevë	1,005	Me transport publik	16	30
12	Sferkë	2,448	Me transport publik	13	30
13	Binxhë	117	Pa transport publik	8	60
14	Dugajevë	399	Pa transport publik	11	60
15	Dush	241	Pa transport publik	13	60
16	Grapc	206	Pa transport publik	13	60
17	Gjyrgjevik i Madh	449	Pa transport publik	12	60
18	Jashanicë	1,784	Pa transport publik	10	30
19	Jelloc	27	Pa transport publik	9	60
20	Ranoc	353	Pa transport publik	10	60
21	Rudicë	446	Pa transport publik	11.9	60
22	Stupë	179	Pa transport publik	12.5	60
Popullsia		38,496	Distanca mesatare	11.6	



Harta 42. Harta e planit të transportit urban-rural

4.3.3.7. Infrastruktura Publike e Planifikuar

Infrastruktura publike e planifikuar për komunën e Klinës do të ndikojë drejtëpërdrejtë në përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve që jetojnë në këtë komunë. Infrastruktura publike ekzistuese ka nevojë të përmirësohet në të ardhmen me hapësira të reja, shërbime efikase e cilësore, qasje më të shpejt dhe më të lehtë dhe pajisje adekuate.

Bazuar në gjendjen ekzistuese, vizionin, qëllimet dhe objektivat e përcaktuara me këtë plan, kërkohet që komuna të ketë hapësira të mjaftueshme të shërbimeve publike, një mbulueshmëri të mjaftueshme hapësinore për gjithë territorin e komunës, qasje të mirë, ngritje të cilësisë në shërbime dhe dixhitalizimin e tyre, pajisje adekuate dhe mirmbajtje e vazhdueshme.

Planifikimi i infrastrukturës publike në komunën e Klinës do të jetë i bazuar në:

- Ngritjen e kapaciteteve në shërbime publike duke ndërtuar hapësira të reja, zgjerimin e hapësirave në disa objekte ekzistuese si dhe renovimin e rehabilitimin e objekteve varësisht nga nevoja.
- Mbulimin e gjithë territorit të komunës dhe vendbanimeve të saj me shërbimet e nevojshme
- Ngritjen e cilësisë së shërbimeve, pajisje adekuate dhe dixhitalizim
- Qasje më të mirë dhe mirmbajtje e tyre.

Zhvillimi hapësinor i vendbanimeve dhe trendet demografike gjatë 8 viteve të ardhme duhet të përcillen me kujdes dhe të sigurohen shërbimet e nevojshme publike.



Propozimet konkrete për shtimin e hapësirave të reja për infrastrukturë publike, si dhe rehabilitime atyre ekzistuese janë paraqitur në Planin e Veprimit të këtij PZHK.

Institucionet arsimore

Sa i përket shërbimeve arsimore, gjendja është relativisht e mirë dhe në të ardhmen synohet të arrihet qëllimi që ka të bëjë me cilësinë dhe gjithpërfshirjen në arsim.

Për ta siguruar hapësirën e nevojshme me objekte parashkollore – çerdhe, kërkohet që të ndërtohen objekte të reja për ti plotësuar kërkesat. Aktualisht ke vetëm një çerdhe publike në qytetin e Klinës, e cila nuk i plotëson nevojat e zonës urbane. Për të ardhmen është propozuar ndërimi i edhe 6 objekteve të tjera për çerdhe në komunën e Klinës. Çerdhet janë planifikuar në vendbanimet: Klinë, Dresnik, Gllarevë, Jashanivë, Sferkë dhe Zllakuqan. Në këtë drejtim do të inkurajohen edhe investime nga sektori privat në sigurimin e këtij shërbimi në bashkëpunim me komunën. Për ndërtimin e këtyre objekteve parashkollore janë planifikuar edhe parcelat kadastrale si: Klinë (Zona Kadastrale Klinë, numri i parcelës 00520-1), Dresnik (Zona Kadastrale Dollc, numri i parcelës 00095-0), Gllarevë (Zona Kadastrale Gllarevë me nr. të parcelës 001074-2), Jashanicë (ZK Jashanicë me nr. të parcelës 769-2), Sferkë (ZK Sferkë me nr. parcelës 00130-0) dhe Zllakuqan (ZK Berkovë me nr. të parcelës 00414-1-47)

Sa i përket arsimit parafillor, ky nivel i shkollimit është i organizuar në hapësirat ekzistuese të shkollave filllore të mesme të ulëta. Në të ardhmen kërkohet që të rishikohet kjo hapësirë për shkollimin parafillor dhe të plotësohet hapsira shkollore sipas nevojave që kërkohet për këtë nivel të shkollimit.

Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët planifikohet ndërtimi i një shkolle në zonën urbane (Dollc) ku planifikohet edhe parcela në zonën kadastrale të Dollcit me nr. të parcelës 00095-0. Gjatë periudhës së realizimit të këtij plani, planifikohet që të bëhet rindërtimi dhe renovimi i shkollave filllore në Klinë; Zllakuqan, Çabiq, Ujmirë; Caravik; Jashanicë; Gjurgjevik i Madh; Pjetërq i Epërm; Shtupel; Budisalc dhe Gremnik deri në vitin 2033.

Është planifikuar po ashtu edhe ndërtimi i anekseve të veçanta për klasa për shkollën filllore “Dëshmorët” në Volljakë dhe Paralelen e Ndarë në shkollën filllore “Motrat Çiriazhi në Zajm.

Është planifikuar edhe rindërtimi i shkollave në zonat kadastrale si më poshtë:

- SHFMU “Motrat Qiriazhi” Klinë (ZK Klinë nr. parcelës 00520-1);
- SHFMU “Atë SHTjefan Gjeqovi” Zllakuqan (ZK Berkovë nr. i parcelës 00414-1-47-0);
- SHFMU “Motrat Qiriazhi” Zajm (ZK Zajm nr. i parcelës 00008-23).

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është planifikuar ndërtimi i aneksit në gjimnazin Luigj Gurakuqi. Në këtë nivel të arsimit, është me rëndësi që të arrihet një përfshirje më e madhe e nxënësve në arsimin profesional si dhe zhvillimi profesional i mësimdhënësve.

Gjithashtu është planifikuar edhe zgjerimi i hapësirave shkollore për shkollimin fillor dhe të mesëm të lartë dhe atë si vijon:

- Ndërtimi i një Aneksi të veçantë për administratë dhe laboratorë në gjimnazin “Luigj Gurakuqi”. Ky aneks është planifikuar të ndërtohet në Zonën Kadastrale Klinë, respektivisht në parcelën me Nr. 585-1;
- Ndërtimi i një Aneksi në IAAP “Fehmi Agani” Klinë për punë praktike (ZK Klinë nr. parcelës 018-0).

Tutje: gjatë periudhës së implementimit të këtij plani, është planifikuar edhe ndërtimi i sallave sportive në shkollat me numër më të madh të nxënësve si:

- SHFMU “Motrat Qiriazhi Klinë (ZK Klinë nr. parcelës 00520-1);



- SHFMU “Emin Duraku” Sferkë (ZK Sferkë nr. parcelës 00130-1);
- SHFMU “Dëshmorët e Qëndresës” Gllarevë (ZK Gllarevë nr. parcelës 001074-2);
- SHFMU “Atë Shtjefan Gjeqovi” Zllakuqan (ZK Bërkovë nr. parcelës 00414-1-47-0).

Gjatë përmirësimit të infrastrukturës shkollore duhet të intervenohet edhe në hapësirat përcjellëse të shkollave, respektivisht në rregullimin e oborreve, parqeve dhe hapësirave rekreative e sportive.

Institucionet shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale


Objektet shëndetësore në komunën e Klinës kanë një shtrirje të mirë hapësinore dhe gjithashtu ka edhe infrastrukturë dhe hapësirë të mjaftueshme. Në të ardhmen synohet ngritja e nivelit të shërbimeve shëndetësore dhe mirëqenies sociale duke synuar: Përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, avancimin e Sistemit Informativ Shëndetësor (SISH) dhe platformave tjera digjitale për shëndetësi, rritjen e kujdesit ndaj grupeve sociale me gjendje të vështirë shëndetësore dhe ekonomike – përmes vizitave shëndetësore në shtëpi, identifikimi dhe trajtimi i familjeve strehuere, njohja e statusit si ofrues të shërbimeve, licencimi i tyre si dhe ofrimi i benefiteve si njohja e stazhit të punës si dhe pagesat për to si dhe Krijimi i grantit specifik për financimin e shërbimeve sociale dhe familjare në nivelin komunal.

Hapësira e objekteve shëndetësore në komunë është e mjaftueshme dhe në të ardhmen planifikohet të ndërtohet vetëm një objekt shëndetësor- QMF në Dollc si dhe të shtohet një aneks në QKMF të Klinës për shërbimet e emergjencës. Më shumë hapësira kërkohet për përkujdesje sociale ku janë planifikuar: ndërtimi i shtëpisë së pleqve, ndërtimi i shtëpisë së sigurtë, ndërtimi i objektit të ri për familjet në nevojë sociale të cilat nuk e kanë të zgjidhur çështjen e banimit si dhe renovimi i objekteve të banimit social.

Veprimet konkrete në raport me institucionet shëndetësore dhe të përkujdesjes sociale- bashkë me koston dhe kohën e realizimit të tyre janë paraparë në Planin e Veprimit të këtij PZHK.

Administrata publike

Hapësira për shërbime administrative në komunën e Klinës është e mjaftueshme dhe ka një shtrirje të mirë hapësinore me një koncentrim më të lartë në qytetin e Klinës. Në aspektin e përmirësimit të shërbimeve, parashihet të kemi një administratë më efikase. Kjo mund të arrihet me decentralizim të shërbimeve administrative përmes e-kiosqeve, përmirësimin e kushteve dhe ngritjes së shërbimeve administrative si dhe ofrimin e shërbimeve administrative në formë elektronike – e-administrata. Trajnimet e vazhdueshme të stafit janë planifikuar po ashtu, në mënyrë që të ketë ngritje të vazhdueshme të performancës së personelit dhe rrjedhimisht të ketë ngritje të vazhdueshme të cilësisë së shërbimeve.



Harta 43. Harta e planit të Institucioneve publike dhe sociale

4.3.3.8. Infrastruktura Sociale e Planifikuar


Ndërtesat kulturore, Sportive dhe Rekreative

Kapacitetet e hapësirave të bibliotekës, shtëpisë së kulturës dhe hapësirave sportive janë të pamjaftueshme në komunën e Klinës si dhe ka një koncentrim vetëm në qytetin e Klinës. Këto hapësira planifikohen të zgjerohen në të ardhmen me qëllim të përmirësimit të gjendjes. Në këtë aspekt, planifikohet të ndërtohet teatri i hapur në Dresnik-Dolc (në afërsi të lokalitetit arkeologjik). Për realizimin e këtij projekti kërkohet që të sigurohet prona nga AKP. Në këto hapësira do të vendosen edhe shtëpia e kulturës, galeria, teatri dhe ansambli.

Zgjerimi i hapësirave sportive, rekreative e kulturore do të ketë një rritje të vazhdueshme gjatë gjithë periudhës së implementimit të këtij plani duke shfrytëzuar kryesisht hapësirat e shkollave. Do të sigurohen hapësira sportive dhe rekreative në të gjitha shkollat e komunës. Parcelat kadastrale ku gjenden objektet arsimore apo shkollore gati në të gjitha vendbanimet e komunës së Klinës kanë sipërfaqe të mëdha. Bazuar në NTPH për hapësira shkollore, në shumicën e vendbanimeve kemi tejkalim të normave. Kjo lejon që parcelat të shfrytëzohen në mënyrë më efikase, ndërsa mundëson edhe ruajtjen e tokës në këto vendbanime. Ky shfrytëzim racional i tokës është në përputhje me vizionin dhe politikat e komunës për një zhvillim të qëndrueshëm dhe menaxhim eficient të resurseve natyrore. Për këtë arsye, këto parcela do të shfrytëzohen edhe për ndërtimin e hapësirave sportive, në mënyrë që të plotësohen edhe kriteret minimale të NTPH për hapësira sportive në komunë. Ky shfrytëzim racional i tokës në asnjë mënyrë nuk do të cenojë kërkesat minimale për hapësira



shkollore. Në të ardhmen planifikohet që ti kushtohet një vemendje më e madhe edhe sportit, kulturës dhe artit, e sidomos tek të rinjtë. Kërkohej një stimulim më i madh i të rinjve për sport, kulturë e art duke organizuar sa më shumë aktivitete dhe evente të kësaj fushe. Krahas kësaj, do të shtohen edhe hapësirat për këto aktivitetet dhe do të përmirësohen kushtet në përgjithësi.




Harta 44. Harta e planit të Hapësirave Sportive

Hapësirat e hapura publike dhe sociale


Hapësirat publike ekzistuese do të rregullohen dhe mirëmbahen vazhdimisht si dhe do të shtohen edhe hapësira të reja. Gjithashtu, do të planifikohen edhe hapësirat e vendosjes së shtatoreve dhe përmendoreve në hapësirat publike të komunës.

Ky PZHK parasheh ndërtimin e tri parqeve të reja si dhe ndërtimin e liqenit akumulues.

Veprimet konkrete në raport me infrastrukturën sociale të planifikuar- bashkë me koston dhe kohën e realizimit të tyre janë paraparë në Planin e Veprimit të këtij PZHK.



Në përgjithësi, hapësirat për varreza dhe objekte fetare i plotësojnë nevojat bazuar edhe në Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, por në të ardhmen planifikohet që në disa vendbanime të ketë zgjerim të këtyre hapirave, si: Zonën Urbane, Gllarevë, Carravik, Deiq, Gjurgjevik i Vogël, Kërrnicë. Një nga aktivitetet që parashihet në të ardhmen është edhe rrethimi i hapësirave të varrezave dhe objekteve fetare si dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e tyre.



Harta 46. Harta e planit të menaxhimit të varrezave

4.3.3.9. Mjedisit dhe Sipërfaqet me rrezikshmëri Mbrotjtja e mjedisit

Në raport me mbrotjtjen e mjedisit, ky PZHK ka paraparë përcaktimin dhe implementimin e masave mbrotjtëse përkatëse për amortizim të efekteve negative në mjedis, mbrotjtje ndaj ndotësve dhe kërcënuesëve të tjerë mjedisor, si dhe masa për zhvillim kualitativ mjedisor. Vlerat natyrore të komunës si ato pyjore, ujore e bujqësore të cilat konsiderohen potenciale të rëndësishme, krahas ruatjes strikte të tyre, do të shfrytëzohen edhe për zhvillim të turizmit. Shfrytëzimi i këtyre aseteve do të bëhet konform standardeve mjedisore dhe praktikave më të mira në këtë fushë si dhe duke ruajtur balancën ekologjike të ekosistemit. Tutje; Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) i këtij PZHK përcakton masa dhe veprime për zvogëlimin e ndikimit negativ në mjedis të zhvillimeve të parapara me këtë dokument, e të cilat janë të integruara në fushën e mbrotjtjes së mjedisit.

Bazuar në rekomandimet e VSM-ës për mbrotjtjen e cilësisë së ujërave sipërfaqësor nga veprimet degraduese dhe fatkeqësitë natyrore, masat që duhet të ndërmerren janë: kushtëzimi i operatorëve ekonomik për aplikimin e masave për arritjen e minimumit ekologjik, monitorim dhe kujdes rigoroz për ndalimin e eksploatimit të zhavorrit, ndërtimin e pendave për ujitje (kanalet e ujitjes), zbatimin e masave që dalin nga dokumenti “Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në territorin e komunës së Klinës”.



Mbrojtja e sipërfaqeve ujore

Masat mbrojtëse për sipërfaqet ujore përcaktohen bazuar në UA. nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor. Burimet e ujërave klasifikohen në burime nëntokësore dhe sipërfaqësore. Me qëllim të mbrojtjes së burimeve të ujërave përcaktohen zonat e mbrojtura ujore, të cilat ndahen në:

- 1. Zona e mbrojtjes së regjimit të rreptë**, e cila ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e burimit të ujit dhe ndërtesave me instalime për marrjen e ujit si dhe të mbrojtë burimin nga shkarkimet e ndotësve që mund të ndikojnë drejtpërdrejt në ujë nga aktivitetet e njeriut;
- 2. Zona e mbrojtjes së regjimit të kufizuar**, e cila ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e burimit të ujit nga lëvizjet e ndotësve mikrobiologjik, kimik dhe llojeve të tjera të ndotësve;
- 3. Zona e mbrojtjes së regjimit të lehtë**, e cila ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen parandaluese për pellgun përkatës të burimit të ujit dhe të rrisë efikasitetin e mbrojtjes nga ndotja kimike dhe radioaktive. Ndër të tjera është parashikuar si vijon:

Ky PZHK planifikon mbrojtjen e të gjitha burimeve të ujërave natyrale, termale dhe termo - minerale si dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor - ashtu siç janë paraparë edhe me hartën hidrologjike të komunës së Klines. Masat mbrojtëse përfshijnë edhe caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim të caktuar të mbrojtjes, varësisht nga nevoja, përkatësisht gjendja në terren.

Do të parandalohet ndërtimi i objekteve dhe/apo zhvillimi i aktiviteteve tjera në këto zona. Nuk do të lejohet as shfrytëzimi i tokës në atë mënyrë që të rrezikojë sasinë dhe kualitetin e ujit;

Do të merren masat e nevojshme për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërat e përdorura (nga amvisëira, industria dhe aktivitetet tjera ekonomike) duke bërë trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera si vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti etj. Do të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura (urbane dhe industriale) para se të lëshohen të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike.

Mbrojtja e ajrit

Sipas ligjit nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, komuna në bashkëpunim me MMPHI do të bëjë kontrollimin e vazhdueshëm të emetimeve të pluhurit dhe tymit nga ndotësit kryesor të ajrit në komunë. Planifikohet krijimi i brezave të gjelbër përgjatë rrugëve kryesore dhe rrjedhave të lumenjëve, me qëllim të amortizimit të ndotjes nga pluhuri, gazrat dhe zhurma.

Në mënyrë që të mbrohet ajri, është e nevojshme që të kontrollohet lokacioni për prodhimin e pajisjeve dhe llojin e teknologjisë, llojin e energjisë dhe të stimulohet energjia e pastër dhe energjia ripërtëritëse.

Bazuar në rekomandimet e VSM, masat që duhet të ndërmmiren për monitorimin e cilësisë së ajrit janë: vendosja e stacionit për monitorimin e kualitetit të ajrit në komunë apo pajisje mobile për monitorimin e ndotësve të ajrit, me fokus të veçantë ata për matjen e sasisë së sulfurit dhe ndotësve që lirohen nga djegia e mbeturinave.

Bazuar në veprimet që rekomandohet në VSM për zvogëlimin e ndikimit mjedisor negativ, masat që duhet të ndërmmiren janë: hartimi i Planit të Mobilitetit i cili do të nxiste krijimin e kushteve për përdorim të transportit publik, ecjes dhe çiklizimit, ndërtimin e rrugëve tranzitore të cilat do e zhvendosnin komunikacionin e rëndë në periferi, modifikimin e planit dhe sistemit ekzistues të menxhimit të mbeturinave, planifikimi për shtim të hapësirave të gjelbërta në përgjithësi e në veçanti në të gjitha hapësirat ekzistuese publike.



Mbrojtja e ujit

Gjatë dhënies së lejeve për planifikim, me qëllim të mbrojtjes së ujit nëntokësor, është e nevojshme që të rregullohen masat për mbrojtje në vijim:

- Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza me elemente të papërshkueshme nga uji
- Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhimit

Po ashtu, kujdes të veçantë duhet ti kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza. Tutje; në mënyrë që të mbrohet rrjedha e lumenjve, është e nevojshme të kontrollohen të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.

Mbrojtja e tokës bujqësore

Toka bujqësore, si vlerë e çmuar për zhvillimin ekonomik të komunës së Klinës duhet të mbrohet nga degradimi, erozioni e fragmentimi me masat mbrojtëse të përcaktuara me ligjin nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe me UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Mbrojtja e pyjeve

Duke marrë parasysh përqindjen e madhe të sipërfaqeve pyjore në komunë, pylltaria konsiderohet si potencial shumë i mirë për zhvillimin ekonomik të komunës. Kështu, mbrojtja e këtyre sipërfaqeve planifikohet të bëhet konform ligjit nr. 03/L-153 për Pyjet e Kosovës dhe aktet nënligjore relevante, si dhe UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.

Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore bëhet nëpërmjet formave si në vijim:

1. Mbrojtja e tokës pyjore nga shpyllëzimi- prerja e të gjitha bimëve pyjore dhe më pas përdorimi i kësaj toke për shfrytëzime të tjera jo-pyjore;
2. Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet pyllëzimit- krijimi i një pylli apo të një grumbulli të bimëve pyjore (ekskluzivisht autoktone) në një tokë ku nuk kishte pyll;
3. Mbrojtja dhe rregullimi i tokës pyjore nëpërmjet ripyllëzimit- rivendosja e mbulesës pyjore (ekskluzivisht autoktone), në forme të natyrshme (nëpërmjet mbjelljes natyrore, nëpërmjet kthimit të pyjeve cungishte në trungishte) ose në forme artificiale (nëpërmjet mbjelljes së drejtpërdrejtë të bimës dhe farës).

Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera

Duke konsideruar rreziqet e mëdha që paraqiten në sipërfaqe të ndryshme të komunës për shkak të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, për menaxhimin e këtyre fatkeqësive, parandalimin e tyre dhe zvogëlimin e numrit të viktimave dhe pasojave tjera në natyrë, planifikohet zbatimi i masave mbrojtëse të përcaktuara me ligjin nr. 04/L-027 për Mbrojtjen nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera.

Mbrojtja nga Erozioni

Me qëllim të parandalimit të aktivitetit eroziv, parashikohet të ndërmerren hapa konkret dhe të menjëhershëm, siç janë:

1. Ndalimi i prerjeve dhe degradimit të pyjeve;
2. Ndalimi i mbikullotjes;
3. Ndalimi i shfrytëzimit të të mirave materiale që shkaktojnë erozion;
4. Ndalimi i shfrytëzimit të dheut dhe rërës etj.



Gjatë procesit të planifikimit kujdes i veçantë duhet ti kushtohet zonave erozive ndaj të cilave, përveç faktorëve natyror, procesin eroziv në shkallë të madhe e ka rritur faktori njeri. Në shkallë globale ky faktor ka ndikuar në rritjen e erozionit 10-40 herë me shumë se faktori natyror, prandaj trajtimi i duhur i këtyre zonave do të ndikojë në zbutjen e efektit të tyre negativ në të gjitha aspektet, duke përfshirë atë ekonomik, social, mjedisor dhe infrastrukturor.

Parandalimi i erozionit është i nevojshëm për mbrojtjen e resurseve natyrore si toka bujqësore, rrjedhat lumore, pyjet, peizazhet natyrore, por edhe të mirave të krijuara nga njeriu siç janë vendbanimet, infrastruktura rrugore. Erozioni mund të parandalohet me anë të hartimit të politikave dhe ndërmarrjes së veprimeve konkrete për parandalimin, shmangien dhe marrjen nën kontroll të veprimeve që mund të shkaktojnë erozion.

Kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për këto zona:

- Ndalohet prerja e drurëve dhe shkurreve;
- Ndalohet shpyllëzimi;
- Në rast të rrezikut eroziv në kullosat përkatëse ndalohet dhënia e lejeve për kullotje;
- Ndalohet shndërrimi i kullosave dhe livadheve në toka punuese të rrezikuara nga erozioni;
- Nevojitet përcaktimi paraprak i mënyrës së punimit dhe shfrytëzimit të tokës;
- Ndalohet pyllëzimi i detyruar pa një studim paraprak;
- Ndalohet nxjerrja e inerteve;
- Ndalohet ndërtimi i objekteve pa leje mjedisore në zonat erozive;
- Ndalohet ndërtimi i objekteve të cilat rrezikojnë stabilitetin e tokës siç janë pendat, kanalet, hurdhat e peshqve;
- Ndalohet hedhja e mbeturinave;
- Pyllëzimi i vendeve të zhveshura;
- Meliorimi i pyjeve dhe kullosave;
- Në rajonet kodrinore malore duhet të studiohet mënyra e punimit të tokës dhe të dëgjohen këshillat nga ekspertët bujqësor;
- Pyllëzimi me fidanë por edhe me barishte;
- Ndërrimi i kulturave bujqësore nga ato barishtore në pyjore;
- Ndërtimi i tarracave dhe objekteve;
- Rregullimi i shtretërve të rrëkeve;
- Pastrimi i shtretërve të rrëkeve nga bimët e vet rritura;
- Pastrimi i shtretërve të rrëkeve nga depozitimi i inerteve me leje paraprake ujore.

Masat biologjike

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pa kontrolluara dhe nga zjarri.
- Ndalimi i kullotjes në masivet e varfra me bimësi.
- Pyllëzimi i viseve të zhveshura dhe atyre të degraduara.
- Krijimi i brezave të gjelbër në ato rajone, e ku shkalla e erozionit është e lartë.

Erozioni duhet të kufizohet në brigjet e lumenjëve kryesor me mbjelljen e drunjëve që do të mbulonin brezin prej 10 metra largësi nga lumi. Shfrytëzimi i tokave bujqësore në fushat lumore të lumenjve kryesor duhet të kufizohet me kullota të përhershme ose pyje.



Mbrojtja nga zhurma

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga ndotja e zhurmës është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve të transportit dhe vendbanimeve.

Bazuar në rekomandimet e VSM për zhvillimin e sistemit për monitorimin e nivelit të zhurmës, masat që duhet të ndërmerren janë: Hartimin e Planit të mobilitetit (potencuar edhe më lartë) i cili promovon dhe nxitë përdorimin e transportit publik me shtysa ose lehtësime për përdoruesin siç parashihet me PZHK, Paisja me mjete për monitorim të vazhdueshëm të nivelit të zhurmës, potencialisht si pjesë e një stacioni të ri monitorues që përfshinë edhe kualitetin e ajrit. Mundet të jetë pjesë e një njësie mobile, Hartimi i planit të veprimit dhe Hartës së zhurmës siç e parasheh legjislacioni në fuqi sipas të cilit parashihet identifikimin e lokacioneve me intensitet të lartë të zhurmës, prezantimin e tyre në hartë dhe propozimi i masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma, Zbatimi i masave të reja për amortizimin dhe mbrojtjen nga zhurma siç janë shirita të vegjetacionit apo barriera mbrojtëse në afërsi të rrugëve apo zonave që gjenerojnë shumë zhurmë (në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi).

Masat për mbrojtje nga zjarri

Ligji për mbrojtje nga zjarri e obligon komunën e Klinës si përgjegjëse për hartimin e *Planit për mbrojtje nga zjarri në nivel komunal*. Ky dokument ka rëndësi të veçantë pasi evidenton rrezikun nga zjarri në zonat që përfshinë territori i komunës. Ky dokument duhet të hartohet në bazë të *Planit shtetëror për mbrojtje nga zjarri*.

Komuna e Klinës në vitet e fundit është përballur kryesisht me zjarre në sektorët pyjor kryesisht të shkaktuara nga temperaturat e larta, rrjeti elektrik i lartpërquesve, zjarrvëniet e qëllimshme dhe veprimtaritë e pakujdesshme njerëzore. Zonat më të rrezikuara në komunën e Klinës nga zjarret në pyje janë në zonat kadastrale të Gllarevës, Sferkës, Krushevë e Vogel, Dollc, Gremnik, Çabiq. Deri në hartimin e *Planit për mbrojtje nga zjarri në nivel komunal*, komuna e Klinës duhet të parasheh masa konform situatave si më poshtë:


- Inspektim të zonave për parandalim të zjarreve në zonat pyjore dhe bujqësore,
- Planifikim të zonave tampon mes zonave pyjore dhe bujqësore për të penguar përhapjen e zjarreve nga tokat bujqësore në zona pyjore dhe anasjellas,
- Vendosjen e stacioneve të hidrantëve në vendbanime me prezencë të zjarreve në pyje,
- Përmirësimin e qasjes së automjeteve të zjarrëfikëseve në zonat urbane dhe rurale.

Në kontekst të zbatimit të rekomandimeve të VSM-së, komuna e Klinës duhet të:

- Sigurojë zbatimin e skemave të shtysave dhe masave ndëshkuese të rrepta për zjarrvënësit;
- Sigurojë kontroll rigoroz dhe monitorim i vazhdueshëm i zbatimit të masave për revitalizimin e zonave të degraduara nga zbatimi i projekteve të ndryshme si edhe ato të turizmit;
- Ngrisë vetëdijen e popullatës për ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave të biodiversitetit, pyjeve në veçanti dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të tyre;
- Ngrisë vetëdijen e popullatës për ndryshimet klimatike dhe efektin e tyre në biodiversitet;
- Bëjë restaurimin e peizazheve të prekura nga aktivitetet njerëzore.

Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme ne mjedis

Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna, në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis. Projektet zhvillimore në shkallë prej 5 hektarëve, duhet të dëshmojnë që nuk shkaktojnë ndikime në mjedis. Gjatë dhënies së lejeve për objekte zhvillimore ekonomike, në pajtim me rregullat mjedisore, duhet të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis siç janë ndotja e ajrit dhe zhurma, vibracionet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta. Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbytjet prodhuese.



Harta 47. Harta e planit për mbrotje nga rreziket natyrore




4.3.3.10. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Mbrojtja e Trashëgimisë Kulturore

Zonat nën mbrojtje të trashëgimisë kulturore do të trajtohen konform Ligjit për Trashëgimi Kulturore si dhe Ligjit për Planifikimin Hapësinor. Zhvillimet e ardhshme në këto zona do të kontrollohen si dhe do të parandalohet degradimi i mëtutjeshëm i vlerave të tyre dhe mjedisit rrethues.

Duke u bazuar në UA nr.08/2017 për Norma Teknike të Planifikimit Hapësinor, do të kufizohen zhvillimet përreth zonave të mbrojtura me radius prej 50 metrash, respektivisht 100 metra prej perimetrit të objekteve të trashëgimisë arkeologjike.

Bazuar në rekomandimet e VSM-ës, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitektuale arrihet përmes hartimit të planit për menaxhimin e integruar të trashëgimisë kulturore, krijimin e shtyesave për investime në trashëgimi kulturore duke e ndërlidhur atë me zhvillimin e turizmit dhe promovimit të kulturës, Forcimi i lidhjes së komunitetit dhe përgjegjësisë së përbashkët për promovimin e kulturës dhe mbrojtjen e aseteve të trashëgimisë me anë të ngjarjeve, punëtorive, festivaleve organizuar nga vullnetarë dhe popullata locale, Shfrytëzimi i aseteve lokale për zhvillimin e projekteve nga fusha e trashëgimisë si stafi vullnetar i përbërë nga studentët vendor ose të huaj në shkëmbim të njohurive të reja ose njohjes si përvojë pune në mungesë të fondeve, Lobimi për investime dhe grante në mbështetje të aktiviteteve komunale. – Hulumtim për përcaktimin e perimetrit dhe sipërfaqes së mbrojtur përreth vlerave të trashëgimisë kulturore; Ngritja e vetëdijës për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë dhe përdorimin e saj në favor të zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm, Ngritja e vetëdijes për përdorimin dhe përfshirjen e materialeve të lokalitetit që janë miqësore ndaj mjedisit (gurit, tullës, drurit) në ndërtesat e reja me qëllim krijimit të ndërthurjes së arkitekturës moderne me atë tradicionale.



Harta 48. Harta e Planit për mbrojtjen e Trashëgimisë Natyrore dhe Kulturore

4.3.8 Vendbanimet

Komuna e Klinës karakterizohet me vendbanime kryesisht të shpërndara, sidomos në zonën rurale. Për të kontrolluar zhvillimin e banimit dhe funksioneve të tjera në pajtueshmëri, është përcaktuar kufiri ndërtimor për secilin vendbanim. Plani Zhvillimor Komunal rekomandon zhvillim kompakt dhe të balancuar, duke ofruar shërbime bazë në funksion të këtij zhvillimi.

Bazuar në parashikimet demografike të komunës, vendbanimet do të zhvillohen sipas këtyre funksioneve të përcaktuara me UA nr. 08/2017 për Normal Teknike të Planifikimit Hapësinor:

Tabelë 82. Planifikimi i zhvillimit të vendbanimeve në komunën e Klinës

Vendbanimi	Funksioni	Klasifikimi sipas madhësisë
Klina	Qendër komunale	Vendbanim shumë i vogël urban
Zllakuqani	Vendbanim	Vendbanim rural i madh



Gillarevë, Krushevë e vogël, rixhevë	Vendbanim	Vendbanim rural i madh
Caravik, Dresnik, Gremnik, Jashanicë, Klinafç, Pograhë, Përqev, Sferkë, Shtupel, Siqevë, Zajm, Zllakuan, Gjurgjevik i vogël, Kërrnic, Radulloc	Vendbanim	Vendbanim i mesëm i madh rural
Çabiq, Dranashiq, Dush, Grabanicë, Kpuz, Krushevë e Madhe, Pjetërq i Madh, Qupevë, Ujmirë, Videjë, Volljak, Zbaërgjë, Jellovc, Resnik	Vendbanim	Vendbanim i mesëm i vogël rural
Berkovë, Binxhë, Bokshiq, Budisalc, Deiq, Dobërdoll, Dollc, Dollovë, Drenoc, Dugojevë, Gjurgjevik i Madh, Qeskovë, Rudicë	Banim	Vendbanim i vogël rural
Dush i vogël, Jagodë, Nagllavkë, Pjetërq i poshtëm, Stupë	Banim	Vendbanim shumë i vogël rural

4.3.9 Shfrytëzimi i planifikuar i tokës

Shfrytëzimi i planifikuar i tokës përcakton llojin e shfrytëzimit të tokës bazuar në vizionin, qëllimet dhe objektivat e Planit Zhvillimor Komunal. Sipas konceptit të përzgjedhur të zhvillimit hapësinor, territori i komunës së Klinës ndahet në tri tërësi hapësinore:

1. Zona Natyrore
2. Zona Bujqësore
3. Zona Urbane

Zona Natyrore përfshinë pjesën jugore të territorit të Komunës së Klinës që ka një karakteristikë të veçantë natyrore, shpesh të mbrojtur për arsye mjedisore, biologjike, gjeologjike, ose kulturore. Kjo zonë karakterizohet me reliev më të ngritur e që në të njëjtën kohë kjo pjesë është identifikuar dhe me lartësitë më të mëdha mbidetare në nivel komune. Zonat natyrore ka një rëndësi të veçantë për shkak të biodiversitetit të lartë, funksionit ekologjik, dhe për shkak të rolit në mbajtjen e ekosistemeve të shëndetshme. Ruajtja e këtyre zonave dhe menaxhimi i tyre të qëndrueshëm janë thelbësore për të siguruar që trashëgimia natyrore të ruhet për brezat e ardhshëm në Komunën e Klinës. Duke pasur parasysh që kjo zonë është e pasur me pyje, rrjedha ujore, peisazhe natyrore, monumente natyrore e kulturore, biodiversitet etj., parashihet të jetë një potencial për aktivitete turistike, eko-turizëm, aktivitete blegtorale, rekreacion etj. Po ashtu planifikohet të shfrytëzohen resurset e trashëgimisë kulturore dhe natyrore me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të zonës natyrore. Infrastruktura e nevojshme teknike, rrugore, publike dhe sociale do të kompletohet në atë mënyrë që të ndihmojë edhe në ruajtjen por edhe në promovimin dhe shfrytëzimin racional dhe eficient të këtyre burimeve.

Zona Bujqësore përfshinë kryesisht pjesën veriore të komunës së Klinës, e cila gjithashtu karakterizohet me toka të kategorive me bonitet të lartë. Kjo zonë është mjaftë e pasur me hidrografi, në hapësirën e së cilës janë të identifikuar apo rrjedhin 3 rrjedha lumore: Drini i Bardhë nga pjesa veriore, Lumbardhi i Pejës nga pjesa perëndimore dhe lumi Klina nga pjesa lindore. Zona bujqësore shtrihet në një territor kryesisht të rrafshët në të cilin lartësia mesatare mbidetare është 450 m. Konsiderohet si potenciali më i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të komunës në përgjithësi. Të gjitha masat e nevojshme për zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë do të ndërmerren konform standardeve të aplikueshme në Kosovë dhe duke u bazuar në praktikën dhe




përvojat më të mira lokale, rajonale dhe ndërkombëtare. Të gjitha masat e nevojshme për ruajtjen e tokës bujqësore si dhe zhvillimin dhe promovimin e bujqësisë si dega kryesore ekonomike e Klinës janë paraparë me këtë PZHK dhe si të tilla janë vendosur në Planin e Veprimit të këtij PZHK.

Zona urbane- relievi është i rrafshët me disa valëzime të krijuara nga veprimtaria lumore. Lartësia mesatare mbidetare është 380 m. Përveç qytetit të Klinës, zona urbane përfshinë edhe vendbanimet Klinafç, Dresnik dhe Zllakuqan, kjo për shkak të zhvillimeve të hovshme të ndërtimit të cilat kanë bërë që këto vendbanime të shndërrohen në paralagje urbane të Klinës. Brenda kufijve ndërtimor të kësaj zone planifikohet ri-zhvillim, plotësim e densifikim i zonës urbane. Përveç shfrytëzimit të banimit, në këtë zonë planifikohet zhvillimi i shfrytëzimeve të tjera në pajtueshmëri me karakterin urban të zonës, duke përfshirë shërbimet publike dhe sociale, shërbimet e komunitetit, shërbime argëtuese e rekreative, shërbime komerciale etj. Zona urbane po ashtu do të zhvillohet konform nevojave dhe kërkesave zhvillimore të tri tërësive urbane (Zona Veriore dhe Jugore; Zona Lindore; Zona Qendrore) të parapara me këtë PZHK. Të tri tërësitë urbane do ta ruajnë karakterin unik të tyre me dominim të funksioneve primare të përcaktuara për to, ndërsa do të ketë kujdes që përdorimi i përzier (mix use) të aplikohet po ashtu.

Zgjerimi i kufirit ndërtimor të zonës urbane në drejtim të zonës kadastrale Dresnik është bërë kryesisht brenda hapësirës që i takon Klasës I-IV të bonitetit të tokës. Mirëpo, kjo është bërë për të siguruar vazhdimësi fizike dhe territoriale të zonës urbane në atë mënyrë që të parandalohet shpërndarje e pa-rregullt e zonës së banuar. Kjo politikë dhe ky veprim po ashtu është në përputhje me prioritetet strategjike të këtij plani për zhvillim kompakt të të gjithë komunës si dhe zhvillim kompakt të zonës urbane të qytetit të Klinës. Ky zgjerim po ashtu ka marrë parasysh zhvillimet në terren, përkatësisht ndërtimet që kanë ndodhur brenda dhe në afërsi të zonës së re të përfshirë brenda kufijve të ri ndërtimor.

Me këtë PZHK është propozuar edhe ndërtimi i Liqenit Akumulues në shtratin e lumit Drini i Bardhë, përkatësisht në lokacionin mes Restaurant Fenix deri tek penda ekzistuese. Gjatësia e këtij liqeni akumulues është 1.05 km. Ky propozim është bërë duke marrë parasysh iniciativën aktuale të komunës.

Kompletimi i infrastrukturës teknike, transportit, energjisë dhe telekomunikacionit, ndriçimit publik, infrastrukturës publike dhe sociale si dhe shtimi i aktivitetit ekonomik dhe interaktivitetit social janë prioritetet strategjike të këtij PZHK. Të gjitha hapësirat publike si dhe objektet e infrastrukturës publike dhe sociale do të jenë të qasshme për të gjitha kategoritë sociale. Me realizimin e këtyre prioritetëve strategjike do të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm, i balancuar, koheziv dhe gjithëpërfshirës i zonës urbane/qytetit të Klinës në veçanti por edhe i komunës në përgjithësi.



Harta 49. Harta e planit të shfrytëzimit të planifikuar të tokës

ZONA BUJQËSORE - PJESA VERIORE

